



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA**  
**QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA**  
**MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË**  
**MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU**  
**MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY**



## **UDHËZUES PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS**

**(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSIMDHËNËS)**

### **FUSHA KURRIKULARE JETA DHE PUNA**

*Tetor, 2016*



# **UDHËZUES PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS**

**(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSIMDHËNËS)**

## **FUSHA KURRIKULARE JETA DHE PUNA**

*Tetor, 2016*



***Përgatitur nga:***

*Binak Gërguri, koordinator i fushës Jeta dhe puna, IPK – MAShT*

*Zana Kurtishi - Rudi, mësimdhënëse – bashkëpunëtore për kurrikula*

*Kimet Mejtani, mësimdhënëse – bashkëpunëtore për kurrikula*

# PËRMBAJTJA E UDHËZUESIT

<b>I. HYRJE.....</b>	<b>9</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>• Rëndësia e udhëzuesit</li><li>• Qëllimi i udhëzuesit</li><li>• Përdorimi i udhëzuesit</li><li>• Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit</li><li>• Organizimi i udhëzuesi</li></ul>	
<b>II. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË.....</b>	<b>13</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Arritja e qëllimeve të arsimit parauniversitar</li><li>▪ Parimet e arsimit parauniversitar</li><li>▪ Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit</li><li>▪ Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë (RNK) dhe arritja e tyre</li><li>▪ Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe arritja e tyre</li></ul>	
<b>III. PROGRAMET MËSIMORE.....</b>	<b>27</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Qëllimi i programeve mësimore</li><li>▪ Lidhja e programeve mësimore me konceptet e fushës dhe me rezultatet e të nxënit të fushës</li><li>▪ Temat dhe rezultatet e të nxënit</li><li>▪ Udhëzimet metodologjike në programet mësimore</li></ul>	
<b>IV. KURRIKULA ME ZGJEDHJE – ZBATIMI NË PRAKTIKË.....</b>	<b>31</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Hyrje</li><li>▪ Lidhja e Kurrikulës me zgjedhje me kurrikulat bërthamë dhe me programet mësimore</li><li>▪ Qëllimi</li><li>▪ Organizimi i Kurrikulës me zgjedhje</li><li>▪ Përbajtja e Kurrikulës me zgjedhje</li><li>▪ Aspektet kryesore për përgatitjen e një programi mësimor me zgjedhje</li><li>▪ Planifikimi i Kurrikulës me zgjedhje</li></ul>	
<b>V. ASPEKTE METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT MËSIMOR.....</b>	<b>35</b>
<ul style="list-style-type: none"><li>▪ Plani mësimor</li><li>▪ Plani vjetor</li><li>▪ Plani dymujor</li><li>▪ Plani javor</li><li>▪ Plani i orës mësimore</li><li>▪ Planifikimi i çështjeve ndërkurrikulare dhe veprimtarive jashtëkurrikulare</li></ul>	

<b>VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES DHE MATERIALET MËSIMORE</b>	59
.....	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Metodologjia e mësimdhënies në funksion të Kurrikulës dhe programeve të reja mësimore <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në arritjen e kompetencave</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar</li> <li>- Mësimdhënia dhe të nxënit e diferencuar</li> <li>- Çështjet/temat ndërkurrikulare</li> <li>- Çështjet/veprimtaritë jashtëkurrikulare</li> </ul> </li> <li>▪ Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)</li> </ul>	
<b>VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE</b>	69
.....	
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Qëllimi i vlerësimit</li> <li>▪ Parimet themelore të vlerësimit</li> <li>▪ Llojet e vlerësimit / Vlerësimi i brendshëm</li> <li>▪ Aspektet metodologjike dhe praktike të zbatimit të vlerësimit</li> </ul>	
<b>VIII. BASHKËPUNIMI I MËSIMDHËNËSVE</b>	83
.....	
<b>SHTOJCA</b>	84
.....	
<b>BURIMET DHE LITERATURA</b>	109
.....	

## SHKURTESAT

<b>KB</b>	Kurrikula bërthamë
<b>KK</b>	Korniza e kurrikulës
<b>KSNA</b>	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit
<b>MAShT</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
<b>RN</b>	Rezultatet e të nxënit
<b>RNF</b>	Rezultatet e të nxënit për fushë
<b>RNL</b>	Rezultatet e të nxënit për lëndë
<b>RNK</b>	Rezultatet e të nxënit për kompetenca
<b>ShK</b>	Shkalla e kurrikulës
<b>TIK</b>	Teknologjia e informimit dhe komunikimit
<b>PL</b>	Programe lëndore





## **I. HYRJE**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulat bërthamë, ka përcaktuar përfaqësimin, shtrirjen dhe organizimin e secilës fushë kurrikulare dhe lëndëve mësimore brenda fushave përkatëse, pra edhe të **fushës kurrikulare Jeta dhe puna**.

Për të siguruar një qasje përgatitore dhe të suksesshme në zbatimin në praktikë të filozofisë së Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës (KK), kurrikulave bërthamë (KB) dhe programeve lëndore (PL), MASHT-i ndërmori iniciativën për ta përgatitur materiale ndihmëse për mësimdhënës - udhëzues të veçantë për fusha kurrikulare.

Për të përgatitur udhëzues për mësimdhënës, të cilët ofrojnë orientimet e nevojshme për zbatimin në praktikë të kurrikulës së re, MASHT-i ftoi dhe autorizoi Divizionin e kurrikulave në MASHT dhe Institutin Pedagogjik të Kosovës që të udhëheqin punën për përgatitjen e udhëzuesve për fusha kurrikulare.

Udhëzuesi për fushën kurrikulare Jeta dhe puna u përgatit me përfshirjen aktive të mësimdhënësve që punojnë në shkolla, duke i bërë pjesë të autorësisë dhe të konsultimeve gjatë pilotimit të Kurrikulës dhe rishikimit të dokumenteve kurrikulare, pas përfundimit të fazës së pilotimit. Udhëzuesi ofron informata për jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin e parimeve të Kurrikulës, për kuptimin e zbërthyeshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca dhe për fusha të kurrikulës, si dhe të rezultateve të programeve lëndore, në planifikimet mësimore.

Gjithashtu, udhëzuesi ofron informata për ndërlidhjen e programeve lëndore me fushën e Kurrikulës, ofron orientime për aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të programeve mësimore, si dhe orientime për aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

Duke besuar se ky udhëzues i plotëson nevojat e mësimdhënësve dhe do të jetë i dobishëm për procesin e përgatitjes, planifikimit dhe zbatimit në praktikë të Kurrikulës, ne i ftojmë mësimdhënësit që ta marrin këtë udhëzues, programet lëndore, kurrikulat bërthamë, kornizën kurrikulare dhe në frymën e këtyre dokumenteve e të përvojave të avancuara, në procesin mësimor të fillojnë zbatimin në praktikë të Kurrikulës së re.

### **Mirënjohje**

Ky udhëzues është përgatitur duke u bazuar në udhëzuesin e fushës Jeta dhe puna, të hartuar për fazën e pilotimit të kurrikulës, përvojat e shkollave dhe mësimdhënësve gjatë procesit të pilotimit të Kurrikulës dhe në dokumentet kurrikulare e programet lëndore të rishikuara dhe të hartuara pas përfundimit të fazës së pilotimit të kurrikulës.

MASHT-i falënderon koordinatorët e këtij procesi Selim Mehmetin, Shqipe Gashin, Hajrije Devetakun – Gojanin, Agim Bytyçin, Ryve Prekoragjen dhe Radica Berishën, të cilët kontribuan në përgatitjen dhe redaktimin e këtij udhëzuesi.

Gjithashtu, MAShT-i i falënderon të gjithë mësime dhënësit dhe trajnerët e fushës Jeta dhe puna, që kontribuuan në rishikimin e këtij udhëzuesi me modele të planifikimit mësimor dhe me sugjerime, gjatë procesit të konsultimeve për rishikimin e këtij udhëzuesi.

## **Rëndësia e udhëzuesit**

Udhëzuesi mbështet zbatimin e KK-së, respektivisht KB-ve dhe programeve lëndore, për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në shkollë. Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore, të metodologjisë së mësime dhënësit dhe vlerësimit, ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës me proceset e mësimit në shkollë.

## **Qëllimi i udhëzuesit**

Meqenëse mësime dhënësit janë agjentët kryesorë të zbatimit të filozofisë së KK,-së, udhëzuesi ka për qëllim ngritjen profesionale të tyre, për ta kuptuar dhe zbërthyer KK, respektivisht KB dhe programet mësimore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në planifikimet mësimore, në strategji e teknika të mësime dhënësit, të nxënësve dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe në vetëvlerësim të procesit mësimor të organizuar nga vet mësime dhënësi duke e ndihmuar zhvillimin e kompetencave të caktuara të nxënësve të moshës që mbulon Kurrikula bërthamë në fjalë.

## **Përdorimi i udhëzuesit**

Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i mësime dhënësit për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësime dhënësit për zbatim të KK-së, respektivisht të KB dhe programeve lëndore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Në të ardhmen llogaritet që ky udhëzues, krahas me udhëzuesit për përmirësimin e praktikave në klasë (MAShT & SWAP, 2012) dhe udhëzues të tjerë, t'ju shërbejnë mësime dhënësit gjatë punës së pavarur në realizimin e kurrikulës së re.

## **Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit**

Duke pasur parasysh çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, pritet që mësime dhënësi të arrijë këto rezultate:

- Identifikon qasjet e arritjes së qëllimeve të arsimit të përcaktuara me KK;
- Identifikon qasjet e respektimit të parimeve në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;
- Identifikon elementet e domosdoshme të përmbajtjes së planifikimeve mësimore për zbatimin e KB – programeve mësimore;
- Prezanton modelet e planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-së – programeve mësimore;
- Prezanton modelet e strategjive të mësime dhënësit dhe të nxënësve, duke respektuar parimet e KK-së, KB-së dhe programeve mësimore;
- Prezanton modelet e përgatitjes dhe shfrytëzimit të materialeve mësimore;.

- Zbaton strategjitë, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit konform parimeve të Kurrikulës dhe specifikave të programeve mësimore;
- Zbaton strategjitë e bashkëpunimit kolegjal brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.

### **Organizimi i udhëzuesit**

- Udhëzuesi përbëhet prej shtatë kapitujve dhe shtojcës. Në secilin kapitull elaborohen çështje që u ndihmojnë mësimdhënësve të kuptojnë ecurinë e zbërthimit të KK-së, respektivisht të KB-ve dhe programeve mësimore për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në praktikën shkollë, dhe t'i bëjnë ata agjentë të ndryshimeve. Secili kapitull i udhëzuesit është në funksion të lehtësimit të punës së mësimdhënësve për zbatimin e Kurrikulës së re.

Në kapitullin e parë – *hyrja*, trajtohen rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit e udhëzuesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit.

**Në kapitullin e dytë - *Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula bërthamë*** – zbatimi në praktikë, trajton çështjet që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin e parimeve të kurrikulës në procesin e arsimit në shkollë, kuptimin e zbërthyeshmërisë së rezultateve të të nxëniet për kompetencat kryesore të shkollës dhe për fushat kurrikulare e programet mësimore lëndore në planifikimet mësimore.

Në Kapitullin e tretë–***Programet mësimore***, trajtohen qëllimi i programeve mësimore, lidhja e programeve mësimore me konceptet e fushës dhe me rezultatet e të nxëniet të fushës, temat dhe rezultatet e të nxëniet dhe udhëzimet metodologjike në programet mësimore.

Në Kapitullin e katërt- ***Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re***, trajtohen çështjet e planifikimeve mësimore, duke integruar elemente të domosdoshme të KB-së dhe programeve mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare e programeve mësimore dhe bashkëpunimi kolegjal në funksion të zbatimit të KB-së dhe programeve mësimore.

---

**Në kapitullin e pestë – *Kurrikula me zgjedhje*** – zbatimi në praktikë, trajtohen aspektet që do të ndihmojnë shkollën në konceptimin e drejtë të të kuptuarit të kurrikulës me zgjedhje si pjesë përbërëse e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës, në dhënien e udhëzimeve për hartimin e tij, në konkretizimin e procedurave dhe të kriterëve për miratimin e realizimin e tij dhe në paraqitjen e modeleve të caktuara të cilat do të shërbejnë për cilësi të të gjitha aspekteve që ndërliken me kurrikulën me zgjedhje.

---

**Në kapitullin e gjashtë – *Metodologjia e mësimdhënies dhe materialet mësimore***, trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të të nxënësve, duke përfshirë metodat, teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënësve të suksesshëm, përgatitjet dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore.

---

•

**Në kapitullin e shtatë – *Vlerësimi i nxënësve*** -Qasjet praktike në vlerësimin e nxënësve, trajtohen metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat, rezultatet e të nxënësve dhe nivelet e njohjes në funksion të vlerësimit.

---

- Shtojca përmban instrumente të planifikimeve dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të përgatitura nga mësimdhënësit.

## II. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË

Ky kapitull përqendrohet në:

- Arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar;
- Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukative- arsimore;
- Kuptimin dhe funksionin e rezultateve të të nxënësve (*rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (RNK), rezultatet e të nxënësve të fushave kurrikulare - RNF dhe rezultatet e të nxënësve për lëndë mësimore - RNL*).

### II. 1 Arritja e qëllimeve të arsimit parauniversitar

#### • **Qëllimet e arsimit parauniversitar**

- *Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;*
- *Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*
- *Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*
- *Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*
- *Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm; dhe*
- *Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.*

Qëllimet e arsimit parauniversitar të paraqitura në KK janë pjesë përbërëse e dokumenteve të kurrikulave bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. E gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve është në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe rezultatet e të nxënësve për kompetencat kryesore të shkollës (RNK), rezultatet e të nxënësve të fushave kurrikulare (RNF) të secilës shkollë kurrikulare dhe rezultatet e të nxënësve për lëndë mësimore (RNL) janë në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Rrjedhimisht, e gjithë puna praktike edukative-arsimore që zhvillohet në shkollë duhet të jetë në funksion të arritjes së këtyre qëllimeve.

Qasjet e arritjes së qëllimeve duhet t'u përshtaten moshës dhe mundësive të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Në secilën Kurrikulë bërthamë janë dhënë disa përshkrime që lidhen me veçoritë e arsimit në nivelin përkatës, të cilat i orientojnë hartuesit e programeve mësimore dhe mësimdhënësit që punojnë në nivele të ndryshme të arsimit që të marrin për bazë mundësitë dhe nevojat e nxënësve, gjatë mbarështrimit të programeve mësimore, planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të tjera me nxënës në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit.

Për të thelluar informacionet lidhur me veçoritë e arsimit në nivele, secili mësimdhënës duhet të konsultojë Kurrikulën bërthamë (KB) të nivelit të arsimit në të cilin punon dhe programet mësimore me të cilat punon në klasën përkatëse, në mënyrë që, me kohë, të orientojë drejtë punën me nxënës për arritjen e qëllimeve të arsimit.

**Si arrihen qëllimet e arsimit parauniversitar?**

Qëllimet e arsimit arrihen në mënyrë suksesive, në secilin nivel të arsimit. Qasjet për arritjen e qëllimeve dallojnë nga niveli në nivel. Ato duhet t'u përshtaten moshës dhe mundësi të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Qëllimet e arsimit arrihen kur ato bëhen pjesë e planifikimeve mësimore të secilës klasë, si të planifikimeve vjetore, mujore, javore, ditore dhe pjesë e procesit mësimor që zhvillohet në klasë dhe jashtë saj. Kjo do të thotë se, në funksion të arritjes së qëllimeve, duhet të jenë aktivitetet e shumta të udhëhequra nga mësimdhënësi, si:

- Përzgjedhja e rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (RNK) dhe rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare (RNF), përkatësisht RNL që synohen të arrihen gjatë periudhave të caktuara, përmes përmbajtjeve (temave dhe njësive mësimore) dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;
- Përzgjedhja e përmbajtjes mësimore (temave apo përcaktimi i njësive mësimore);
- Përzgjedhja e metodologjive të mësimdhënies dhe të të nxënit;
- Përzgjedhja e materialeve dhe burimeve mësimore;
- Përzgjedhja e metodologjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit;
- Përzgjedhja e formave të komunikimit;
- Krijimi i klimës së favorshme, në klasë dhe shkollë, për arritjen e qëllimeve.

**Reflekto:** Qëllimet e arsimit nuk mund të kuptohen si fiksime të veçanta, që arrihen secila ndaras, njëra nga tjetra. Ato, në shumicën e rasteve, funksionojnë si tërësi.

**Shembull** i arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar përmes fushës

kurrikulare **Jeta dhe puna.**

*Shkalla II, kompetencat 4.1,4.2,4.3,4.4;*

*Shkalla II, fusha kurrikulare Jeta dhe puna, rezultati 1.2, 3.2;*

*Rezultati i fushës kurrikulare Jeta dhe puna, klasa: 6-të p.sh. **rezultatet e të nxënit brenda temës 1***

*Përmbajtja mësimore: Materialet dhe përpunimi i tyre.*

***Qëllimet e synuara mund të jenë:** zhvillimi i punës praktike, njohja me materialet dhe përpunimin e tyre, dhe nëse nxënësit angazhohen në përcaktimin e përpunimit të disa materialeve në mënyrë individuale a grupe, promovohet bashkëpunimi si vlerë e përgjithshme në frymën pozitive, rritet përgjegjësia ndaj vetës dhe të tjerëve, rritet angazhimi dhe iniciativa si pjesë të ndërmarrësisë dhe krijohet mundësia për punë të pavarur.*

***Në këtë rast vijnë në shprehje metodologjia e punës, materialet dhe burimet e informacionit, klima pozitive.***

***(Kujto aktivitetet që mësimdhënësi i bën për arritjen e qëllimeve parauniversitare).***

**Aktivitet:**

*Pasi që të keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar, diskutoni me kolegët:*

1. Si mund të integrohen dhe respektohet qëllimet e arsimit parauniversitar, konkretisht në kuadër fushës Jeta dhe puna/ apo lëndës mësimore sipas niveleve arsimore.

2. Merrni shembuj në lëndën tuaj dhe në nivele të ndryshme të planifikimit dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies.

Fusha e kurrikulës/Lënda mësimore:Fusha Jeta dhe puna

Klasa:\_\_\_\_\_

Tema:\_\_\_\_\_ (mund të merret nga programi i lëndës)

Rezultati i të nxënit: \_\_\_\_\_ (duhet të jetë rezultat i të nxënit i lidhur me temën e përcaktuar)

Qëllimet e arsimit që synohen të arrihen:

---

---

Përshkrimi i anës praktike për arritjen e qëllimeve gjatë punës me nxënës:

---

---

## **II.2 Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukative-arsimore**

<i>Parimet</i>
<ul style="list-style-type: none"><li>• <i>Gjithëpërfshirja;</i></li><li>• <i>Zhvillimi i kompetencave;</i></li><li>• <i>Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent;</i></li><li>• <i>Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle;</i></li><li>• <i>Përgjegjësia dhe llogaridhënia.</i></li></ul>

Parimet janë pikënisje, pikë referimi, janë një lloj i rregullave, të cilat e mbështesin punën edukative-arsimore për arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar dhe në arritjen e kompetencave kryesore të kurrikulës. Ato mbështesin punën edukative-arsimore të mësimdhënësve të të gjitha fushave të kurrikulës. Janë udhërrëfyes të punës së suksesshme të



mësimdhënësve që reflektohen në përgatitjen e nxënësve në secilin nivel të arsimit për sfidat e tanishme në të nxënë, në zgjidhje të problemeve në raport me potencialet e tyre dhe në përgatitjen për të nxënë të mëtutjeshëm. Mësimdhënësit, punën e tyre edukative-arsimore, duhet ta mbështesin në parimet e përcaktuara në Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (KK), respektivisht në KB për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe kurrikula për të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar është ndërtuar mbi bazën e parimeve që janë përcaktuar në KK (Shih KK,) dhe gjithashtu edhe zbatimi praktik i saj duhet të bëhet mbi bazën e tyre.

***Si mund ta dijë një mësimdhënës ose një aktiv profesional i një shkolle të caktuar, se është duke e mbështetur punën e vet në parimet e KK?***

Përgjigjja në këtë pyetje duhet të jetë pjesë e diskutimeve në mes të mësimdhënësve dhe forumeve të tjera në shkollë, gjatë të gjitha aktiviteteve që kanë për qëllim punën në procesin edukativ e arsimor. Në pjesën në vijim të këtij udhëzuesi ofrohen disa tregues se si një mësimdhënës gjatë punës së tij është në linjë të parimeve të KK-së.

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të gjithëpërfshirjes** atëherë kur:

- Ka **planifikuar** me qëllim për të diagnostikuar përvojat, dijet, kulturat, stilet e të nxënësve të nxënësve dhe ka realizuar aktivitetet për të përmirësuar mësimdhënien;
- Ka planifikuar duke synuar rezultate të caktuara;
- Ka **përdorur** llojllojshmëri të metodave, teknikave dhe materialeve të ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënësve si dhe detyra të diferencuara për realizim të aktivitetit.

#### **Dhe nxënësi**

- Ndihet i pranuar në klasë nga nxënësit edhe nga mësimdhënësi, i njëjtë si të gjithë të tjerët pa dallim, qoftë të potencialit, qoftë të gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë sociale, ekonomike, shëndetësore, etnike dhe kulturore;
- Ndihet i respektuar sa i përket dinjitetit, përvojës, dijeve, stileve të të nxënësve, mënyrës së të shprehurit dhe mendimit.

***Sepse kemi krijuar klimë ku secili ndihet komod, i çmuar, kontribuues dhe i suksesshëm***

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të zhvillimit të kompetencave** atëherë kur:

- Ka **planifikuar** mësimdhënien dhe të nxënësve, duke pasur parasysh rezultatet e të nxënësve të kompetencës (RNK), rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare (RNF) të shkollës së parë apo të dytë kurrikulare, dhe rezultatet e fushës apo lëndës për klasë (përgatitore e parë,... e pestë), të marrë dhe të adaptuar nga planet dhe programet ekzistuese, e nëse e jo i kem hartuar vetë;
- Ka aplikuar **metodologji dhe mjete didaktike**, të cilat kanë nxitur të nxënësit dëshirën, kreativitetin dhe pavarësinë;

- Ka përdorur **teknika dhe instrumente të vlerësimit**, të cilat kanë ndihmuar vetëvlerësimin, identifikimin e saktë të shkallës së arritjes dhe pastaj marrjen e masave për përmirësim.

Dhe nxënësi

- Identifikon, krahason, analizon dhe vlerëson ngjarje, dukuri dhe zgjidh probleme konform rezultateve të të nxënës të fushës apo lëndës për klasën përgatitore, apo klasat e arsimit fillor;
  - Demonstron shkathhtësi të komunikimit (dëgjon dhe është konstruktiv në dhënien e mendimeve, qoftë me gojë, me shkrim apo me vizatim), të menaxhimit të detyrës, aktiviteteve, kohës, mjeteve dhe të shfrytëzimit të burime;
  - Demonstron vlerat si tolerancë, mirësjellje, solidaritet, përkrahje, respekt dhe përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit;
  - Demonstron qëndrim, për diçka, si për sjellje, ngjarje a dukuri;
  - Demonstron iniciativa dhe pjesëmarrje për ndryshim;
  - Menaxhon emocionet e veta. Nuk është arrogant, konfliktuoz dhe i tensionuar
- **Dhe, kështu zhvillojmë nxënësit kompetent**

Mësimdhënësi është në **linjë të parimit të mësimdhënies së integruar dhe të të nxënës koherent** atëherë kur:

- Ka **planifikuar** lidhje ndërlëndore, brenda fushës së njëjtë, përmes përzgjedhjes së temave të përbashkëta;
- Ka **planifikuar** lidhje, në mes të fushave kurrikulare, që do të ndihmojnë zhvillimin e gjuhës te shkencat, artet, jeta dhe puna, por edhe te matematika; apo të ndihmojnë zhvillimin e temave të shkencave, shoqërisë dhe mjedisit përmes matematikës, gjuhës dhe arteve (p.sh. vjeshta, temë-njësi mësimore e shkencave ndihmohet të realizohet përmes esesë te gjuha, përmes artit e edhe muzikës; p.sh. Foljet, mbiemri, emri - njësi mësimore të gjuhës për përmes teknikës së pesëvargëshit zhvillohen te shkencat natyrore, te shoqëria dhe mjedisi etj.);
- Ka **planifikuar** module dhe projekte, ku gjenden elemente të fushave kurrikulare, p.sh. projekti Mbjellja e luleve në një kënd të oborrit të shkollës. Në atë rast vijnë në shprehje shkencat natyrore duke e studiuar kohën e përshtatshme për mbjellje, matematika duke matur thellësinë e gropës të përshtatshme për lulet, shoqëria dhe mjedisi duke ditur rëndësinë e ruajtjes dhe krijimit të një mjedisi të këndshëm, shëndeti dhe mirëqenia, artet etj.

Dhe nxënësi

- analizon një detyrë, situatë, ngjarje a dukuri në kënde të ndryshme (p.sh. të një lloj ushqimi, identifikon përbërjen, mënyrën e përdorimit dhe vendin e prodhimit. Këtu ka elemente të shkencave të natyrës, jetës dhe punës, por edhe të shoqërisë dhe mjedisit; pastaj, trupat gjeometrik – forma, mendojmë në matematikë, shkenca të natyrës, arte etj).

- identifikon ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e detyrave, ngjarjeve dhe dukurive (p.sh. bimët na ndihmojnë të kemi jetë të shëndoshë, sepse në saje të tyre kem ajër të pastër dhe ne i ruajmë, kujdesemi dhe i kultivojmë ato).

- **Dhe, kështu zhvillojmë të nxënë gjithëpërfshirës dhe koherent**

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të autonomisë dhe fleksibilitetit** atëherë kur:

- Ka përgatitur **planifikime mësimore** (vjetore, mujore, ditore) konform rezultateve të të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (RNK), rezultateve të të nxënësve për fushë kurrikulare (RNF) për shkallë dhe rezultateve të të nxënësve për lëndë mësimore për klasë dhe konform përvojave, ritmeve e stileve të të nxënësve të cilët i udhëhiq;
- Ka hartuar **kurrikulën zgjedhore** konform talentit, afiniteteve dhe interesave të nxënësve.

**Dhe, nxënësi**

- nxënësi në bazë të ritmeve individuale të të nxënësve;
- nxënësi sipas stilit individual;
- zhvillon talentin dhe nxënësi mbi bazën e afiniteteve dhe interesave.

**Dhe, kështu zhvillojmë nxënësin të suksesshëm**

Mësimdhënësi është në linjë të **parimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënës** atëherë kur:

- Është **transparent** për saktësinë dhe nivelin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve për secilin detyrë, aktivitet me secilin nxënësi-se dhe kem diskutuar rrugët e arritjes;
- Është **transparent** dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindër për të arriturat e rezultateve të nxënësve për kompetencat kryesore të shkallës (RNK) dhe rezultateve të nxënësve të fushës kurrikulare (RNF), lëndës a temës mësimore;
- Është **transparent** me Këshillin e klasës, Këshillin e mësimdhënësve të shkollës dhe këshillat e tjerë që funksionojnë në shkollë për nivelin e arritjes së rezultateve të kompetencave, fushave, lëndës apo temës për paralelet të cilat i udhëheqim.

**Dhe**

- Nxënësi është në dijeni për nivelin e arritjes së vetë konform kërkesave të shtruar nga mësimdhënësi;
- Prindërit janë në dijeni për nivelin e arritjes së fëmijëve të tyre konform rezultateve të të nxënësve të shkallës – kompetencës (RNK), rezultateve të të nxënësve të fushës kurrikulare (RNF) për shkallë, rezultateve të të nxënësve të lëndës (RNL) a temës mësimore për klasë;
- Këshilli i klasës, Këshilli i mësimdhënësve të shkollës dhe këshillat e tjerë që funksionojnë në shkollë janë në dijeni për nivelin e arritjes së nxënësve të paraleles.

- **Kështu përmirësojmë mësimdhënësin dhe rrisim të nxënësve e nxënësve**

**Aktivitet :** Pasi që të keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për Parimet e arsimit parauniversitar referencat e organizimit të punës edukative arsimore, diskutoni me kolegët: si mund të respektohen parimet e arsimit parauniversitar konkretisht në kuadër të një fushe të kurrikulës - në klasë, p.sh. në klasën e parë.

Merrni shembuj në lëndën tuaj dhe në nivelet e ndryshme të planifikimit **dhe të metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies**

**Fusha e kurrikulës/Lënda:Jeta dhe puna/Shkathtësi për jetë**

**Klasa:** \_\_\_\_\_

**Tema:** \_\_\_\_\_ (mund të merret nga programi i lëndës)

**Rezultati i të nxënit:** \_\_\_\_\_ (duhet të jetë rezultat i të nxënit i lidhur me temën e përcaktuar)

**Parimet që shpërbëjnë si pikënisje për të arritur rezultatin e të nxënit dhe për të zhvilluar temën mësimore:**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Përshkrimi i anës praktike për parimet që respektohen në përcaktimin e veprimtarive me nxënës dhe gjatë punës me nxënës:

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

### **2.3. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (RNK) dhe rezultateve të të nxënit për fusha të kurrikulës**

#### ***Kompetencat kryesore***

#### ***Rezultatet e të nxënit***

- *Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (RNK) dhe arritja e tyre;*
- *Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF);*

#### **2.3.1. Kompetencat kryesore të të nxënit<sup>1</sup>**

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe transferuese, të cilat do t'u ndihmojnë nxënësve që të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë të bazuar në dije, në një botë të marrëdhënieve të ndërvarura, që çojnë në veprime të efektshme njerëzore në botë në një sferë të caktuar. Prandaj të qenit kompetent do të thotë të zbatosh me efektshmëri një

<sup>1</sup>Kjo pjesë është e bazuar në Kurrikulat bërthamë për nivele.

*kombinim të njohurive, aftësive dhe sjelljeve për të reaguar suksesshëm ndaj një situatë ose për të zgjidhur një problem në botën reale”<sup>2</sup>.*

Kompetencat e parapara me kornizën e kurrikulës rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit parauniversitar dhe përcaktojnë rezultatet kryesore të të nxënës, të cilat duhet t’i arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të qëndrueshme gjatë sistemit të arsimit parauniversitar.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Kompetencat reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënës, të cilat janë të përgjithshme e të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme, deri në fund të arsimit të mesëm të lartë.

### **Kompetenca e komunikimit dhe të të shprehurit (Komunikues efektiv)**

Me qëllim që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillohen si personalitete, të mësojnë dhe të marrin pjesë aktive në shoqëri, është me rëndësi që t’i kuptojnë porositë që u drejtohen dhe të shprehin në mënyrë adekuate nëpërmjet gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. Për të komunikuar në mënyrë efektive, nxënësit përkrahen që të shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe kreative mjetet dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit.

### **Kompetenca e të menduarit (Mendimtar kreativ - krijues dhe kritik)**

Marrja dhe përpunimi i njohurive në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për të nxënë, por edhe për të marrë vendime dhe për të zgjidhur probleme. Duke mbajtur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, të bazuar në dije, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Nxënësit kanë nevojë, jo vetëm të marrin informacion, por edhe të zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese.

### **Kompetenca e të mësuarit (Nxënës i suksesshëm)**

Në zhvillimet bashkëkohore në shoqëri, në shkencë, në teknologji e në ekonomi nuk mund të kërkohet që të gjitha njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e nevojshme të arrihen nëpërmjet

---

<sup>2</sup> Anne Gilleran & Caroline Kearney (2014). Zhvillimi i kompetencave të nxënësve nëpërmjet e-Twinning. Shërbimet Qendrore të Mbështetjes për e-Twinning [www.etwinning.net](http://www.etwinning.net), European Schoolnet (EUN Partnership AISBL), Belgjikë.

shkollimit. Prandaj, shkolla u krijon nxënësve të gjitha kushtet dhe mundësitë për t'u arsimuar dhe përgatitur për të nxënë gjatë gjithë jetës. Në funksion të kësaj kompetence duhet të promovohet mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në stilet dhe strategjitë efektive mësimore.

### **Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis (Kontribuues produktiv)**

Shkolla angazhohet që nxënësi të përgatitet të punojë në mënyrë të pavarur dhe të vetëdijesohet për rolin dhe përgjegjësinë e tij në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Për të zhvilluar këtë kompetencë nxënësi përkrahen që të kuptojë në mënyrë të plotë ndërvarësinë ndërmjet fenomeneve shoqërore dhe natyrore. Njëkohësisht, duke e pasur parasysh arsimin për zhvillim të qëndrueshëm, ai përgatitet që të ballafaqohen me preokupimet mjedisore, ekonomike dhe sociale.

### **Kompetenca personale (Individ i shëndetshëm)**

Për të zhvilluar kompetencën personale, shkolla përgatit nxënësin, që në mënyrë efektive dhe konstruktive të inkuadrohen në jetën familjare, shoqërore dhe të punës. Në këtë kontekst, nxënësi përkrahet që të vetëdijesohen për veten dhe të ketë vetëbesim, por njëkohësisht të jetë i hapur dhe të ketë besim për të tjerët dhe te të tjerët.

### **Kompetenca qytetare (Qytetar i përgjegjshëm)**

Shkolla përgatit nxënësin për të jetuar së bashku me të tjerët dhe për të tejkaluar sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet në jetën e përditshme. Kjo kompetencë siguron që nxënësi të jetë në gjendje të veprojë si qytetar i përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë të zhvillimeve në shoqëri.

## **2.3.2. Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë dhe arritja e tyre**

Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënit për shkallë. Ato janë pjesë e Kurrikulës bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga të gjithë nxënësit, me rastin e përfundimit të një shkalle të kurrikulës. Rezultatet nuk mbulojnë gjithçka që nxënësit kanë mësuar apo është dashur të mësojnë gjatë një shkalle të caktuar. Ato shprehin kërkesat esenciale të arritjes, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, me rastin e përfundimit të një shkalle të caktuar si dhe promovojnë integrimin e mëtejme të fushave të kurrikulës në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me kornizën e kurrikulës.

Rezultatet e të nxënit përkufizohen si: „Deklarata që përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë një nxënës, në fund të një shkalle apo niveli”. Ato shprehin një varg domenesesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat.

Rezultatet e të nxënit për kompetenca në nivel shkalle shprehin pritjet e mësimdhënësve, të autoriteteve arsimore, të prindërve dhe të shoqërisë në raport me arritjet konkrete, të matshme, të nxënësve, në fund të çdo shkalle të kurrikulës. Ato duhet të përdoren gjatë

hartimit të programeve mësimore, organizimit mësimor në shkollë, hartimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore.

### **Zhvillimi dhe arritja e kompetencave**

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritja e rezultateve të tyre, bëhet përmes fushave kurrikulare. Të gjitha fushat kurrikulare, apo lëndët mësimore, që mbahen në klasën përgatitore, në klasën e parë dhe në klasën e dytë, duhet të kontribuojnë bashkërisht në arritjen e rezultateve të kompetencave të shkallës së parë. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe me fushat kurrikulare, përkatësisht lëndët mësimore dhe klasat që ka shkalla e dytë kurrikulare, shkalla e tretë, e kështu me radhë.

Nuk do të thotë që, domosdo, secila fushë kurrikulare, si e vetme me lëndët brenda saj, të arrijë të gjitha rezultatet e të gjitha kompetencave. Por, secila fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore duhet të fiksojë rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetencë që do të synojë t'i arrijë për secilën klasë. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të kompetencave të jenë pika synuese për disa fusha kurrikulare dhe disa lëndë mësimore, por mund të ndodhë që disa të përzgjedhjen nga një fushë apo lëndë mësimore e vetme.

P,sh. Rezultati III. 3 (shkalla e pestë, KB për arsimin e mesëm të lartë, f. 22)

#### **Nxënësi:**

***III.3 Parashtron pyetje dhe shfaq mendime të strukturuar për zgjidhjen e një problemi apo detyre të një teme të caktuar; bën përmbledhjen e së paku dy veprimeve të përdorura, të cilat përcaktojnë drejtimin e mëtejshëm të të nxënit të vet për temën apo problemin e caktuar.***

(Rezultati 3.3) arrihet përmes të gjitha fushave kurrikulare.

Kurse rezultati IV.1 (shkalla e pestë, KB për arsimin e mesëm të lartë, f. 22)

#### **Nxënësi:**

***IV.1 Përgatit biografinë personale (CV) sipas formatit dhe udhëzimeve të kërkuara dhe e prezanton veten me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke vënë theksin në mundësitë, aftësitë dhe cilësitë personale të angazhimit në një program apo projekt të caktuar.***

Rezultati 4.1 është rezultat që mund të trajtohet nga disa fusha kurrikulare, por më tepër vëmendje i kushtohet në fushën Jeta dhe puna.

Gjithashtu, duhet të kihet kujdes, të gjitha rezultatet e përzgjedhura nga shkalla e caktuar duhet të arrihen deri në klasën e fundit të asaj shkalle.

Rezultate e të nxënit për kompetencë mund të jenë të synuara në çdo klasë (sa ka shkalla), por arritja e tyre duhet të bëhet gradualisht, në mënyrë progresive dhe në harmoni me moshën dhe mundësitë e nxënësve.

P.sh. Rezultati IV.1 (shkalla e tretë, KB për arsimin e mesëm të ulët f. 20)

**Nxënësi:**

**IV.1 Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.**

Rezultati 4.1 ndoshta nuk mund të arrihet nga të gjithë nxënësit e klasës së gjashtë, por mjafton që ata të jenë në gjendje të organizojnë aktivitete praktike në grup. Arritja e plotë e këtij rezultati duhet të bëhet deri në fund të klasës së shtatë (fondi i shkollës së 3-të).

Në mënyrë që rezultatet e të nxënit që kompetencat të jenë të arritshme, ato duhet të jenë të pranishme pothuajse në të gjitha planifikimet mësimore të secilës fushë kurrikulare.

**Aktivitet:**

*Pasi që të keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për arritjen e rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë, diskutoni me kolegët:*

1. Si mund të integrohen rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë konkretisht në kuadër të fushës Jeta dhe puna/ lëndës mësimore, sipas niveleve arsimore.
2. Merrni shembuj në lëndën tuaj dhe në nivele të ndryshme të planifikimit **dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies.**

Fusha e kurrikulës/Lënda mësimore: **Jeta dhe puna/**

Klasa: \_\_\_\_\_

Tema: \_\_\_\_\_ (mund të merret nga programi i lëndës)

Rezultati i të nxënit: \_\_\_\_\_ (duhet të jetë rezultat i të nxënit i lidhur me temën e përcaktuar)

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë që synohen të arrihen:

---

---

Përshkrimi i anës praktike gjatë punës me nxënësit për arritjen e rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë:

---

---



### 2.3.3. Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe arritja e tyre

Rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të fushës përkatëse dhe janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore – temave mësimore për lëndë dhe rezultateve të të nxënit për lëndë mësimore.

*Konceptet janë shtylla përmbajtjesore, rreth të cilave organizohet e gjithë përmbajtja mësimore e fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare. Ato janë të pranishme në klasat e shkallës kurrikulare. Fuqia e prezencës së tyre në periudha të ndryshme kohore, brenda një viti shkollor të një klase të caktuar, por edhe të klasave të ndryshme të shkallës së njëjtë, mund të jetë e larmishme.*

Për secilën fushë përcaktohen rezultatet e të nxënit, të cilat mundësojnë zhvillimin e kompetencave kryesore. Rezultatet e të nxënit sipas fushave sigurojnë:

- Zhvillimin e kompetencave përmes një tërësie të përbashkët përvojash mësimore të ndërlydhura.
- Lidhjen ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore, që realizohen në kuadër të një fushe të kurrikulës, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve, që mundësojnë këto lëndë.
- Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel shkolle.

#### Arritja e rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare (RNF)?

Rezultatet e të nxënit të një fushe kurrikulare arrihen deri në fund të klasës që është fundi i shkallës së kurrikulës. P.sh. rezultatet e fushës Gjuhët dhe komunikimi, në shkallën e parë, duhet të arrihen deri në fund të klasës së dytë. Arritja e rezultateve të fushës është e lidhur ngushtë me procesin e zbatimit të programeve lëndore për klasë.

Për të siguruar zbërthimin dhe përfshirjen e rezultateve të fushës në programet lëndore, MASHT ka formuar grupet punuese për hartimin e programeve lëndore për klasë. Grupet punuese gjatë hartimit të programeve lëndore për klasë janë mbështetur në Dokumentet e kurrikules (KK dhe KB), respektivisht në fushën kurrikulare Jeta dhe puna – konceptet e fushës dhe përshkrimin e tyre, rezultatet e të nxënit të fushës dhe në udhëzimet metodologjike<sup>3</sup>.

<sup>3</sup>Detajet për programet lëndore ofrohen në kapitullin e tretë të këtij udhëzuesi.

Zbërthimi dhe përfshirja e rezultateve të fushës në programet lëndore, është vetëm hapi i parë, i cili nuk siguron arritjen e këtyre rezultateve. Lidhja ndërmjet lëndëve dhe veprimtarive mësimore që realizohen në shkollë, në kuadër të një fushe të kurrikulës, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që mundësojnë këto lëndë, si dhe zbatimi i praktikave të reja të mësimdhënies në nivel klase/shkolle, janë veprimet kryesore që sigurojnë arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare.

Për arritjen e rezultateve të të nxënit për fushë kurrikulare (RNF), brenda shkallës përkatëse të kurrikulës, kërkohet që të gjithë mësimdhënësit që japin mësim në lëndët mësimore që mbulon fusha e kurrikulës të bashkëpunojnë ngushtë ndërmjet vete, në të gjitha fazat e procesit mësimor, t'i përdorin ato gjatë planifikimit mësimor, të përzgjedhin metoda, teknika dhe mjete të përshtatshme didaktike që sigurojnë arritjen e të gjitha rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore për shkallë të kurrikulës.

Arritja e rezultateve të fushës kurrikulare, bëhet përmes lëndëve të fushës por edhe në korrelacion me lëndët tjera dhe me kurrikulen me zgjedhje. Të gjitha programet e lëndëve mësimore që zhvillohen në klasat që i mbulon shkalla përkatëse e kurrikulës, duhet të kontribuojnë bashkërisht në arritjen e rezultateve të fushave kurrikulare. Secila lëndë mësimore, brenda secilës klasë, në planifikimet mësimore duhet të fiksojë rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare që do të synojë t'i arrijë për secilën klasë. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të një fushe kurrikulare të jenë pika synuese për disa lëndë mësimore, por mund të ndodhë që ndonjë rezultat i të nxënit të një fushe të përzgjidhet nga një lëndë mësimore e vetme.

Rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare që janë fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore, si *Matematika, Edukata fizike, sportet dhe shëndeti, Shoqëria dhe mjedisi (në nivelin e parë)*, si dhe të disa fushave kurrikulare që realizohen brenda një lënde mësimore në nivelin e parë të arsimit: *Shkencat natyrore - Njeriu dhe natyra dhe Jeta dhe puna - Shkathtësi për jetë*, realizohen me zhvillimin e programeve mësimore brenda klasave sa i ka një shkallë e kurrikulës. Edhe në këto situata, secila lëndë mësimore brenda secilës klasë duhet të fiksojë në planifikimet mësimore për klasë rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare që do të synojë t'i arrijë për secilën klasë, në mënyrë që arritja e rezultateve të fushës të jetë e plotë, në përfundim të shkallës përkatëse.

**Aktivitet:**

*Pasi që t'i keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për arritjen e rezultateve të të nxënit për fusha kurrikulare, diskutoni me kolegët: Si mund të integrohen rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare në nivele të ndryshme të planifikimit dhe metodologjisë së mësimdhënies dhe nxënies në lëndën/lëndët që ju i mbani?*

**Përgatitni një orientim në pikat në vijim:**

Fusha e kurrikulës/Lënda mësimore: **Jeta dhe puna**

Klasa: \_\_\_\_\_

Tema: \_\_\_\_\_ (mund të merret nga programi i lëndës)

Rezultati i të nxënit: \_\_\_\_\_ (duhet të jetë rezultat i të nxënit i lidhur me temën e përcaktuar)

Rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare që synohen të arrihen:

---

---

---

Përshkrimi i anës praktike gjatë punës me nxënës për arritjen e rezultateve të të nxënit të

fushës:

---

---

---

---

### **III. PROGRAMET MËSIMORE LËNDORE - funksioni dhe organizmi i tyre**

**Ky kapitull përqendrohet në planifikimet e procesit mësimor, si:**

- Qëllimi i programeve mësimore
- Lidhja e programeve mësimore me konceptet e fushës me rezultatet e të nxënit të fushës
- Temat dhe rezultatet e të nxënit
- Udhëzimet metodologjike në programet mësimore

Programet mësimore janë bazë e organizimit të procesit mësimor-edukativ në kuadër të lëndës mësimore, për çdo nivel arsimor dhe shkallë përkatëse të kurrikulës.

Për secilën lëndë mësimore janë përcaktuar temat mësimore dhe rezultatet e të nxënit, të cilat e orientojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënit në zhvillimin e kompetencave kryesore.

Rezultatet e të nxënit për lëndët mësimore sigurojnë:

- Zhvillimin e kompetencave përmes një tërësie të përbashkët përvojash mësimore të ndërlidhura.
- Lidhjen/koherencën ndërmjet temave dhe veprimtarive mësimore, që realizohen në kuadër të një lënde mësimore, me synim integrimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që mundësojnë këto tema në funksion të arritjes së rezultateve të fushës kurrikulare.
- Fokusin e planifikimit mësimor në rezultate të të nxënit.
- Zbatimin e praktikave të reja të mësimdhënies në nivel të lëndëve të fushës, në nivel klase/shkolle.

Secila lëndë mësimore, nga pikëpamja e organizimit të materialit, paraqitet sipas formatit të mëposhtëm:

1. Hyrja
2. Qëllimi
3. Temat dhe rezultatet e të nxënit
4. Udhëzimet metodologjike
5. Udhëzimet për vlerësim
6. Udhëzimet për materialet dhe burimet mësimore
7. Udhëzimet për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

## **Realizimi i programeve lëndore**

Programi lëndor duhet të realizohet gjatë një viti mësimor. Gjatë kësaj periudhe nxënësit duhet t'i arrijnë rezultatet e të nxënësve të lëndës për tema mësimore dhe të kalojnë nëpër çështje ndërkurrikulare që ndërlidhen me temat mësimore. Gjithashtu aktivitetet mësimore, që realizohen në formë të njësive mësimore, duhet të synojnë zhvillimin e kompetencave të parapara në KB për shkallën kurrikulare, pjesë e së cilës është klasa në të cilën mësimdhënësi punon.

Njësitë mësimore pos që duhet të jenë në funksion të RNL të temës, ato duhet të ndërlidhen edhe me temat, njësitë mësimore të lëndëve të tjera –koncepteve, moduleve brenda fushës dhe me fushat tjera kurrikulare në mënyrë që të sigurohet mësimdhënia e integruar. Realizimi i aktiviteteve, respektivisht njësive mësimore për bazë duhet të kenë situatat jetësore-ndërlidhjen me jetën, natyrën, punën dhe veprimtari të ndryshme shoqërore dhe natyrore.

Në funksion të RNL dhe ndërlidhjes me Çështjet ndërkurrikulare, me lëndët mësimore dhe me situata jetësore duhet planifikuar mësimdhënien, nxënien, materialet mësimore dhe vlerësimin e nxënësve e të vet punës së mësimdhënësve, më qëllim të zhvillimit dhe përmirësimit të nxënies së nxënësve dhe mësimdhënies së mësimdhënësve.

Programi lëndor i fushës *Jeta dhe Puna* duhet të përfshijë të gjitha konceptet/module/lëndët që i përkasin asaj fushe, në nivelin përkatës p.sh:

Në Nivelin 2 Shkalla 3, Klasa e 6-të Lënda : Teknologji duke përfshirë TIK-un paraqet në vete 4 konceptet kryesore si:

- Këshillimi dhe orientimi për karrierë
- Teknologjia duke përfshirë TIK-un
- Puna dhe edukimi për ndërmarrësi
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

Konceptet e fushës kurrikulare së bashku me rezultatet e të nxënësve për fusha kurrikulare na ndihmojnë në përzgjedhjen e përmbajtjes mësimore (temave mësimore) për fushën kurrikulare për secilën klasë, sa ka shkalla kurrikulare

***Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha konceptet/modulet/lëndët mësimore brenda një fushe kurrikulare, gjatë periudhave të caktuara kohore të një viti shkollor.***

## **Udhëzimet metodologjike-**

Metodologjia e mësimdhënies dhe e nxënies përkufizohet si: sistem i strategjive, i metodave, i mënyrave e parimeve, i mjeteve e teknikave, të cilat na shërbejnë si bazë për ndërtimin e konceptit të mësimi. ose për organizimin e dhënies së mësimi në shkollë.

Andaj, secila Fushë duhet të përshtatë metodologjitë adekuate për lëndët e saja.

### **Udhëzimet për vlerësim**

Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënit në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNK-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime, duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB-të (Kapitulli VII). Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe në fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve që janë paraparë me planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e **vlerësimit të vazhdueshëm**, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor, bëhet **vlerësimi përfundimtar** në nivel klase dhe për secilën fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore, nxënësit i vihet nota - numër, siç është paraparë në KB-të.

Fusha kurrikulare *Jeta dhe puna* për shkak të natyrës dhe specifikeve që ka, kërkon shumëllojshmëri të mënyrave të vlerësimit në baza të rregullta, ndërsa fokusi është mbi të kuptuarit e jetës dhe punës, konceptet dhe praktikimi i sjelljeve dhe qëndrimeve pozitive. Me fjalë të tjera, nxënësit duhet të jenë në gjendje të vazhdueshme dhe në mënyrë aktive t'i zbatojnë njohuritë e mësuara në praktikë, gjatë jetës së tyre të përditshme.

### **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Materialet mësimore tashmë sidomos te fusha *Jeta dhe puna* mund të përdoren në formë elektronike në secilën lëndë. Material mund të jetë dhe puna e nxënësit e demonstruar një vit më përpara ose një detyrë më përpara.

Materialet ricikluese, letra, druri, metali etj., mund të përdoren për krijimin e aktiviteteve të ndryshme në një njësi mësimore.

Burimet ku mësimdhënësi duhet të qaset fillimisht janë librat shkollor, por pa anashkaluar dhe materialet ndihmëse të mësimdhënësit edhe të nxënësit për të përmbushur kërkesat e Kurrikulës së re (RNK dhe RNF).

## Aktivitet praktik

Përgatitni një orientim në pikat në vijim:

Fusha e kurrikulës/Lënda mësimore: Jeta dhe puna

Klasa: \_\_\_\_\_

Tema: \_\_\_\_\_ (mund të merret nga programi i lëndës)

Rezultati i të nxënit: \_\_\_\_\_ (duhet të jetë rezultat i të nxënit i lidhur me temën e përcaktuar)

Aktiviteti apo njësia mësimore në funksion të rezultatit të lëndës për temën e planifikuar:

---

---

---

Përshkrimi i aktivitetit apo njësisë mësimore që ndihmon arritjen e RNL për temë

---

---

---

Përshkrimi i ndërlidhjes me çështjen ndërkurrikulare, me lëndët tjera dhe më situatat jetësore:

---

---

---

---

## V. KURRIKULA ME ZGJEDHJE – ZBATIMI NË PRAKTIKË

Kurrikula me zgjedhje është pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar. Ajo trajtohet në kurrikulat bërthamë për tri nivelet e arsimit parauniversitar, në kapituj të veçantë, dhe është e përfshirë në planin mësimor të çdo klase.<sup>4</sup> Kurrikula me zgjedhje sikurse edhe kurrikula bërthamë, duhet t'i shërbejë zhvillimit të kompetencave kryesore.

Për dallim nga kurrikulat bërthamë dhe programet mësimore, të cilat hartohen nga grupet punuese të udhëhequra nga MASHT, hartimi i programit të kurrikulës me zgjedhje mbetet kompetencë e shkollës - mësuesve. Hartimi dhe realizimi i saj bëhet në përputhje me planin mësimor të përcaktuar nga MASHT-i për kurrikulën me zgjedhje, me mundësitë, nevojat, interesat e nxënësve dhe të komunitetit, duke pasur në konsideratë mundësitë kuadrore të shkollës dhe të komunës.

Për Kurrikulën me zgjedhje është përgatitur një udhëzues i veçantë dhe udhëzimi administrativ, të cilët ofrojnë orientime dhe udhëzime të detajuara për përzgjedhjen, hartimin dhe realizimin e saj.<sup>5</sup>

Në këtë udhëzues ofrohen vetëm informacionet themelore për:

- qëllimin e kurrikulës me zgjedhje,
- organizimin e kurrikulës me zgjedhje,
- aspektet kryesore për përgatitjen e një programi mësimor me zgjedhje, dhe
- orientimet për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje.

### Qëllimi

Qëllimi i kurrikulës me zgjedhje është që nxënësve t'u ofrohen mundësi më të mëdha për të përmbushur vetën me dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në përputhje me mundësitë, nevojat dhe interesat e tyre, drejt zotërimit të kompetencave të përcaktuara me KK, përkatësisht arritjes së rezultateve të nxënësve për kompetenca për shkallë kurrikulare. Në këtë kontekst Kurrikula me zgjedhje nxënësve u mundëson të thellojnë dhe zgjerojnë njohuritë, të zhvillojnë shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat:

- në fushat/lëndët mësimore të përcaktuara në dokumentet kurrikulare
- në lëndët e reja<sup>6</sup> që nuk janë paraparë në dokumentet kurrikulare
- në temat që kanë lidhje me çështjet shoqërore, kulturore dhe natyrore, dhe

---

<sup>4</sup> Gjatë një viti shkollor nxënësit e një klase mund të marrin një apo dy programe mësimore qoftë lëndë, modul a projekt.

<sup>5</sup> Shih, Udhëzuesin për planifikim dhe zbatim të kurrikulës me zgjedhje, MASHT, Prishtinë, 2016; dhe Udhëzimin administrativ me këtë emërtim: **UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR. 32/2013 Organizimi i kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar**

<sup>6</sup> Emërtimi bëhet sipas përmbajtjes dhe funksionit të programit.



- në temat që janë me interes për nivelin lokal dhe ndërkombëtar.

### **Organizimi i kurrikulës me zgjedhje**

Sipas përcaktimeve të vendosura në kurrikulat bërthamë, Kurrikula me zgjedhje mund të organizohet si lëndë mësimore, si modul ose si projekt. Organizimi i Kurrikulës me zgjedhje në lëndë mësimore apo modul, duhet të bëhet me strukturë të njëjtë si programet e lëndëve mësimore të obligueshme. Ndërsa, projekti mësimor me zgjedhje organizohet në bazë të specifikave të përmbajtjes dhe funksionit të projektit.

Përzgjedhja dhe miratimi i lëndëve mësimore, i moduleve apo i projekteve që dalin nga Kurrikula me zgjedhje bëhet sipas udhëzimit administrativ për organizimin e Kurrikulës me zgjedhje, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

### **Përmbajtja e Kurrikulës me zgjedhje**

Përmbajtja e Kurrikulës me zgjedhje dallon nga forma e organizimit, thellësia dhe gjerësia e trajtimit të tematikës në përputhje me veçoritë e klasës për të cilën përgatitet Kurrikula me zgjedhje. Pavarësisht dallimeve në formën e organizimit, përmbajtja dhe rezultatet e të nxënit të Kurrikulës me zgjedhje, e orientojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënit në zhvillimin e kompetencave kryesore.

Në interes të nxënësve përgatitet Kurrikula me zgjedhje për ndonjë lëndë të kurrikulës bërthamë, por me përmbajtje shtesë që i kontribuon arritjes së rezultateve të të nxënit për lëndë dhe zhvillimit të kompetencave kryesore. P.sh. për gjuhën amtare, gjuhën angleze, matematikën ose për lëndët tjera mësimore. Ose, mund të futen në zbatim programe mësimore të reja të miratuara nga MASHT-i dhe të ndërlidhura me Kurrikulën bërthamë e që shkolla mund t'i zgjedh.

Kurrikula me zgjedhje mund të organizohet në module mësimore me zgjedhje, të cilat mund të jenë të ndryshme. P.sh: aftësitë për jetën, etika, mbrojtja e ambientit, arte, zgjidhja e konflikteve, trashëgimia, muzika ritmike, drama, ekonomia shtëpiake, përdorim i softverve kompjuterik, edukimi për të drejtat e njeriut, etj.

Kurrikula me zgjedhje mund të realizohet në formë të projektit mësimor, përmes mësimdhënies dhe nxënies hulumtuese, krijuese dhe zgjidhjes së problemeve të caktuara.

### **Aspektet kryesore për përgatitjen e një programi mësimor me zgjedhje**

Korniza e përgjithshme e përgatitjes së një programi mësimor me zgjedhje duhet të jetë si vijon:

*Përshkrimi i lëndës/modulit:* Këtu përshkruhen (skicohen) veçoritë kryesore të lëndës me katër-pesë fjali (veçoritë kryesore dhe risitë). Çka e bën atë të veçantë krahasuar me lëndët e tjera?

*Qëllimi i lëndës/modulit:* Pse hartohet kjo lëndë ? Për çka shërben ajo? Çka sjellë të re kjo lëndë?

*Rezultatet mësimore:* Çfarë ndryshimesh sjell lënda në dijen, sjelljen, qëndrimet dhe në shkathtësitë e nxënësve? Çka do të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit në fund të lëndës?

*Njësitë tematike – orët mësimore:* Përmes cilave përmbajtje / aktivitete do të realizohet lënda në shkollë? Sa orë do të duhen për realizimin e secilës prej tyre? Cilat aktivitete parashihen për nxënësit? A parashihen aktivitete jashtë klasës? Aktivitete jashtëshkollore? Sa orë mësimore do të zgjasë lënda?

*Prezantim i qasjeve / metodave të punës:* Tregoni cilat metoda / strategji do të aplikoni për të zhvilluar lëndën / modulën? A parashihni angazhimin e ndonjë ligjëruesi mysafir? Si do ta organizoni realizimin e lëndës?

*Format e angazhimit të nxënësve:* Cili është roli i nxënësve në realizimin e lëndës / modulit? Çfarë angazhimesh priten prej tyre? Detyrat? Projektet? Sfidat? Zgjidhjet e problemeve?

*Format e angazhimit të prindërve / komunitetit:* A parashihni ndonjë rol për prindërit / komunitetin? Si mund ta bëjnë ata kursin / modulën më atraktiv dhe më të afërt për nxënësit? Si mund të ndihmojnë ata për ta lidhur me mirë kursin me realitetin e përditshëm? Si do të shfrytëzohen shkathtësitë / specializimet e prindërve për të ofruar të mësuar më të mirë?

*Vlerësimi (për të nxënë - i të nxënësve):* Si do ta realizoni vlerësimin, në mënyrë që ai të jetë në funksion të të nxënësve më të mirë? Si mendoni të realizoni vlerësimin periodik? Po atë përfundimtar?

*Materialet mësimore:* Cilat tekste shkollore / materiale mësimore / teknologji arsimore / teknologji informative / medie / materiale nga përditshmëria parashihni të përdorni në realizimin e lëndës?

## **Planifikimi i Kurrikulës me zgjedhje**

Zhvillimi i programit mësimor me zgjedhje përbën bazën themelore për të filluar planifikimin për zbatimin në praktikë. Planifikimi fillon pasi që nxënësit kanë marrë programin/programet mësimore për klasën dhe vitin shkollor përkatës. Planifikimi bëhet në përputhje me hapat dhe procedurat e përshkruara në udhëzuesin për Kurrikulën me zgjedhje dhe në përputhje me udhëzimet.



#### IV. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË FUSHËS KURRIKULARE „JETA DHE PUNA”

**Ky kapitull përqendrohet në planifikimet e procesit mësimor, si:**

- Planin mësimor
- Planin vjetor
- Planin dymujor
- Planin javor
- Planin e orës mësimore
- Planifikimi i çështjeve ndërkurrikulare dhe veprimtarive jashtëkurrikulare

##### 5.1. Plani mësimor

- Fusha kurrikulare / Lënda mësimore Jeta dhe puna
- Orë mësimore

Para se të bëhet planifikimi më i detajuar i procesit mësimor (planifikimit vjetor, mujor) për një vit shkollor, së pari duhet përcaktuar saktë planin mësimor për klasën përkatësisht vitin shkollor (mësimor).

Në kurrikulat bërthamë të tri niveleve të arsimit parauniversitar ekziston liria, në një masë të caktuar, për organizimin e planit mësimor brenda fushave kurrikulare. P.sh shiko KB-në e nivelit II shkolla e mesme e ulët (klasat VI-IX f 82, 87-89). Shkollat, mësimdhënësit janë të lirë të lëvizin numrin e orëve brenda fushës së njëjtë të shkallës kurrikulare nga klasa në klasë apo nga gjysmë vjetori në gjysmë vjetor dhe të bëjnë ndarjen e orëve mësimore në mes të lëndëve të ndryshme mësimore, brenda fushës së njëjtë kurrikulare, gjatë një viti shkollor, apo për të gjitha klasat sa ka shkalla kurrikulare.

**Por, kujdes!** Nuk duhet tejkaluar totali i fondit javor që është caktuar me Kurrikulën bërthamë (të nivelit të caktuar) për secilën fushë, për secilën shkallë dhe secilën klasë.

##### Shembulli

Në shkallën e tretë, klasa e 6-të dhe e 7-të, sipas planit mësimor, fusha kurrikulare Jeta dhe puna, i kanë nga 4 orë mësimore për lëndën e Teknologjise me TIK, duke përfshirë konceptet Edukim për zhvillimin të qëndrueshëm, ndërmarrësi dhe orientim në karrierë. Faktikisht janë nga 2 orë për vit, 2 orë (për të gjitha lëndët/konceptet) për kl. 6-të dhe 2 orë të tjera për kl. 7-të (për të gjitha lëndët/konceptet). Por, shkolla, mësimdhënësit kanë liri të plotë që së pari të vendosin vetë se këto 4 orë, që janë përcaktuar për këtë fushë, për këtë shkallë, ta ndajnë nga 2 orë për vit (klasë) apo të vendosin edhe ndryshe, p.sh. në një vit të kenë p.sh. 3 orë e në vitin tjetër 1 orë. Por, gjithmonë duke u harmonizuar me fushat e tjera mësimore që të mos kalohet total i orëve javore për atë vit shkollor që është caktuar nga MASHT-i. Krahas kësaj mundësie, shkollat dhe mësimdhënësit e fushës mund të pajtohen që një lëndë të caktuar, p.sh. Teknologji, brenda numrit të përgjithshëm të orëve, të fushës, për klasën e caktuar, t'i japin më shumë hapësirë. Kjo mund të bëhet me kusht, që brenda fushës të ruhet balanca, kështu në klasën tjetër të shkallës, lëndës/konceptet tjera të fushës, p.sh. në këtë rast TIK-ut,

t'i jepet më shumë hapësirë (orë mësimore). Në harmonizimin e planit mësimor gjithashtu duhet pasur parasysh **prioritetin** që u japin rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare, lëndëve mësimore. Pra, nëse në një klasë (vit të caktuar) rezultatet e përzgjedhura nga mësimdhënësit i përshtaten më shumë p.sh. lëndës së Teknologjisë, atëherë në atë klasë (vit mësimor) i jepen më shumë orë kësaj lënde dhe anasjelltas në vitin tjetër p.sh. rezultatet i përshtaten më shumë lëndës TIK, atëherë kësaj lënde i jepen më shumë orë mësimore.

Gjithsesi është e nevojshme që mësimdhënësit të përcaktojnë së bashku mënyrën e zbatimit të planit mësimor. Këtë duhet ta bëjnë në bazë të kriterëve për hartimin e planit mësimor dhe mundësive të zbatimit të tij sipas udhëzimeve që janë dhënë në KB-të për secilin nivel. P.sh shiko KB-në e nivelit II, mësimi i mesëm i ulët (klasat VI-IX f. 90).

Planin e orës mësimore, mësimdhënësit e shkollës fillore, mund ta bëjnë në **bashkëpunim me kolegët** e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mund ta bëjnë edhe në mënyrë të pavarur, sepse një mësimdhënësi është përgjegjëse vetëm për një paralele. Mirëpo, bashkëpunimi gjithëherë është më produktiv!

#### **Aktivitet:**

*Pasi që të keni lexuar, diskutuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për planin mësimor, diskutoni me kolegët e fushës së kurrikulës **Jeta dhe puna** dhe përgatitni një plan mësimor për lëndët/konceptet mësimore për të dy shkallët e nivelit të dytë të arsimit, shkallën 3 (klasat 6-të dhe 7-të) dhe shkallën 4 (klasat 8-të dhe 9-të) dhe përgatitni një arsyetim për ndarjen e orëve në vite.*

## **5.2. Plani vjetor**

*Plani vjetor përmban këto elemente:*

- *Rezultatet e kompetencave (rezultatet e të nxënimit për shkallën e caktuar);*
- *Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor. Temat shpërndahen (organizohen) në 3 periudha, ku çdo periudhë përmban 2 cikle dymujore;*

**Plani vjetor** është dokument, i cili e orienton zhvillimin e mësimimit për një vit shkollor duke i përbushur kërkesat e shkollës kurrikulare, duke i ndarë apo duke i thjeshtuar e përshtatur për klasën e caktuar. Ai hartohet për secilën fushë kurrikulare, pra edhe për fushën Jeta dhe puna, dhe ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënimit të kompetencave, të cilat mund të jenë synim arritjeje gjatë një viti shkollor (mësimor). Pastaj, identifikimin e koncepteve dhe rezultateve të të nxënimit të fushave kurrikulare nga të cilat do të përcaktohen përmbajtjet mësimore në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënimit të fushës kurrikulare dhe të rezultateve të të nxënimit të kompetencave të identifikuar. Ky planifikim mbështetet në programin lëndor të fushës kurrikulare të hartuar nga MASHT-i, në bashkëpunim me ekspertët e kësaj fushe.

**Shembull:** Hapat që duhet ndjekur për planifikimin vjetor, klasa e VI

Hapi 1-rë →	Hapi 2-të →	Hapi 3-të →	→ Hapi 4-të
Programi lëndor	Periudhat mësimore	Tema mësimore	RNK –kompetencat
Teknologji me TIK	Periudha I Shtator-Tetor & Nëntor-Dhjetor	Teknologjia e informimit dhe komunikimit  (Kompjuteri, njësitet qendrore, hardwerat, softwerat, Sistemi operativ).	I.1, II.1,.....

U mbetet mësimdhënësve se me çfarë hapash vendosin të bëjnë planifikimin. Ata mund të planifikojnë duke i ndjekur hapat si në tabelën më lart, por edhe mund të vendosin që hapin e 4 ta vendosin të parin e pastaj për të vijuar me hapat 1, 2 dhe 3.

Përmbajtja mësimore duhet të jetë në funksion të mësimdhënies se integruar, brenda fushës kurrikulare (Jeta dhe puna), por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Puna me tema të përbashkëta mësimore, brenda fushës kurrikulare dhe lidhshmëria me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare, janë në linjë të mësimdhënies dhe të nxënies së integruar.

Temat mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore/konceptet brenda një fushe kurrikulare.

**Shembull:** Edhe pse fusha e kurrikulës Jeta dhe puna përbëhet prej disa lëndëve mësimore, si p.sh. Teknologji dhe TIK, në shkallën e tretë, temë e përbashkët mund të jetë p.sh. **Shkathësitë e të punuarit**. Sado që dy lëndët mund të trajtojnë çështje të ndryshme, tema e njëjtë përcakton që nxënësit duhet të zotërojnë shkathësitë e punës, qoftë në përdorimin e mjeteve, veglave të punë si çekani, kaçavida, sharra, gërshërët, në lëndën e Teknologjisë ose njohja e pajisjeve si shtëpiza, monitori, pllaka amë, hardisku, si dhe zotërimi i programeve softuerike që janë shkathësi të nevojshme për lëndën e TIK-ut.

Gjatë identifikimit të rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare Jeta dhe puna, mësimdhënësit mund të hasin në rezultate që i përshtaten më shumë një lënde mësimore apo koncepti; në këtë rast ndonjë temë mësimore mund t'i dedikohet vetëm një lënde/koncepti mësimore, por është qasje e KKK-së drejt mësimdhënies dhe nxënies së integruar. Prandaj, duhet synuar përcaktimin e temave mësimore të cilat janë reprezentative për të gjitha lëndët/konceptet mësimore të fushës kurrikulare (Jeta dhe puna).

Temat mësimore mund të jenë të pranishme disa muaj gjatë vitit shkollor (mësimor), por mund të ketë raste që të jenë të pranishme edhe gjatë tërë vitit shkollor, apo madje edhe gjatë disa viteve shkollore, brenda shkallës së njëjtë. Kjo varet nga nevojat e nxënësve dhe nga rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare. Shiko shembullin më poshtë në fushën

kurrikulare *Jeta dhe puna*. Nëse një temë është e përfshirë më shumë se një dymujorësh ose gjatë tërë vitit, është me rëndësi që të caktohen nëntemat të cilat paraqesin përmbajtjet e ndara në çdo dymujore.

**Shembull:** Shpërndarja e temave mësimore gjatë dy muajve

RNK	RNF	Tema	Muajt
			I-II
I.1 ; I.2 III.2; VI.5	1,1.1,1.2, 3,3.1,3.2 4,4. KB –FQ 80	Teknika bujqësore dhe e ndërtimtarisë	√

Shpërndarja e temave mësimore gjatë tërë vitit mësimor


RNK	RNF	Tema	Muajt				
			IX -X	XI- XII	I- II	III- IV	V- VI
I.1 ; I.2 III.2; VI.5 KB – FQ 14...	1.1,2,2.1, 4,4.1 KB –FQ 80	Teknologjia e informimit dhe komunikimit	√	√	√	√	√

Me rastin e përzgjedhjes të temave mësimore duhet pasur parasysh përvojat, interesat dhe mundësitë e nxënësve.

**Shembull:** Në klasën e gjashtë fillohet me temat që janë të afërta me nxënësin, tema të cilat lidhen me praktikën në përditshmërinë e jetës së tyre, Përpunimi i letrës, kartuçit, drurit, për të vazhduar, më pas, me punën praktike në ndërtimin e objekteve nga druri dhe letra. Apo p.sh. në lëndën Teknologji, në klasën e gjashtë, përmbajtja Energjia elektrike si burim dhe pjesë bazë ndërlihet pastaj me klasën e shtatë dhe lehtësohet kuptimi i saj më shumë sesa vetëm në njërin klasë. Kjo mundëson që pjesët praktike t'i fillojmë me zbatim të energjisë së thjeshtë në klasën e gjashtë që ndërlihet me drurin dhe letrën. Ndërsa, në klasën e shtatë mund të vazhdohet përdorimi i materialeve nga druri për nivel më të lartë të arritjes së temave mësimore.

Për secilën temë mësimore duhet caktuar edhe rezultatet e të nxënësve për shkallë kurrikulare (kompetencë) të synuara të arrihen nga tema në fjalë. Rezultatet e të nxënësve mund të shënohen me numra, ashtu siç janë në KB për shkallën përkatëse. Për çështje praktike edhe rezultateve të të nxënësve të fushës kurrikulare mund t'u vendoset nga një numër dhe temës mësimore që korrespondon me të.

Me rastin e planifikimit vjetor mund të shfrytëzohen burime të ndryshme që ndihmojnë përshtatjen e temave mësimore të përzgjedhura me moshën e nxënësve dhe aspektet pedagogjike. Duhet të kihet parasysh identifikimi i burimeve bazë për nxënës që janë në funksion të arritjes së kompetencave dhe rezultateve të fushës kurrikulare.



Temat mësimore pas përzgjedhjes shpërndahen në ciklet dymujore të planifikimit vjetor. Shih tabelën e planifikimit vjetor të procesit mësimor.

Në tabelën e planit vjetor të paraqitur më poshtë është marrë vetëm një periudhë kohore me temat përkatëse me të gjitha RNK adekuate.

Është me rëndësi të koordinohen temat në periudhat përkatëse duke mos anashkaluar dhe ndarjen e tyre në lëndët/konceptet përkatëse. Duke ditur se kompetencat synohen të arrihen në 2 vjet (klasa 6-të dhe 7-të) p.sh për shkallën e 3-të atëherë duhet të kemi kujdes që si fushë të përfshijmë sa më shumë tema të cilat përmbushin rezultatet e shkallës në të gjitha lëndët e një fushe.

Te fusha *Jeta dhe Puna* qëndrojnë dhe temat të cilat mbulojnë konceptin e ndërmarrësisë, këshillimit dhe orientimit në karriere dhe zhvillimin e qëndrueshëm të cilat duhet të përfshihen në periudhat përkatëse për të mbuluar sa më mirë kompetencat e synuara përmes fushës/lëndës.



P.sh. Viti shkollor 2016-2017, shkolla e mesme e ulët, klasa e gjashtë

## **PLANI VJETOR - 2016 /2017**

**Fusha e kurrikulës: JETA DHE PUNA\_\_\_ Klasa : VI**

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator-Tetor	Nëntor - Dhjetor	Janar-Shkurt	Mars – Prill (java I)	Prill - Maj	Qershor	
Lënda: Teknologji duke përfshirë TIK	1. Materialet dhe përpunimi i tyre 2. Njeriu dhe shoqëria në teknologji						<b>TEMA 1 dhe 2</b> I.1,2,3,4,5,6,8; II.2,3,6,7,8; III:1,2,3,7,8; IV.2,3,4,7; V.5 VI.1,2,3,6
Lënda:							

Preferohet që në tabelën e planifikimit vjetor të vendosen të gjitha lëndët/konceptet e një fushe kurrikulare, në mënyrë që lidhshmëria ndërmjet tyre dhe rezultatet e kompetencave të mund të kontrollohen dhe të krahasohen më lehtë. Kjo mundëson të ketë një pasqyrë të qartë të realizimit të rezultateve të të nxëniet të shkallëve kurrikulare/kompetencave.

Gjithashtu, temat mund të jenë të unifikuara në vite (në shkallë), p.sh nëse në klasën e VI tema është **Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia**, edhe në klasën e VII mund të jetë e njëjta temë ku p.sh. në Kl. VI nxënësi mëson format e energjisë dhe në Klasën e VII avancohen njohuritë dhe mësohet aplikimi i energjisë në praktikë.

### **Udhëzime për plotësim të tabelës**

#### **Udhëzimet hyrëse**

Ky format i tabelës/instrumentit të planit vjetor përdoret për të hartuar planet vjetore për të gjitha fushat e kurrikulës, lëndët mësimore dhe për secilën klasë.

Planifikimi i përbashkët në kuadër të *Departamentit profesional /Aktivit profesional/ Këshillit të klasave në nivelin fillor* është kusht themelor në procesin e planifikimit vjetor.

Planifikimi i përbashkët në kuadër të fushës kurrikulare, siguron një segment të rëndësishëm të qasjes së integruar dhe të zhvillimit të kompetencave kryesore/rezultateve të të nxëniet të shkallës (RNK). Në kontekstin e praktikës shkollore, planifikimi i përbashkët dhe organizimi i nxënies së integruar kërkon punë të përbashkët të mësimdhënësve, menaxhim fleksibil të

kohës në dispozicion dhe të hapësirës shkollore e mjeteve mësimore. Kurrikula e re kërkon integrimin e kompetencave profesionale të mësimdhënësve. Prandaj, Departamenti profesional/Aktivi profesional/ Këshilli i klasave duhet t'i shqyrtojë me kujdes përparësitë dhe mangësitë në punën e tyre, që të mund të planifikojë dhe zbatojë një plan vjetor që e ruan frymën e Kurrikulës së re - qasjen e bazuar në kompetenca.

### **Udhëzime për hapat që duhet ndjekur gjatë përgatitjes së planit vjetor**

**Hapi i parë – Përgatitja për planifikim.** Fillimi i procesit të planifikimit vjetor, kërkon pjesëmarrjen aktive të të gjithë mësimdhënësve të fushës përkatëse, sigurimin e dokumenteve të kurrikulës (Kurrikulën Bërthamë dhe programet lëndore) dhe të raporteve të punës nga klasa paraprake. Përgatitja e mirë për planifikim, siguron që mësimdhënësit gjatë planifikimit të mbështeten në programet lëndore të hartuara nga grupet punuese nën udhëheqjen e MASHT-it, në dokumentin e Kurrikulës bërthamë për nivelin - shkallën përkatëse të kurrikulës, planin mësimor për lëndë, në kohëzgjatjen e secilës nga tri periudhat e ndara për një vit mësimor dhe në nevojat e nxënësve për përkrahje në zotërimin e kompetencave kryesore.

**Hapi i dytë: Analiza përmbajtjesore.** Brenda Departamentit profesional /Aktivit profesional/ Këshillit të klasave për nivele, analizohen dhe shqyrtohen:

- përvojat e mësimdhënësve për temat e programeve lëndore të realizuara në vitet paraprake,
- temat e reja që për herë të parë fillojnë të zhvillohen në klasën dhe lëndën përkatëse,
- lidhja e temave mësimore me lëndët tjera brenda fushës së kurrikulës dhe me lëndët tjera,
- rendi logjik i trajtimit të temave përgjatë vitit mësimor,
- thellësia dhe gjerësia e trajtimit të temës në përputhje me veçoritë e klasës dhe stilet e të nxënësve,
- kohën mësimore minimale të përcaktuar me planin mësimor (orët e mësimimit që i ka secila lëndë mësimore brenda një viti shkollor),
- mundësitë që ofron shkolla për organizimin e orëve të mësimimit mbi kohën minimale,
- organizimin e mësimimit plotësues dhe shtues,
- ndarjen e vitit mësimor në tri periudha dhe mundësitë e realizimit të programit të lëndëve brenda secilës periudhë të vitit mësimor, etj.

**Hapi i tretë: Vendosja e temave në periudhën dymujore.** Brenda dy muajsh mund të jenë disa tema mësimore, 1, 2 apo me shumë tema, varësisht sa mësimdhënësit mendojnë se janë të nevojshme të trajtohen sipas programeve lëndore/koncepteve. Disa tema mund të jenë të pranishme edhe në muajt e tjerë, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të behet mbi analizën dhe konkluzionet e bëra në hapin e dytë.

**Hapi i katërt: Vendosja e numrit të orëve mësimore për tema mësimore.** Mësimdhënësi duhet të konsultojë planin mësimor për klasë dhe lëndë mësimore, të miratuar nga MASHT-i. Vendosja e numrit të orëve mësimore bëhet në bazë të konkluzioneve të bëra nga hapi i dytë, përkatësisht nga rezultatet e të nxënësve për temë. Vendosja e orëve mësimore për tema mësimore në kuadër të planifikimit vjetor mund të jetë orientuese dhe fleksibile me mundësi ndryshimi gjatë zbrërthimit të planeve dymujore. Vendosja e orëve mësimore për tema në këtë

fazë siguron një pasqyrë të mbulueshmerisë së programit mësimor, brenda kohës mësimore në dispozicion që ka secila lëndë mësimore dhe brenda kalendarit të vitit mësimor.

### **Hapi i pestë: Vendosja e rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës.**

Në kolonën për kontributin në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca që mendohet se duhet të arrihen përmes temave që zhvillohen përgjatë gjithë vitit mësimor, apo që zhvillimi i këtyre temave i kontribuon arritjes së rezultateve të të nxënit të vendosura për këtë periudhë. Këto rezultate mund t'i gjeni te rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare. Për çështje praktike, në kolonën Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, rezultatet mund të shënohen me numra origjinalë siç janë në KB. Por, gjatë planifikimit duhet të kuptohet në esencë rezultati i kompetencës, në mënyrë që të mund të bëhet ndërlidhja me segmentet e tjera të planifikimit. Mësimdhënësi, rezultatet e kompetencave, synon t'i arrijë përmes lëndës mësimore, fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temave mësimore. Të gjitha lëndët mësimore, për sa klasë që ka shkalla, duhet të synojnë të arrijnë të gjitha rezultatet e kompetencave, d.m.th. nëse shkalla i ka dy klasë atëherë për dy vite shkollore-mësimore një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën bërthamë. Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e shkallës (kompetencës) do të synojë t'i arrijë p.sh. në klasën e gjashtë, e cilat në klasën e shtatë. Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetence mund të synohet të arrihet në dy klasa radhazi. Kjo i mbetet mësimdhënësit të vendosë.

**Kujdes! Rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës**

### **Të rikujtojmë procedurat e nevojshme për plotësim të tabelës**

- Tabela punohet nga **Departamentet profesionale /Aktivet profesionale** të shkollës/ Këshilli i klasave. Për secilën fushë kurrikulare **punojnë bashkërisht mësimdhënësit** e lëndëve që i takojnë fushës kurrikulare. Kjo vlen për shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë.
- Në shkollën e parë dhe të dytë (shkollë fillore) **punojnë të gjithë mësuesit** e paraleleve, sa ka klasa e caktuar. Por, në këtë grup duhet të kontribuojë edhe një përfaqësues i secilës fushë kurrikulare të shkollës së mesme të ulët.
- Pasi që planifikimi vjetor punohet për lëndët mësimore në kuadër të fushës së caktuar dhe për klasën e caktuar, atëherë **mbledhet Këshilli i klasës** së caktuar dhe bashkërisht analizojnë planifikimin e secilës fushë kurrikulare dhe e vendosin në formatin e tabelës.
- Gjatë vendosjes në këtë tabelë përfaqësuesit e fushave, të klasës së caktuar (në shkollën fillore mund të jetë mësues klase) diskutojnë për përmbajtjen dhe kompetencat që synon t'i arrijë secila lëndë mësimore/fushë për klasën e caktuar, në mënyrë të sigurohet mbulueshmëria e plotë dhe e drejtë e arritjes së rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës dhe ndërlidhja në mes lëndëve mësimore /fushave, të jetë sa më e pranishme në planifikimet mësimore dhe në praktikat e mësimdhënies.

### 5.3. Plani dymujor

***Plani dymujor përmban këto elemente:***

Temat mësimore, RNK (kompetenca), RNF, korrelacionin dhe çështjet ndërkurrikulare, lëndët mësimore, rezultatet e të nxëniet për tema mësimore, njësitë mësimore, kohën e nevojshme, metodologjitë e mësimdhënies e të vlerësimit dhe burimet.

Plani dymujor mbështetet dhe del nga plani vjetor i procesit mësimor dhe ka formatin e një programi mësimor. Gjatë një viti shkollor (mësimor) bëhen pesë plane dymujor, të cilat mbështeten në planin vjetor të ndarë në 3 periudha mësimore.

Plani dymujor ka për qëllim zbërthimin e temave mësimore në njësi mësimore, të cilat kanë për synim arritjen e rezultateve të identifikuar të të nxëniet të shkallës kurrikulare (kompetencave) dhe të fushës kurrikulare për temën caktuar mësimore. Gjithashtu, ka për qëllim identifikimin e rrugëve (metodologjisë), mjeteve (materialeve) dhe burimeve për arritjen dhe vlerësimin e nivelit të arritjes së këtyre rezultateve. Elementet e planifikimit dymujor janë paraqitur në tabelën e emërtuar *Plani dymujor i procesit mësimor*.

Tema mësimore e përzgjedhur mund të ketë lidhshmëri edhe me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare. Këtë lidhshmëri duhet shikuar në planifikimin e përbashkët vjetor me fushat e tjera kurrikulare, me qëllim që të bëhet pjesë e planifikimit dymujor dhe kështu të mundësohet mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar.

***P.sh.*** Tema mësimore ***Shkathtësitë e të punuarit (punë praktike)*** e fushës *Jeta dhe puna* mund të ndërlidhet me fushën e Matematikës, përkatësisht me temën mësimore *Kahet e lëvizjes (që trajton elementet para, mbrapa, lart, poshtë, majtas, djathtas)*, me fushën *Gjuhët dhe komunikimi*, gjithashtu me fushën e *Shkencat natyrore*, konkretisht me përmbajtjet/temat *Forca, Energjia*. Por, lidhshmëri mund të ketë edhe me fushat e tjera kurrikulare.

Po ashtu, pjesë e planifikimit mund të jenë çështjet ndërkurrikulare, të cilat mund të korrespondojnë me temën e përzgjedhur. Shih pjesën çështjet ndërkurrikulare në KB - në përmbajtjen e secilës fushë kurrikulare.

***P.sh.*** Nëse për temë mësimore, në fushën kurrikulare *Jeta dhe puna* për dy muaj trajtojmë shkathtësitë në të punuar, atëherë mund të ndërlidhemi me çështjet praktike sa u përket shkathtësive për jetën, mbrojtjes së mjedisit ose të drejtave të njeriut (e drejta për punë).

Plani dymujor i temës mësimore u mundëson lëndëve mësimore të një fushe kurrikulare, përmes njësive mësimore, arritjen e përbashkët të rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, por secilës nga këndi i vet.

Zbërthimit të temës mësimore në njësi mësimore duhet t'i paraprijë zbërthimi i rezultateve të fushës kurrikulare, nga e cila ka dal tema mësimore, në rezultate për lëndë mësimore për klasën e caktuar, aty ku fusha kurrikulare realizohet përmes lëndëve mësimore. (p.sh. Jeta dhe puna; lëndët Teknologjia dhe TIK, nga Klasa e VI).

Tash për hartimin e planeve dymujore duhet direkt të bazohet në planprogramet lëndore, të cilat kanë të përcaktuar konceptin, RNF, temën dhe rezultatet e temës, ku nga mësimdhënësi kërkohet të bëjë kujdes në bartjen e këtyre elementeve në dymujorshit e caktuar.

### Shembull: Procesi i përcaktimit të njësive mësimore

Hapi 1-rë →	Hapi 2-të →	Hapi 3-të →	Hapi 4-të →	Hapi 5-të →
RNK (kompetenca)	RNF- Jeta dhe Puna	Tema mësimore	Rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore	Njësia mësimore
<b>Komunikues efektiv.</b> 1.7 Përdor programet softuerike për komunikim të drejtë në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit, qoftë për nevoja të veta apo si detyrë shkollore.	<b>I. Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b> I.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit	1. Shkruan tekste elektronike me Mavis beacon për të mësuar shkrimin me 10 gishta duke pozicionuar në shkronjat përkatëse. 2. Përdor lojërat e Mavis Beacon për zhvillimin e gjuhës angleze, matematikës në shumëzim, mbledhje, shprehje në gjuhën angleze.	Shkrimi i tekstit në formë elektronike dhe mësim i shkrimit me 10 gishta përmes Mavis Beacon.

Përzgjedhja e njësive mësimore, sikurse edhe e temave mësimore, bazohet në rezultatet e të nxënit, dhe duhet të jetë në përputhje me përvojat, mundësitë dhe interesat e nxënësve. Ato duhet të kenë ndërlidhje me jetën e përditshme.

### Tabela e planifikimit dymujor të procesit mësimor

Në këtë tabelë është paraqitur Tema: Njeriu dhe Shoqëria në teknologji në planin dymujor Shtator-Tetor ku ka të planifikuar orë mësimore.

Gjatë paraqitjes së planit janë shfaqur RNF e marra nga Programi lëndor dhe të gjitha njësitë, RNL që përkojnë me RNF dhe RNK për arritjen e tyre.

Burimet e informacionit për këtë temë janë marrë nga interneti që mund të themi se ka mjaft resurse ku mund të marrim çështje për përmbushjen e temave me materiale mësimore si dhe nga libri i Shqipërisë Aftësim Teknologjik 6 te shtëpisë botuese PEGI.

### Udhëzime për plotësim të pjesës narrative dhe tabelës

#### Pjesa narrative

#### Planifikimi

Plani dymujor, sipas këtij formulari, bëhet për një temë mësimore. Nëse brenda dy muajsh, në planifikim vjetor janë parapa dy apo më shumë tema, atëherë duhet për secilën temë të bëhet planifikimi. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular (tabelë).

**Temat mësimore:** Merren nga tabela e planifikimit vjetor të temave për lëndë mësimore sipas planifikimeve për dy muaj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës:** Nga planifikimi vjetor, merren vetëm ato rezultate të të nxënit që synohen të arrihen përmes temës/ve mësimore që zhvillohen gjatë periudhës dymujore. Tani rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion si është në Kurrikulën bërthamë. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate.

**Rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë kurrikulare:** Shënohen vetëm ato rezultate të të nxënit të fushës kurrikulare që në programin e lëndës mësimore janë pjesë e temave që zhvillohen brenda këtij planifikimi dymujor dhe që synohen të arrihen me realizimin e këtyre temave. Rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion, ashtu siç janë në programin e lëndës mësimore apo në Kurrikulën bërthamë. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate të synuara brenda një planifikimi dymujor.

### PLOTËSIMI I TABELËS

#### **Temat mësimore**

Barten nga pjesa narrative. Tabela plotësohet me kolona horizontale varësisht nga numri i temave në planin dymujor, në mënyrë që zbrërthimi i planit të bëhet për tema të lëndës mësimore.

#### **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**

Merren nga programi i lëndës, përkatësisht nga lista e rezultateve për tema mësimore në kuadër të programeve lëndore. Nëse një temë mësimore zgjatë më shumë se një periudhë dymujore e planifikimit, në tabelën e planit dymujor barten vetëm ato rezultate të të nxënit që duhet të arrihen përmes njësive mësimore që do të shtjellohen gjatë kësaj periudhe. Rezultatet tjera përfshihen në planifikimin tjetër dymujor. Rezultatet e temës së lëndës shënohen në origjinal, ashtu siç janë në kuadër të programit mësimor lëndor. Rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion si është në programin e lëndës. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate, varësisht sa ka tema dhe sa rezultate duhet të arrihen brenda kohës së planifikuar.

#### **Njësitë mësimore**

Njësitë mësimore përcaktohen dhe elaborohen për rezultatet e të nxënit të temës së planifikuar - në raport me kohëzgjatjen e saj. Numri i njësive mësimore përcaktohet nga vete mësimdhënësi. Mësimdhënësi përcaktohet për ato njësi mësimore që janë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të temës së lëndës dhe që i kontribuojnë arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës së caktuara për temën përkatëse. Një njësi mësimore mund të përfshijë disa rezultate, siç mundet që edhe një rezultat të zbrërthet në disa njësi mësimore (nëse shihet e nevojshme).

#### **Koha e nevojshme**

Mësimdhënësi duhet të konsultojë planin vjetor, gjegjësisht numrin e orëve të planifikuara për tema. Mësimdhënësi tani vendos sa kohë (orë mësimore) i nevojitet, përmes njësive mësimore, të arrihen rezultatet e të nxënësve të temës së lëndës mësimore. Të njëjtën gjë e bëjnë në çdo planifikim dymujor. Mësimdhënësi vendos sa kohë (javë, ditë, orë mësimore) do t'ia dedikojë një rezultati të temave brenda periudhës së planifikimit dymujor.

### **Metodologjia e mësimdhënies**

Te shkruhet *metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret gjatë zhvillimit të temës (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin e orës mësimore)*, duke specifikuar disa nga qasjet metodologjike, metodat dhe teknikat e mësimdhënies interaktive që janë relevante për temën/lëndën/konceptin dhe që i ndihmojnë nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënësve të synuara me këtë plan dymujor, si p.sh. puna me projekte, vëzhgimet në natyrë, studimi kërkimor, intervista dhe debatet, ekspozita tematike, teknika të mendimit kritik, varësisht nga specifikat e lëndës/**konceptit** dhe nga përgatitja e mësimdhënësit për zbatimin e qasjeve metodologjike.

### **Vlerësimi**

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit të arritjeve të nxënësve (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor) që përdoren për të vërtetuar nivelin e arritjeve të nxënësve dhe për të orientuar mbështetjen e të nxënësve. P.sh. vlerësimi me listë kontrolli, vlerësimi me teste ose detyra përmbledhëse, vlerësimi me dosje (portofolio), vlerësimi me projekte, vlerësimi me foto apo albume – varësisht nga specifikat e rezultateve të të nxënësve të temës së lëndës.

### **Burimet**

Të shkruhen burimet që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të caktuara. Ato mund të jenë të ndryshme (burimet e shkruara, elektronike, njerëzore etj.);

- Burimet e shkruara mund të jenë tekste mësimore, gazeta, revista, dokumente dhe materiale të ndryshme;
- Burimet elektronike interneti, ueb-faqja, TV-kanali-emisioni, radio.
- Burimet njerëzore mund të jenë njerëzit që janë pjesë e zhvillimit të laboratorëve të shkencave natyrore, ngjarjeve, punës, etj.

**Sugjerim:** *Një planifikim i mirë kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale!*

### **Aktivitet:**

*Pasi që të keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIN DYMUJOR, diskutoni me kolegët e fushës së kurrikulës dhe përgatisni një plan dymujor për fushën e kurrikulës **Jeta dhe puna.***

## PLANI DYMUJOR : SHTATOR-TETOR

**Fusha e kurrikulës: Jeta dhe Puna Lënda mësimore: Teknologji duke përfshirë TIK-un Klasa:VI**

**Tema mësimore:** Njeriu dhe Shoqëria në teknologji

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:** I.1,4; II.2,3,5,6,7; III.1,2,3; IV.2,4,7. V.5. VI.2,6

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:** 1.1,2; 2.1;3.1,2;4.1;6.1;9.1

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
2. Njeriu dhe shoqëria në teknologji	<p>Tregon përdorimin e teknologjisë në mjedis nga hulumtimi i bërë në internet dhe libra të ndryshëm</p> <p>Dallon ndotje të ndryshme nga teknologjia në mjedisin shkollor</p> <p>Tregon ndikimin e teknologjisë në mjedisin ku jetojmë</p> <p>Harton një plan për parandalimin e ndotjeve nga teknologjia dhe mbrojtjen nga pajisjet teknologjike të dëmshme për shëndetin</p> <p>Kryen aktivitete praktike për të kuptuar realisht ndotjen nga teknologjia</p>	<p>2.1. Njeriu dhe shoqëria në teknologji</p> <p>2.2 Mjedi dhe teknologjia ekologjike</p> <p>2.3. Mjedi fizik dhe social</p> <p>2.4. Pajisjet teknologjike në mjedis</p> <p>2.5. Banesat</p> <p>2.6- Mjedi dhe banesat- Punë praktike</p> <p>2.7. Teknologjia ushqimore</p> <p>2.8. Ushqimi dhe trupi ynë- praktikë</p>	9 ore	<p>Punë me projekte</p> <p>Diskutimi</p> <p>Prezantimi me kompjuter</p> <p>Hulumtim me kompjuter</p> <p>Punë praktike-kohe reale</p>	<p>Informate kthyesë, Teknika efektive e të pyeturit</p> <p>Vëzhgim</p>	Shkencat e natyrës (Ndotjet, shkaktarët, pasojat, ushqimi)	Aftësim Teknologjik 6 (Shqipëri)



## 5.4. Plani javor

Meqenëse planifikimi dymujor nuk është i ndarë në javë, planifikimi javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore që do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare), në klasën e caktuar. Njësitë mësimore merren nga planifikimi dymujor.

Planifikimi javor ka për qëllim lidhshmërinë e njësive mësimore e të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemeve, dukurive dhe ngjarjeve si çështje të ndërlidhura, e jo të ndara.

Kjo do të thotë që të gjithë mësimitdhënësit e një klase të lëndëve të ndryshme të të gjitha fushave kurrikulare, në një tabelë të përbashkët të vendosin njësitë mësimore që i kanë menduar t'i realizojnë gjatë javës për një klasë (edhe pse ato mund të jenë të ndryshme nga arsimtarët e së njëjtës lëndë, por që japin mësim në paralele të tjera brenda klasës së njëjtë). Kjo qasjeje i obligon mësuesit që të takohen gjatë javës dhe që të bëhet lidhshmëria e njësive mësimore në mes të lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të nxënit e nxënësve të jetë më i integruar. Nëse ky takim për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta nuk mund të jetë i realizuar sepse „kolektivi i mësimitdhënësve është shumë i madh”, atëherë kryetari i Këshillit të klasës mund të qarkojë fletën në të cilën mësimitdhënësit shkruajnë njësitë mësimore që do t'i zhvillojnë javën që vjen. Më pas kjo fletë e përfunduar shumëzohet ose shpërndahet në mënyrë elektronike të të gjithë mësimitdhënësit e klasës së njëjtë para javës që realizohen njësitë mësimore.

Mësimitdhënësit, planifikimin javor, mund ta bëjnë në formë tabelare, ngjashëm si faja e ditarit (librit të klasës) që ka secila klasë, ku shënohen orët mësimore për çdo ditë sipas orarit. Aty e ka vendin edhe fusha *Jeta dhe puna*.

Tabela nuk ka nevojë të ngarkohet me elemente të tjera, sepse këto vetëm janë përgatitur në planin dymujor dhe më pas zëbërthehen në planin e orës mësimore.

Më poshtë paraqiten shembujt e formateve të mundshme të planifikimit javor brenda fushës dhe në mes të fushave.

**Shembull** i një formati të mundshëm të planifikimit javor (klasa e parë)

Tema pikënisëse: **Udhëtimet dhe aventurat**

Dita	Njësitë mësimore në javë			
E hënë	<b>1. Gjuhë dhe Komunikim</b>	<b>1. Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>2. Matematikë</b>	<b>3. Artet, Ed. figurative</b>
	Lexim në abetare f. 45	Paraqitja e tingullit dhe shkronjës H,h. Grafiku i shtypit f. 46	Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9 Fletore pune f. 36	Vizatimi:Treni, topi, hëna
E martë	<b>1. Matematikë</b>	<b>2. Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>1. Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>2. Shoqëria dhe mjedisi</b>
	Zbatime të mbledhjes dhe zbritjes me problem f. 54	Shkronja e madhe dhe e vogël H,h (grafiku i dorës) f. 47	Transporti	Mjetet e udhëtimit
E mërkurë	<b>1. Matematikë</b>	<b>2. Artet, Ed. muzikore</b>	<b>3. Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>4. Zgjedhore, lexim-shkrimi</b>
	Numri 10, f. 57	Mësohet kënga Tapshin-tapshin	Plotësim në Abetare pune fq. 36	Diktim
E enjte	<b>1. Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>2. Matematikë</b>	<b>3. Shkencat e natyrës</b>	<b>4. Shëndeti dhe mirëqenia</b>
	Lexim dhe plotësim në abetare f. 47	Numrat prej 1 – 10 f.58	Matja e kohës: ora, dita, nata	Loja e trenit
E premte	<b>1. Gjuhë dhe komunikim</b>	<b>2. Matematikë</b>	<b>3. Jeta dhe puna</b>	<b>4. Shëndeti dhe mirëqenia</b>
	Paraqitja e tingullit dhe shkronjës T,t. Grafiku i shtypit f. 48	Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10	Trafiku f. 13 (punëdore)	Orientimi në natyrë

Gjatë kësaj jave do të diskutohet për **udhëtimet dhe aventurat**, p.sh në fushën **Shoqëria dhe mjedisi**, e cila do të jetë pikë referimi i fushave të tjera kurrikulare si: **Matematikë** –Gjatë punës me libër kemi ilustrime të trenit, zhytësit. Numërimi i vagonëve të trenit,.. **Gjuhë dhe komunikim** :Zhvillimi i shkronjës dhe tingullit H dhe T(hëna, treni, helikopteri) **Shkencat e natyrës** Gjatë orës mund të diskutojmë për mjetet e udhëtimit se kur lëvizin, për sa mund të lëvizin prej një vendi në vendin tjetër etj. **Jeta dhe puna** – Diskutojmë për rregullat në trafik të mjeteve të udhëtimit (rregullat e thjeshta) **Shëndeti dhe mirëqenia** : Luajmë lojën „Treni”, ku fëmijët imitojnë zhurmën e trenit dhe renditen si vagonët.

### Aktivitet:

*Pasi që ta keni analizuar shembullin e dhënë për PLANIN JAVOR, diskutoni me kolegët e fushës së kurrikulës dhe **përgatisni një plan javor** ku përshkruani fokusin kryesor të javës për fushën e kurrikulës **Jeta dhe puna** – në shkallën e kurrikulës ku ju punoni.*

**Shembull** i një formati të mundshëm të planifikimit javor (Klasa-X- XII)

Drejtimi :		PLANI JAVOR      MUAJ:      Java me ditët e punës nga :										
Shoqëror - gjuhësor		K L A S A e X – të				K L A S A e XI - të				K L A S A e XII - të		
FUSHA	Lëndët	Njësitë mësimore				Njësitë mësimore				Njësitë mësimore		
Gjuhët dhe komunikimi	Gj. Shqipe, Gj. angleze, Gj. frënge, Gj. Gjermane											
Artet	Art figurativ, Art muzikor											
Matematika	Matematikë											
Shkencat natyrore	Fizikë, Kimi, Biologji											
Shoqëria dhe mjedisi	Histori, Edukatë qytetare, Psikologji, Sociologji, Filozofi, Logjikë											
Shëndeti dhe mirëqenia	Edukatë fizike - shëndetësore											
Jeta dhe puna	TIK											
Pjesa zgjedhore	Ed. mediatik, Shkencat kompjuterike TIK Mbrojtja e nxenesve nga përdorimi i internetit Projekte për zhvillime kreative përmes lojërave Pune dore											

## 5.5. Plani i orës mësimore

Plani i orës mësimore ka për qëllim që të gjitha planifikimet e procesit mësimor t'i bëjë të zbatueshëm në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit në klasë, por edhe jashtë saj, brenda një ore mësimore.

Në këtë planifikim mësimdhënësi përcakton:

- Njësinë mësimore, të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimi dymujor, përkatësisht planifikimi javor);
- Rezultatet e synuara të kompetencave, të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore;
- Rezultatet e synuara të fushës kurrikulare (mund të vendosen vetëm rezultatet e lëndës mësimore që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare Jeta dhe puna. Edhe këto merren nga planifikimi dymujor);
- Rezultatet e orës mësimore dhe
- Kriteret e suksesit, të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës.

Të gjitha rezultatet e kompetencave, të fushave kurrikulare dhe të lëndëve mësimore, duhet të shënohen me numra të njëjtë, siç janë në planifikimin vjetor, e më pas në planifikimin dymujor, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të realizimit, përkatësisht arritjes së tyre.

Mbi bazën e rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, mësimdhënësi e elaboron orën mësimore duke përcaktuar edhe elementet tjera, të cilat i sheh të nevojshme. Mënyra organizative e orës - metodologjia e mësimdhënies dhe e vlerësimit, metodat, teknikat, mjetet dhe burimet që shfrytëzohen për realizim të njesisë së orës mësimore, duhet të jenë në funksion të rezultateve të të nxënit të planifikuara për arritje.

Mësimdhënësi duhet të përdor modelin e ofruar nga MASHT-i, por mund të përdor dhe formate të ndryshme të planifikimit të orës mësimore. Mirëpo, çdoherë duhet pasur parasysh rezultatet e të nxënit të kompetencave dhe të fushave kurrikulare.

**Vlen të theksohet se planifikimi i orës mësimore mund të bëhet duke përfshirë Rezultatet e Lëndës/Temës, vetëm atëherë kur të gjitha elemente e një rezultati janë të përfshira. Ndryshe duhet të plotësohen me Kriteria të suksesit ose Rezultatet e orës mësimore pa harruar elementet e rezultatit.**

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**  
(UDHËZIME PËR PLOTËSIM TË TABELËS)

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: \_\_\_\_\_ / Lënda: \_\_\_\_\_ Shkalla e kurrikulës: \_\_\_\_\_ / Klasa: \_\_\_\_\_

**Tema** (Nga plani dymujor):

**Rezultati i të nxënit të temës** (Nga plani dymujor):

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

Barten nga plani dymujor, vetëm rezultati/et që lidhen me fokusin e orës mësimore.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**

Barten nga plani dymujor, vetëm rezultat-i/et që lidhen me fokusin e orës mësimore.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore:** Merret nga plani dymujor, përkatësisht nga plani javor. Në raste të veçanta, nëse mësimdhënësi ka vendosur që për çështje praktike temën ta ruajë si formulim në kuadër të njësisë mësimore, atëherë në vend të njësisë mund të shënohet tema mësimore.

**Fjalët kyçe** (Vendosen vetëm fjalët që identifikohen me njësinë mësimore që trajtohet brenda orës mësimor):

**Rezultat-i/et e të nxënit për orë mësimore:**

Rezultatet e të nxënit për orë mësimore, duhet të jenë të definuar qartë, të matshme, me strukturë të plotë të rezultateve të të nxënit (veprim+qëllim/objekt+kusht+kriter) dhe në funksion të zotërimit të rezultateve të të nxënit të temës së lëndës dhe rezultateve të të nxënit të shkallës për kompetencat kryesore, rezultatet e të nxënit të fushës sipas pritshmërisë, të përcaktuar për shkallën përkatëse.

Në raste të caktuara, kur tema nuk është zbërthyer në njësi mësimore, rezultati i temës mund të jetë edhe rezultati i një apo më shumë orëve të mësimimit. Mirëpo, në rastet e tilla është e domosdoshme që rezultati të zërthehet në kriteret e suksesit për orë mësimore.

**Kriteret e suksesit:**

Kriteret e suksesit duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës. Paraprakisht, mësimdhënësi duhet të bëjë një orientim në bazë të kontekstit të klasës dhe veprimtarive të planifikuara për punë me nxënësit. Kriteret e suksesit, të zërthyer për rezultatin e të nxënit të njësisë mësimore, duhet të jenë të formuluar mirë, nuk duhet të përsërisin rezultatin e të nxënit të orës mësimore, por rezultatin e të nxënit e zërthejnë sipas niveleve të arritjes (niveli i ulët, niveli mesatar dhe niveli i lartë) dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit të rezultatin të të nxënit të orës mësimore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Këtu vendosen të detajuara burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë gjatë orës mësimore (shih orientimet e përgjithshme të planit dymujor për burimet).

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:**

Përshkruhet shkurtimisht me cilën/cilat lëndë mësimore dhe çështje ndërkurrikulare ndërlidhet ora mësimore. Në mënyrë specifike, me cilat tema të lëndës/lëndëve dhe me cilat aspekte të çështjes së caktuar ndërkurrikulare ndërlidhet ora mësimore dhe veprimtaritë me nxënësit.

## **PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Përshkrimi duhet të përfshijë organizimin e orës së mësimi, i cili duhet të përmbajë:

- lidhjen e temës/njesisë mësimore me njohuritë e mëparshme të nxënësve;
- ndërtimin e njohurive të reja;
- prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura;
- etj.

## **VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Përshkruhet qasja që do të përdoret në vlerësimin formativ në raport me rezultatet e të nxënësve për orë mësimore. Pjesë e përshkrimit të vlerësimit duhet të jetë edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore të mësimi, duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura nga evidencat dhe progresi i nxënësve.

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

*Këtu përshkruhen detyrat dhe puna e pavarur që planifikohen për t'u realizuar me nxënës kur vlerësohet se disa aktivitete paraprake të orës së mësimi mund të realizohen më shpejtë, apo mund të zgjatet ora e mësimi, si dhe për kohën pas orës mësimore, në mënyrë që të mos rritet ngarkesa për nxënësit gjatë orës së mësimi. Për këtë vendos vet mësimdhënësi. Detyrat dhe puna e pavarur jashtë orës së mësimi, duhet të bëhen përpjekje që sipas rastit të jenë të integruara brenda lëndëve të fushës apo ndërmjet fushave.*

## **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi bën një vetëreflektim dhe vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore. Në mënyrë të veçantë, në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

**Shembull:** Ndërlidhja e metodave dhe teknikave mësimore në funksion të rezultateve të kompetencave të parimeve të KKK-së në planin e orës mësimore.

#### ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Jeta dhe Puna / Lënda: Teknologji duke përfshirë TIK-un Shkalla e kurrikulës: III / Klasa: VI

**Tema: Njeriu dhe shoqëria në teknologji**

**Rezultati i të nxënit të temës :**

1. Tregon përdorimin e teknologjisë në mjedis nga hulumtimi i bërë në internet dhe libra të ndryshëm.
2. Dallon ndotje të ndryshme nga teknologjia në mjedisin shkollor përmes aktiviteteve

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkollës (të synuara): IV.1,IV.3,IV.7,V.5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :1.1,2, 2.1,4.1,9.1

#### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore : **Përdorimi i teknologjisë në jetën e përditshme**

Fjalët kyçe : teknologji, ndotje,pajisje, komunikacion

Rezultat-i/et e të nxënit për orë mësimore:

Kriteret e suksesit:

- Trego gjendjen e rrugës 1m afër trotuarit të shkollës, sa është gjerësia e saj, sa rrugë kalimi ka ajo, a ka sinjalizim, semaforë për 10 min.
- Numëro së paku 4 shenja të komunikacionit rreth shkollës dhe paraqit ato në fletore.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Power Point, Youtube Projektori, Kompjuteri.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo çështjet ndërkurrikulare:

**Shkencat e natyrës (ndotja në natyrë, rreziqet dhe pasojat e ndotjes, mbrotja e ambientit),**

**Matematikë** (semafori,format gjeometrike, matja e kohës, matja e hapësirës); **Art** (format e ndryshme të ndotjeve nga plastika, druri, metalet, dallimin e ngjyrave), **Shoqëria dhe mjedisi** (kultura higjienike, edukimi personal për pasojat që sjell ndotja)

#### PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Pjesa hyrëse : 7-10 minuta**

Mësimdhënësi e paraqet para nxënësve një video ku shihet njeriu në teknologji dhe mjedise të ndryshme që mirëmbahen ose rrethohen nga teknologjia.

Nxënësit diskutojnë për videon rreth ndikimit që ka teknologjia në jetën e përditshme.

### **Pjesa kryesore 25 min**

Mësimdhënës i udhëzon nxënësit të mbledhin fletoret e tyre, të dalin jashtë në oborrin e shkollës dhe të afroheni te rruga si dhe te pjesa ku zhvillohet komunikacioni. Detyra e nxënësve është të vrojtojnë, përshkruajnë gjendjen e rrugës. **Kompetenca IV.1**

Sa është gjerësia e saj? Me sa drejtime është?

Sa mjete dhe çfarë mjete kalojnë në të?

A ka sinjalizime, tabela për emërtimin e rrugëve, një zyrë postare, një hotel, shkolla, shenja rrugore.

A ka semafor në këtë vend, si është gjendja e ndotjeve të ndryshme (pluhurave, gazrave, zhurmave)? Ku hidhen plehrat? **Kompetenca IV.7 dhe V.5**

**Nxënësit kthehen në klasë për të reflektuar rreth aktivitetit.**

### **Reflektim 10 minuta**

Nxënësit, në fund, pas aktivitetit, reflektojnë duke u përgjigjur në pyetjen:

**Si ndikon teknologjia te njeriu dhe shoqëria, mjedisi?** ← **Kompetenca IV. 1 dhe II. 5**

## **VLERËSIMI I NXËNËSVE**

**Teknikat efektive të të pyeturit, informata kthyesë.**

## **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Nxënësve u paraqitet një detyrë shtëpie dhe kërkohet që të analizohet bashkë me prindërit dhe të kryhet në vendin ku ata jetojnë. P.sh. **Çfarë veprimtarie zhvillohet pranë banesës/shtëpisë tuaj? Vrojttoni dhe përshkruani ndërtesat kryesore të qytetit tuaj!**

**(Shkruani në fletore informatat e marra dhe bëni një përshkrim të shkurtër për ide të reja dhe ndonjë ndotje e paraqitur)**

## **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi bën një vetëreflektim, vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore. Në mënyrë të veçantë, në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

Rezultatet e kompetencës për temën **Njeriu dhe shoqëria në teknologji** janë planifikuar me kohë, në planifikimin vjetor dhe më pas, janë klasifikuar në planifikimin dymujor vetëm ato që mund t'i arrijmë përmes njësisë mësimore **Përdorimi i teknologjisë në jetën e përditshme** dhe metodat e teknikat e mësimdhënies në funksion të tyre.

Rezultatet e të nxënit për shkallë (kompetence) të përzgjedhura dhe arritja e tyre përmes metodave të përzgjedhura në këtë plan mësimor janë si në vijim:

**IV.1 Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.**

Në këtë rast, synojmë të arrijmë kompetencën kontribuues produktiv dhe gjithashtu të jemi në funksion të parimit të gjithëpërfshirjes, sepse secilit nxënës i jepet shansi të marrë pjesë në aktivitetin praktik për mësimin e shenjave të trafikut, ndotjeve të ndryshme nga teknologjia dhe të kontribuojnë bashkërisht në përmirësim.

**II.5 Përzgjedh dhe demonstroi ecuri/strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi duke dëshmuar arritjen e përfundimit, domethënë rezultatin e njëjtë.**

Në këtë rast, synojmë të arrijmë kompetencën mendimtar kreativ, sepse nxënësi hulumton, identifikon,



krahason dhe prezanton gjetjet. Gjithashtu, jemi në funksion të parimit të mësimdhënies së integruar dhe të nxënies koherente, sepse po bëjmë mësimdhënie të ndërlidhur me natyrën dhe po mësojmë forma më të thjeshta për parandalimin e ndotjeve nga teknologjia duke lënë vend më pas në klasat e tjera për analiza më të hollësishme lidhur me këto çështje.

***IV.7 Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekt, aktivitet me bazë në klasë, shkollë apo jashtë saj).***

Në këtë rast, synojmë të arrijmë kompetencën kontribuues produktiv, sepse nxënësi aktivizohet në identifikimin e ndotjeve nga teknologjia, duke gjetur forma për zvogëlim të ndotjeve nga ajo. Nxënësit gjithashtu identifikojnë konkretisht ndotjet, duke hartuar planin mbrojtës për çdo lloj ndotjeje.

***V.5 Identifikon shenjat e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete dhe u shpjegon të tjerëve porosinë apo kërkesën e tyre vizuale.***

Në këtë rast, synojmë kompetencën individ i shëndosh, sepse nxënësit, duke identifikuar ndotjet që sjell teknologjia dhe ndikimin e saj në ambient, kuptojnë që duhet të kenë kujdes gjatë përdorimit të teknologjisë në vende të caktuara, ku dhe përgatisin planin për mbrojtjen nga ambienti i ndotur dhe synojnë mobilizim për jetë të shëndetshme.

Rezultatet e planifikuara në planin e orës mësimore janë pjesë përbërëse e planifikimeve vjetore dhe dymujore të hartuara më parë.

Ekzistojnë shembuj e shembuj të planifikimeve, në të cilat mund të identifikojmë metoda e teknika të cilat janë në funksion të arritjes së RNK (kompetenca) dhe të RNF, respektivisht të qëllimeve dhe parimeve të KB-ve.

Në shembullin e mësipërm, por edhe në shembujt e mundshëm të praktikës së mësimdhënies, filozofia e KKK-së, KB-ve, kërkon qasje të ndryshme të mësimdhënies dhe kjo do të thotë:

- Aplikimin e metodave dhe teknikave të ndryshme, të cilat u mundësojnë të gjithë nxënësve ndërlidhjen në procesin e të nxënies, sepse disa mund të mësojnë duke vizatuar, disa duke lexuar, disa duke dëgjuar, disa duke shikuar, disa duke lëvizur, disa me gjëra konkrete, e disa në mënyrë abstrakte për detyrën e njëjtë. Në këtë rast, ne i kemi respektuar stilet e të nxënies dhe kemi ofruar edhe mësimdhënie të diferencuar për detyrën e njëjtë, por me vështirësi të ndryshme të zgjidhjes dhe të nxënies.
- Aplikimin e mësimdhënies që u mundëson nxënësve të nxënë duke vepruar, si në rastin e mësimin të përdorimit të teknologjisë, sepse nxënësit nxënë duke bërë vetë hulumtimin, si në rastin e mësimin të elementeve të komunikacionit në rrugë. Apo shembulli nga fusha e kurrikulës Shoqëria dhe mjedisi, kur nxënësit mësojnë për rregullat. Në këtë rast ata duhet të kalojnë vetë në procesin e hartimit të rregullave, në mënyrë që të kuptojnë se çka janë rregullat, e shume shembuj të tjerë të kësaj natyre.
- Aplikimin e mësimdhënies që mundëson të nxënies duke ndërvepruar, nxënësit veprojnë në ndonjë objekt, ngjarje apo dukuri dhe efektet e tyre ndikojnë te nxënësit, sepse përvoja që

ata kalojnë gjatë këtyre proceseve u ndihmon të bëjnë apo të mos bëjnë gjërat e njëjta. Kujto „Njeriu mëson edhe nga gabimet”!

- Aplikimin e mësimdhënies që mundëson të nxënit duke bashkëpunuar. Kujto punën në grupe, ekupe, çifte (punën me të tjerët).
- Aplikimin e mësimdhënies duke hulumtuar, sepse nxënësit vetë i gjejnë burimet e informacionit, vetë hulumtojnë (ndajnë detyrat, caktojnë metodat, instrumentet, kriteret dhe vetë përgatisin prezantimin e gjetjeve). Shiko shembullin në planin mësimor për njeriun dhe shoqërinë në teknologji. Në funksion të nxënies, duke hulumtuar, është edhe puna me projekte, sepse fëmijët mësojnë si të hulumtojnë duke ndjekur procedurat e hulumtimit.

#### IV.6 Planifikimi i çështjeve **ndërkurrikulare dhe veprimtarive jashtëkurrikulare**

Në planifikimet vjetore, çdo mësimdhënës, aktiv profesional, lëndë dhe fushë duhet të kenë të paraqitur planin e aktiviteteve jashtëmësimore (jashtëkurrikulare), ku përmes tyre paraqesin planet e përbashkëta të lëndëve të një fushe dhe veprimtaritë që synojnë zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësve drejt forcimit të kompetencave bazë dhe kompletimit të tyre.



## VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES DHE MATERIALET MËSIMORE

### **Ky kapitull përqendrohet në:**

- *Metodologjinë e mësimdhënies në funksion të KKK-së*
  1. *Mësimdhënien dhe të nxëniet e bazuar në arritjen e kompetencave*
  2. *Mësimdhënien dhe të nxëniet e integruar*
  3. *Mësimdhënien dhe të nxëniet e diferencuar*
- *Çështjet e ndërkurrikulare dhe korrelacionet*
- *Çështjet/veprimtaritë jashtëkurrikulare*
- *Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)*

### **6.1. Metodologjia e mësimdhënies në funksion të KKK-së dhe programeve të reja mësimore**

Pasi që kemi bërë planifikimin me kohë dhe të thuktë të KB-ve, duke e zbërthyer atë për nevojat dhe mundësitë e nxënësve, atëherë vetëm fillojmë realizimin praktik të saj. Kjo do të thotë se ne kemi bërë planifikimin për shkallë kurrikulare, planifikimin vjetor dhe dymujor të procesit mësimor, planifikimin javor dhe të orës mësimore dhe i kemi ndërlidhur ato në mënyrë logjike. Tani, jemi gati për zbatim praktik, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj, si në realizimin e aktiviteteve brenda orës mësimore, në dhënien e detyrave të shtëpisë, në aktivitetet ekstrakurrikulare. Në këtë rast na mbetet vetëm të zbatojmë metodologjitë e mësimdhënies së planifikuar.

Rezultatet e të nxëniet për shkallë (kompetencë) (RNK) dhe rezultatet e të nxëniet për fusha kurrikulare (RNF), përveç që janë pika referuese të përzgjedhjes së përmbajtjes mësimore, temave mësimore, respektivisht njërive mësimore në planifikimet e procesit mësimor, ato na ndihmojnë edhe në përzgjedhjen e metodologjisë së mësimdhënies dhe të të nxëniet konform filozofisë dhe parimeve të KKK-së. (Shih, më lart, dokumentin në pjesën II. 2, Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukative-arsimore dhe pjesën e planifikimit, modelet e planifikimeve mësimore).

- Të nxëniet duke ndërvepruar, bashkëpunuar, hulumtuar, të ndërlidhur me jetën, arrihet nëse kemi ofruar mësimdhënie të integruar (qoftë në rrafshin e fushave kurrikulare, por edhe në rrafshin jetësor, sepse temat janë përzgjedhur nga situatat jetësore dhe janë trajtuar nga kënde dhe fusha të ndryshme kurrikulare, nga aspekti gjuhësor, matematikor, natyror, shoqëror, teknologjik e shëndetësor. Shih shembullin e planifikimit javor. Dhe, pikë referimi e mësimdhënies janë nxënësit, sepse në përzgjedhjen e metodave dhe teknikave marrim në konsideratë potencialet, afinitetet, interesat dhe stilet e të nxëniet të nxënësve. Thuajse e gjithë veprimtaria e fushës *Jeta dhe puna* bazohet në punën praktike. Metodatat që përdoren te kjo fushë duhet të mundësojnë konkretizimin e teorisë në praktike.

Te lënda e Teknologjisë, duke përdorur mjete të ndryshme, si veglat e punës, nxënësit fitojnë shkathtësi dhe njohuri drejt arritjes së kompetencave. Veçanërisht në këtë fushë, të nxënit në bashkëpunim ka rëndësi të madhe.



**Të nxënit në bashkëpunim** bën të mundur që nxënësit të nxënë në mënyrë aktive dhe të shprehin shkathtësitë e tyre praktike. Të nxënit në bashkëpunim nxit të menduarit e rendit të lartë, ngre motivimin dhe moralin, nxit mirëkuptimi midis nxënësve dhe grupeve etj., dhe në fund mundëson mësimin dhe forcimin e shprehive vetjake.

### Shembull i të nxënit në bashkëpunim të TIK-u:

Kjo metodë nxit bashkëpunimin në grup, duke zhvilluar të menduarit kritik dhe kreativitetin e nxënësit.

#### Rezultatet e të nxënit:

- Tregon ecurinë e krijim të broshurës
- Përdor formën modular për të dizajnuar broshurën
- Krijon broshurën „Ndikimi i duhanit në shëndetin tonë”

Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit të ndjekin hapat e duhur për krijimin e një broshure me modelin modular: „Ndikimi i duhanit në shëndetin tonë” nga programi Microsoft Publisher.

#### Hapat:

- Jepen udhëzimet e qarta nga mësimdhënësi, i cili i shpjegon hapat për krijim e broshurës përmes projektorit me programin Microsoft Publisher;
- Caktohen detyrat e anëtarëve të grupit;
- Fillohet puna në klasë;
- Vëzhgimi i punës së nxënësve/ndihmë në përmirësim;
- Mësimdhënësi, përmes vlerësimit të ndërsjellë, mat rezultatet e të nxënit.

Shembulli i mësipërm tregon edhe ndërlidhjen në mes lëndës së Teknologjisë dhe Shëndetit e mirëqenies

### Aktivitet:

1. Pasi që ta keni analizuar shembullin e dhënë për **PLANIN E ORËS MËSIMORE**, diskutoni me kolegët e fushës së kurrikulës dhe përgatisni një plan të orës mësimore për njërën nga lëndët/koncepte të fushës së kurrikulës **Jeta dhe puna** (nga klasa VI-IX Ndermarrësia, edukim për zhvillimin e qëndrueshëm, edukim dhe orientim në karrierë).
2. Reflektoni për përvojën e praktikave në klasë, për përvojën tuaj të fituar nga programet e trajnimit në metodologjinë e mësimdhënies dhe përgatisni/ zbërtheni qasjen metodologjike të mësimdhënies dhe nxënies për një orë mësimore, ku fokusi është metodologjia e mësimdhënies në funksion të arritjes së rezultateve të kompetencave dhe rezultateve të fushës së kurrikulës **Jeta dhe puna**.

### ***Mësimdhënia dhe të nxëniet e bazuar në arritjen e kompetencave***

KKK-ja promovon perspektivën e bazuar në kompetenca, me qëllim që njohuritë e nxënësve, aftësitë dhe qëndrimet e tyre, të zhvillohen në funksion të arritjes së kompetencave kryesore dhe me qëllim të adresimit të nevojave të ndryshme të nxënësve për të përmbushur kërkesat e kurrikulës dhe rezultatet kryesore të të nxëniet për shkallë dhe nivele.

Mësimdhënia dhe nxënia e fokusuar dhe e orientuar në kompetenca, nga mësuesit kërkon që të bëjnë përzgjedhjen dhe organizimin e përvojave mësimore të cilat integrojnë njohuritë relevante me vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë e nxënësve. Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca për bazë ka rezultatet mësimore, të cilat përshkruajnë se çka është në gjendje nxënësi të dijë, të bëjë, të kuptojë, të vlerësojë dhe të marrë qëndrim lidhur me përfundimin e suksesshëm të një shkalle të Kurrikulës.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca kërkon që mësuesit të përzgjedhin strategji, metoda, teknika dhe forma të ndryshme të punës me nxënës, si dhe të organizojnë përvojat mësimore të nxënësve që i integrojnë njohuritë relevante me shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në kompetenca është e lidhur ngushtë edhe me procesin e vlerësimit, me fokus të veçantë me vlerësimin formativ dhe progresiv. Për të vlerësuar kompetencat e nxënësve, është e rëndësishme që secili mësues të përzgjedhë teknika dhe instrumente për vlerësim, të cilat u mundësojnë nxënësve të demonstrojnë e të shpërfaqin njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë e tyre, e jo vetëm njohuritë faktike. Në këtë

Mënyrë, mësuesit sigurojnë informacion për cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies, përparimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave.

#### ***Shembull:***

- ***Krijimi i mjedisit të përshtatshëm, në klasë dhe në shkollë, në të cilin nxënësit ndihen të mirëpritur dhe të lidhur me njëri-tjetrin, me mësuesin e tyre dhe shkollën e tyre;***
- ***Zhvillimi i mësimëve nëpërmjet qasjeve dhe teknikave të të nxëniet aktiv;***
- ***Zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënies, zgjidhjes së problemeve dhe zhvillimit të të menduarit kritik. (shih në KB)***

### ***Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar***

Kjo metodologji ndërlidh përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve në të nxëniet e fushave mësimore me rezultatet e të nxëniet të kompetencave kryesore – për shkallë dhe nivele

Për t'i përmbushur kërkesat e KKK-së dhe të Kurrikulës bërthamë për SNKA 1, MASHT-i fton mësimdhënësit e arsimit të mesëm të ulët që të zbatojnë mësimdhënien dhe nxënien e bazuar në qasjen e integruar, duke bërë:

- ndërlidhjen ndërmjet fushave kurrikulare/mësimore, ku përmbajtjet e veçanta mësimore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kryesore;

- ndërlidhjen midis rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare me rezultatet e të nxënit për shkallë dhe nivele, me qëllim që aplikimi i njohurive, i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të jetë i ndërlidhur me situatat konkrete nga jeta e përditshme;
- integrimin në mësimdhënie dhe në nxënie të karakteristikave të përbashkëta të lëndëve të fushës përkatëse (p.sh., të Gjuhës amtare me Gjuhën angleze) apo të karakteristikave të përbashkëta të fushave kurrikulare (p.sh., të fushës *Shoqëria dhe mjedisi* me fushën *Shkencat natyrore*);
- aktivitete me nxënës që të zhvillojnë kompetencat për të gjetur dhe për të përpunuar informatat në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme për shfrytëzimin e mësimit elektronik, të teknologjive aktuale dhe të ardhme në epokën digjitale;
- aktivitete me nxënës që promovojnë perspektivën e mësimit gjatë gjithë jetës, dhe të cilat i ndihmojnë nxënësit që të zhvillojnë kompetencat e tyre për t'u ballafaquar me sfidat dhe mundësitë brenda zhvillimeve në shoqërinë dhe në ekonominë e sotme dhe në të ardhmen.

**Shembull:**

**Mësimdhënësit zbatojnë këtë metodologji atëherë kur bëjnë**

*-ndërlidhjen ndërmjet fushave kurrikulare/mësimore, ku përmbajtjet e veçanta mësimore kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kryesore;*

*- ndërlidhjen midis rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare me rezultatet e të nxënit për shkallë dhe nivele, me qëllim që aplikimi i njohurive, i shkathtësive, i qëndrimeve dhe i vlerave të jetë i ndërlidhur me situatat konkrete nga jeta e përditshme*

*(Shih te kapitulli i korrelacioni dhe te të nxënit në bashkëpunim)*

***Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar***

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar paraqesin një qasje sipas së cilës mësimdhënia, për zhvillimin e kapaciteteve të të gjithë nxënësve, mbështetet në planifikim, në zbatim, në kontroll, në përkrahje dhe në vlerësim.

Mundëson përfilljen e dallimeve ekzistuese ndërmjet nxënësve në klasë përkritazi me përmbajtjen që do të mësojnë, ecurinë didaktike-metodike të të nxënit si dhe matjet dhe materialet, çfarë duan dhe mund të shfrytëzojnë gjatë mësimi.

Përmes mësimi të diferencuar mundësohet përshtatja e kohës dhe e shpejtësisë së të nxënit dhe e të mësuarit me veçoritë individuale të secilit nxënës.

**Shembull:**

**Mësimdhënësi a paraqet detyrën praktike në projektor.**

**Përmes detyrës paraqet format e kryerjes dhe mundësitë e realizimit përmes praktikës në klasë.**

**Puna praktike, mundësitë e realizimit:**

1. **Krijimi i urës me materiale nga druri, letra plastika**
2. **Krijimi i urës në klasë me vetëm 2 mbajtëse**
3. **Krijimi i urës në klasë përmes punës grupore**
4. **Krijimi i urës në klasë përmes punës individuale me mjete personale**
5. **Krijimi i një pjese të urës në një orë mësimore.**

### **Çështjet/temat ndërkurrikulare**

Çështjet ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lënde. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritjes së rezultateve të të nxënësve për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimi për paqe, të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar, duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për kujdesin dhe ruajtjen e mjedisit dhe edukimin për karrierë, edukimi mediatic, etj..

Çështjet mund të integrohen në kurrikula nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Kështu, me rastin e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore në fusha të caktuara këto çështje duhet të merren parasysh. ***P.sh.** kujto shembullin e planit mësimor **Përdorimi i teknologjisë në jetën e përditshme** të fusha **Jeta dhe Puna**. Njësia mësimore e përzgjedhur për **Teknologjinë mund të jetë edhe në funksion të ndërgjegjësimit për mjedisin, duke kontribuar në ruajtjen e tyre nga ndotjet nga teknologjia. Në këtë rast ndihmojmë nxënësit në arritjen e kompetencës kontribuues produktiv etj.***

Gjatë planifikimit preferohet që këtyre çështjeve/temave t'u jepet hapësirë e veçantë në data të caktuara, si p.sh Ditës së tokës, Ditës së të drejtave të fëmijëve etj.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të bëhet edhe përmes projekteve hulumtuese dhe projekteve të natyrave të ndryshme. Për realizimin e këtyre projekteve mund të kontribuojnë disa fusha kurrikulare, p.sh. në hulumtimin e tregut të punës, fusha *Jeta dhe puna* u mundëson nxënësve që duke marrë pjesë në panairët e punës të realizojnë hulumtimin dhe pastaj të përgatisin një prezantim të hulumtimit. Mund të bëhet pastaj një hulumtim tjetër përmes kërkimeve në internet për të drejtat e punëtorëve, rreziqet në punë etj. Këtu kontribuon edhe fusha e *Gjuhët dhe komunikimi* për mënyrat e prezantimit, Matematika për analizat matematikore të të dhënave etj.



Disa nga çështjet që mund të përdoren nga fusha *Jeta dhe Puna* janë:

1. Njohja e medies
2. Zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
3. Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit
4. Barazia gjinore dhe toleranca;
5. Puna vullnetare.
6. Edukimi për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore.
7. Shkathtësitë e buta për jetë

Për shembuj konkret në planin dymujor shih SHTOJCA, në fund të udhëzuesit për të qartësuar zërbërthimin e çështjeve ndërkurrikulare në temat dhe njësitë e caktuara.

### **Çështjet jashtëkurrikulare**

Çështjet jashtëkurrikulare janë pjesë e planifikimeve jashtë planit dhe programit mësimor të rregullt lëndor. Përmes tyre, në planifikojmë tema jashtëmësimore të cilat synojnë zhvillimin e shkathtësive të nxënësve, njohurive dhe plotësimin e zhvillimin e kompetencave bazë për një fushë kurrikulare.


Disa nga format të cilat plotësojnë këtë pjesë janë: Vizita në muze, panairët teknologjike, zhvillimi i sfidave të ndryshme ku në fokus është puna praktike (Fakultet, laboratorët teknologjik) etj.

### **Korrelacioni (ndërlidhja) ndërmjet fushave kurrikulare dhe lëndëve mësimore**

Suksesi i gjithë zbatimit të KB-ve qëndron në trajtimin e integruar të temave mësimore nga kënde të ndryshme të fushave kurrikulare. Kjo u mundëson nxënësve të kuptojnë funksionimin e jetës gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

Realizimi i korrelacionit bëhet në të gjitha planifikimet mësimore, p.sh. në planifikimin për shkallë, në mënyrë studiuuese bëjmë shpërndarjen e RNK-ve dhe RNF-ve për secilën klasë. Në planifikimin vjetor përcaktojmë temat mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore sa ka fusha kurrikulare (në rastin tonë fusha *Jeta dhe puna*). Gjithashtu, kërkohet që planifikimet vjetore të të gjithave fushave kurrikulare të vendosen në formatin e njëjtë, me qëllim të funksionimit të korrelacionit në mes tyre. Në planifikimet vjetore kërkohet të shkruhet vetëm korrelacioni dhe kështu vijmë te planifikimi javor, i cili për qëllim ka pikërisht korrelacionin ndërmjet fushave, përkatësisht lëndëve mësimore (Shiko më lart udhëzuesin, pjesën III.5, Plani javor). Kjo ndërlidhje më pas reflektohet edhe në orën mësimore. (Shiko shembullin në vijim):

## Shembulli



## 6.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)

Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësime të mësimdhënësve të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimeve dhe të materialeve mësimore.

Mësime të mësimdhënësve, mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimeve, përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuar dhe parimeve të KKK-së. Përzgjedhja adekuate e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.

Sot, teksti mësimor, nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësve, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po

ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore, dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për të gjithë nxënësit e të njëjtës moshë sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuara. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit. **Kujto të nxënët duke vepruar!** Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale ricikluese, si letër, gazeta, rroba të vjetra, ambalazhe të ushqimeve, copëza të drurit, gjethe, litarë, kopse rrobash, etj., respektivisht me gjëra të cilat mund t'i ketë çdo shtëpi dhe që nuk i përdor më. Gjithashtu, në disa raste mësimdhënësit së bashku me nxënësit mund t'i riciklojnë edhe vetë.

**Shembull:** Kuptimi i ndërvarësisë ekonomike mund të zhvillohet me ambalazhet e produkteve ushqimore, duke i lexuar vendet e prodhimeve dhe duke i identifikuar vendet në hartë të siguruar nga mësimdhënësi (apo të punuar nga vetë nxënësit e kësaj moshe apo të klasave të larta). Përmes ambalazheve, nxënësit mund mësojnë edhe për përbërjen e produkteve, për mënyrën e përdorimit, etj.

**Shembull:** Rroba të vjetra për të krijuar veshje për t'u përdorur në teatër dhe mjete didaktike, të cilat mësimdhënësit, respektivisht nxënësit, i përdorin në përditshmërinë e mësimdhënies dhe të nxënies.


**Shembull:** Letër, për të krijuar fletëza mësimore me të cilën, i mundësohet secilit nxënës qasje individuale, pastaj domino – që mundëson të nxënët në grup, shkronja dhe materiale të tjera.



**Shembull:** Gazeta, për të krijuar poster, materiale matematikore, por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Shih në foto formimin e kubit me gazeta.

Pra, ekzistojnë mundësi të ndryshme të krijimit të materialeve mësimore, duke shfrytëzuar për lëndë të parë materiale ricikluese që do të lehtësonin procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Për ta bërë këtë është mirë që në shkollë të sigurohet një vend ku grumbullohen materiale të tilla që mësimdhënësit dhe nxënësit t'i kenë çdoherë në dispozicion.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, mësimdhënësi mund të përdorë burime të ndryshme, qoftë elektronike, por edhe të shkruara, si: librat e punës, broshurat, atllaset, enciklopeditë, softuerët arsimore, projektet, studimet e ndryshme, analizat, etj.



Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësime dhënësit të bashkëpunojnë edhe për prodhimin e materialeve të ndryshme didaktike, përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.

**Aktivitet:** Pasi që t'i keni lexuar dhe analizuar informacionet/udhëzimet e dhëna për materialet mësimore, diskutoni me kolegët se si mund të përzgjidhni dhe përgatitni disa materiale mësimore për një apo dy njësi mësimore.

**Fusha e kurrikulës/Lënda:** \_\_\_\_\_

**Klasa:** \_\_\_\_\_

**Tema:** \_\_\_\_\_ **Njësia mësimore** \_\_\_\_\_

**Rezultatet mësimore:** \_\_\_\_\_

**Përzgjedhja dhe përgatitja e materialeve mësimore që mundësojnë zhvillimin e mësime dhënësit atraktive dhe lehtësimin e të nxënësve** - përshkrimi i anës praktike të përzgjedhjes, përgatitjes dhe përdorimit të materialeve mësimore gjatë praktikës në klasë:

---



---



---



## VII. VLERËSIMI I NXËNËSVE

**Ky kapitull përqendrohet në planifikimet e procesit mësimor, si:**

- Qëllimi i vlerësimit
- Parimet themelore të vlerësimit
- Llojet e vlerësimit/Vlerësimi i brendshëm
- Aspektet metodologjike dhe praktike të zbatimit të vlerësimit

### Qëllimi i vlerësimit

Vlerësimi ka për qëllim mbledhjen e informacioneve për përkrahjen e nxënësit në zotërimin e rezultateve të të nxënës, përcaktimin e nivelit të performancës, raportimin e rregullt të progresit, certifikimit dhe orientimit në shkollim të mëtejshëm.

**(U.A. MASHT nr.08/2016 datë 26.05.2016).**

- forcimin e të nxënës të të mësuarit
- raportimin e përparimit të nxënësve
- zotërimin e kompetencave të kurrikulës
- certifikimin dhe orientimin e nxënësve

### Parimet themelore të vlerësimit

- Vlerësimi gjithmonë duhet t'u referohet kompetencave kryesore dhe rezultateve të të nxënës sipas fushave të kurrikulës, fushës lëndore, për klasë, shkallë dhe nivel të shkollimit.
- Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit.
- Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit.
- Mënyra e ndërtimit të vlerësimit duhet gjithmonë të jetë transparente dhe e drejtë.
- Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet në standardet më të larta etike, përgjegjësi dhe llogaridhënie.

### Llojet e vlerësimit/Vlerësimi i brendshëm

Vlerësimi i brendshëm i nxënësit kryhet nëpërmjet dy llojeve të vlerësimit:

Vlerësimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi përfundimtar.

**Vlerësimi i vazhdueshëm** është vlerësim me bazë **në klasë**. Raportohet për **përparimin** e nxënësve dhe vlerësohet me nota numerike. Realizohet nëpërmjet vlerësimit formativ dhe vlerësimit përmbledhës.

- a) **Vlerësimi formativ** – Realizohet nga mësuesi, gjatë gjithë vitit mësimor, duke u bazuar në rezultatet e të nxënës. Realizohet nëpërmjet angazhimit të nxënësve në klasë, detyrave të shtëpisë, kuizeve, debateve, prezantimeve, eseve, testeve ose instrumenteve që i përcakton mësuesi dhe nxënës.
- b) **Vlerësimi Përmbledhës** - Realizohet nga mësuesi, gjatë gjithë vitit shkollor, duke u bazuar në rezultatet e të nxënës për klasë dhe bëhet me notë. Realizohet në tri periudha mësimore: Shtator-Dhjetor; Janar-Mars dhe Prill-Qershor. **(U.A. MASHT nr.08/2016 datë 26.05.2016).**

**Vlerësimi përfundimtar** është vlerësim i cili realizohet në nivel klase si vlerësim i përfundimit të vitit mësimor i nxjerrë nga mesatarja aritmetike e tri periudhave të caktuara mësimore. (U.A. MASHT nr.08/2016 datë 26.05.2016).

**Vlerësimi për shkallë** ka për qëllim verifikimin e arritjes së rezultateve të të nxënësve nga nxënësit në nivel shkalle kurrikulare të fushave përkatëse në kontekstin e zotërimit të kompetencave kryesore dhe mbi këtë bazë, organizimin e mësimdhënies drejt progresit të vazhdueshëm të arritjes së tyre. Realizohet në nivel shkolle për fushë/lëndë dhe përfshin vlerësimin me rastin e përfundimit të shkallës të kurrikulës, në fund të shkallës I, II, III, dhe V (klasat 2,5,7 dhe 11). Vlerësimi për shkallë shënohet me notë në formë të shkronjës (A,B, C, D)

Nota A – Përformancë e shkëlqyeshme

Nota B – Përformancë shumë mirë

Nota C – Përformancë e mirë

Nota D – Përformancë e mjaftueshme (U.A. MASHT nr.08/2016 datë 26.05.2016).

**Vlerësimi i jashtëm** është vlerësim i standardizuar nga institucionet ose agjencitë shtetërore të vlerësimit të nxënësve. Organizohet me mbarimin e klasës 5, 9 dhe 12. (U.A. MASHT nr.08/2016 datë 26.05.2016).

### **Aspektet metodologjike dhe praktike të zbatimit të vlerësimit**

Pas përgatitjeve të nevojshme për një fillim të mbarë të procesit mësimor (kujto llojet e planifikimeve dhe metodologjitë e mësimdhënies), interes i mësimdhënësit është përcjellja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i secilit nxënës në kontekstin e arritjes së rezultateve të planifikuara për periudha të caktuara kohore.

Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënësve në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNK-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime, duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB-të (Kapitulli VII). Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore.

*Vlerësimi është proces i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritshmerinë ose performancën e nxënësve.  
Shiko fjalorthin në KKK*

Për të konstatuar nivelin e arritjes së rezultateve të planifikuara në planifikime duhet kërkuar çdoherë prova dhe dëshmi në performancat e secilit nxënës.

Duke u nisur nga të kuptuarit praktik të konceptit të vlerësimit si veprim i qëllimshëm, gjithëpërfshirës, i planifikuar, i vazhdueshëm, mësimdhënësi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve duhet të ndjek hapat si në vijim:

Së pari të caktohet qëllimi i vlerësimit, pse (për çka) po vlerësojmë? P.sh. vlerësojmë për të planifikuar, vlerësojmë nivelin e progresit të arritjeve të kompetencave, vlerësojmë njohuritë akademike të nxënësve, vlerësojmë për të përmirësuar mësimdhënien, vlerësojmë përvojat e nxënësve, mënyrën e të nxënësve (stile) etj. Ai duhet të jetë çdoherë i planifikuar me kohë dhe pjesë përbërëse e planifikimeve mësimore (shiko planifikimin dymujor dhe të orës mësimore – kriteret e suksesit).



Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari për fushën kurrikulare **Jeta dhe puna** përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Pastaj përcaktojmë nivelin e arritjes të kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës dhe nuk janë të zërthyer. (Kujto zërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë ! Shih pjesën e udhëzuesit II.3.1, Rezultatet e të nxënit për shkallë –kompetencë (RNK) dhe arritja e tyre në shembullin e zërthimit të rezultatit III.3, IV.1 (niveli III) dhe IV.1. (niveli II);
- Më pas caktohet tema apo njësia mësimore përmes të cilës matim rezultatin e kompetencës;
- Në fund caktohen kriteret e vlerësimit dhe teknikat e instrumentet adekuate përmes së cilave maten rezultatet e kompetencave (RNK-të).
- **Kujto!** Rezultatet e kompetencave nuk janë vetëm njohuri, por edhe shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina.
- Shiko KB-të, fushat kurrikulare, pjesën e vlerësimit. Shiko shembullin në vazhdim!

### Shembulli

**P.sh.** Në klasën X, nxënësit mësojnë për **ndikimin e industrisë në ndryshimet klimatike** dhe përmes burimeve në internet, studimeve të ndryshme, programeve softuerike e të dhënave të tjera ata zhvillojnë njohuritë, qëndrimet dhe shkathtësitë, duke realizuar një fushatë vetëdijesuese për zhvillim të qëndrueshëm.

**Qëndrimet, vlerat dhe besimet:** i përgjegjshëm, (për ruajtjen e ambientit), bashkëpunues (me shokët/ shoqet në organizimin e fushatës), i sigurt (se ruajtja e ambientit ndikon edhe në ndryshimet klimatike).

**Njohuritë :** shkëmben përvojat (me të tjerët), identifikimi (i ndotësve të ambientit që ndikon në ndryshimet klimatike), përshkrim (i efektit serë).

**Shkathtësitë:** përdorim të teknologjisë për të marrë informata, diskuton në grup (me të tjerët), pjesëmarrje aktive (organizimi i fushatës).

**Si mund të bëhet vlerësimi i arritjes së rezultateve të të nxënit përmes njësisë mësimore?**

Pasi të keni përzgjedhur njësinë mësimore që do ta zhvilloni në ditët në vijim, hartojeni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënit mbi bazën e RNK dhe RNF (RNL),



zgjidhni një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit (Kujto planifikimin e orës mësimore).

**Shembull** i një modeli të një plani të vlerësimit për një njësi mësimore

**Fusha e kurrikulës Jeta dhe puna /Lënda Teknologji / Klasa VIII**

Njësia mësimore: **Përdorimi i teknologjisë në jetën e përditshme dhe ndikimi i saj në mjedis**

Detyrat kryesore me nxënës: **Nxënësit në grupe kryejnë hulumtimin e përdorimit të disa pajisjeve teknologjike në jetën e përditshme.**

Instrument: **Tabela vlerësuese e mësimdhënësit (mund të jetë listë kontrolli etj.)**

Dëshmia: **Punimi i përbashkët, tabela ku paraqiten karakteristikat kryesore të disa pajisjeve teknologjike dhe ndikimet e tyre në mjedis.**

Rezultatet e të nxënit, nxënësi:

- Hulumton mënyrat e funksionimit të disa pajisjeve teknologjike (ngjashmëritë dhe dallimet);
- Tregon karakteristikat kryesore të atyre pajisjeve;
- Dallon veçoritë e secilës pajisje dhe ndikimet që kanë në mjedis.

Kriteret e suksesit, nxënësi:

- Hulumton funksionimin e disa pajisjeve teknologjike sipas kriterëve të caktuar;
- Shënon së paku 3-4 karakteristika dalluese të secilës pajisje;
- Gjen së paku 2-3 karakteristika më të veçanta të ndonjë pajisje që dallon nga të tjerat dhe ndikimin e saj konkret në mjedis.

**Tabela vlerësuese nga mësimdhënësi**

<b>Kriteret e zërthyera</b>	<b>Ka nevojë për përmirësim</b>	<b>I realizuar</b>	<b>Nivel i lartë</b>
Kriteret e hulumtimit të pajisjeve teknologjike.	Nxënësi nuk hulumton sipas kërkesave të caktuara.	Nxënësi hulumton sipas kërkesave të caktuara, por më vështirësi.	Nxënësi hulumton sipas kërkesave të caktuara dhe përsëritë hulumtimin me sukses.
Karakteristikat e funksionimit të pajisjeve teknologjike dhe ndikimet e tyre në mjedis.	Nuk shënon asnjë karakteristike të funksionimit të pajisjeve teknologjike dhe ndikimet e tyre në mjedis.	Shënon më pak se 3 karakteristika të funksionimit të pajisjeve teknologjike dhe ndikimet e tyre në mjedis.	Shënon 3-4 karakteristika të funksionimit të pajisjeve teknologjike dhe ndikimet e tyre në mjedis.
• Dallimet dhe	Nuk gjen asnjë	Gjen më pak se 3	Gjen 3 e më shumë

veçoritë e ndonjë pajisje nga të tjerat dhe ndikimi i saj konkret në mjedis.	dallim dhe veçori të pajisjes nga të tjerat dhe ndikimin e saj konkret në mjedis.	dallime dhe veçori të pajisjes nga të tjerat dhe ndikimin e saj konkret në mjedis.	dallime dhe veçori të pajisjes nga të tjerat dhe ndikimin e saj konkret në mjedis.
Puna ne grup dhe ndarja e detyrave.	Ka orvatje individuale për ndarjen e detyrave.	Ka orvatje të përbashkëta por rolet nuk janë gjithnjë të qarta.	Bashkërisht ndan detyrat dhe i kryen ato.

### **Kriteret e suksesit**

Termi „kriteret e suksesit” është përdor, për herë të parë, në Britani të Madhe si sinonim për „kriteret e vlerësimit”. Kështu, në vend që nxënësve t’ua rikujtojmë se duhet vlerësuar puna e tyre (me notë), kriteret në fjalë i përqendrojnë ata në përvoja pozitive, në aftësitë e nxënësve për të qenë të suksesshëm.

### **Për të rritur ndikimin në të nxënësit, kriteret e suksesit.:**

- Duhet të jenë të qarta dhe të shkruara në gjuhë të kuptueshme për të gjithë nxënësit;
- Duhet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit – diferencimi dhe mbështetja për nxënës me nevoja të ndryshme bëhet nëpërmjet aktiviteteve;
- Mund të shfrytëzohen për realizimin e rezultateve të kurrikulës, duke përfshirë edhe shkathësitë për përdorimin e teknologjisë, shoqërizimin, për të menduarit në mënyrë kritike dhe kreative, etj;

Kriteret e vlerësimit janë instrumente matëse, të cilat mund të përcaktohen nga vet mësimdhënësi, ose dhe nga nxënësit me ndihmën e mësimdhënësit, për një aktivitet të caktuar. Është me rëndësi të dimë se ato duhet të shkruhen në formë urdhërore.

Nëse përcaktohen nga mësimdhënësi ato mund të paraqiten në këtë formë:

#### **1. Krahaso skicën me vizatim të artit figurativ përmes vizatimit të një objekti**

Nëse kriteret nxirren nga nxënësit, bashkë me mësimdhënësit, atëherë shënohet në këtë formë:

1. Përshkruajmë ndotjet nga teknologjia
2. Identifikojmë pajisjet që ndotin mjedisin

<i>Kriteret e suksesit/ Si do ta dimë nëse kemi qenë të suksesshëm? Kërkesat e mësimdhënësit</i>	
<p><b>Nuk janë kritere të suksesit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• grupi ynë punoi bashkë</li> <li>• grupi ynë i respektoi të gjitha rregullat</li> </ul>	<p><b>Kritere e suksesit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-ndani rolet e secilit për punën që duhet bërë</li> <li>-nëse nuk pajtoheni me shokun/shoqen, argumentoni arsyen</li> <li>-gjysma e nxënësve të shkruajë për ushqimin e shëndetshëm, ndërsa gjysma tjetër për ushqimin jo të shëndetshëm</li> <li>-secili nxënës i grupit të shkruajë nga një artikull për të ushqyerit</li> </ul>

## Aktivitet:

*Pasi që ta keni lexuar dhe analizuar pjesën për vlerësimin – planifikimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve në bazë të rezultateve mësimore, reflektoni për përvojën e vlerësimit në praktikën e klasës, për përvojën tuaj të fituar nga programet e trajnimit në metodologji të vlerësimit dhe merrni së paku tre shembuj të rezultateve të kompetencave që janë të lidhura ngushtë me fushën „Jeta dhe puna”, ose tre shembuj nga rezultatet e fushës „Jeta dhe puna” (shkalla 3), apo tre shembuj nga rezultatet e lëndës mësimore, për të cilat pastaj përcaktoni teknikat e vlerësimit dhe kriteret e suksesit.*

Nr	Rezultatet e të nxënit	Teknika e vlerësimit	Kriteret e suksesit (1-5)				
	Nxënësi është në gjendje të:		Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
1							
2							
3							

**Vlerësimi për të nxënë.** Vlerësimi për të nxënë tashmë është pjesë e udhëzuesve për përmirësimin e praktikave në klasë. Është pjesë e programeve për aftësimin e mësimitdhënësve në shërbim. Ne nuk do të ndalimi në aspektet teorike, por vetëm po sjellim disa aspekte të vlerësimit për të nxënë, për të siguruar se vlerësimi për të nxënë është kuptuar në esencë dhe për të lehtësuar aktivitetet praktike me mësimitdhënës gjatë trajnimit ose zhvillimit profesional në këtë fushë.

Vlerësimi për të nxënë është instrumenti më i fuqishëm i vlerësimit, i cili gjeneron mësim. Ai „...i jep mundësi nxënësit të bëhet nxënës pa frikën se do të dështojë. Krijohet një mjedis mësimor dhe ofrohen mundësi për nxënësit t'i praktikojnë shkathtësitë dhe të marrin komente specifike dhe përshkruese që u ndihmojnë ta përmirësojnë të mësuarit..<sup>7</sup>”

Komentet kthyese të mësimitdhënësit për nxënësin, karshi të nxënit, janë karakteristikë e veçantë e vlerësimit për të nxënë. Hattie dhe Timperley e kanë propozuar një model të komenteve kthyese që shkon në katër nivele: komentet për detyrën (p.sh. komente kthyese nëse përgjigjet ish-in të sakta apo të gabuara, ose orientimi për të marrë më shumë informacione), komentet për procesin e detyrës (p.sh. komente kthyese lidhur me strategjitë e përdorura apo për strategjitë që mund të përdoren), komentet për vetërregullim (p.sh. komente lidhur me vetëvlerësimin apo vetëbesimin e nxënësit) dhe komente për nxënësin si person (p.sh. deklarime se nxënësi është ‘i mirë’ ose ‘i mençur’). Analiza e tyre vë në pah se niveli në të cilin është përqendruar komenti kthyes ndikon në efektivitetin e tij. Komentet kthyese për cilësinë e detyrës dhe komentet për procesin ose strategjitë e përdorura për kryerjen e detyrës janë më të dobishmet. Komentet që e tërheqin vëmendjen e nxënësve për strategjitë vetërregulluese apo aftësitë e tyre si nxënës mund të jenë efektive, nëse nxënësit e kuptojnë se do t'i rrisin rezultatet në qoftë se dëshirojnë t'i shtojnë

<sup>7</sup> Sherry Bennett and Dale Armstrong; *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13) f. 265

përpjekjet dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje. Komentet personale („Vajzë e mirë!”) nuk e tërheqin vëmendjen e nxënësit për të nxënëit e tyre.<sup>8</sup>

Pra, ofrimi i komenteve kthyesë nuk ka të bëjë me dhënien e lëvdatave, por ka të bëjë me **aktivitetet - hapat:**

- Lexoni në mënyrë individuale tregimin në vijim;
- Diskutoni me kolegë për mësimet e marra nga ky tregim;
- Diskutoni me kolegë shembuj praktikë nga përvoja juaj me nxënë, të ngjashëm ose të përafërt me tregimin;
- Përzgjidheni një përvojë të diskutuar në detaje dhe përshkruani rastin/shembullin në formë të tregimit;
- Prezantoni shembullin para kolegëve të tjerë.

### *Një tregim i vërtetë!*

Pas dymbëdhjetë vjet shkolle dhe gjashtë vjet në universitet, unë nuk mbaj mend ndonjë gjë që kam mësuar në lidhje me përgatitjet për provimin përfundimtar (vlerësimin përmbledhës). Por, e mbaj mend, sikur të ishte tani, përvojën time të parë me vlerësimin për të nxënë. Ma ofroi babai (i cili nuk ishte mësues).

Familja ime po përgatitej për pushimin e parë, larg shtëpisë, që nuk e kishte bërë ndonjëherë. I kisha dhjetë (10) vjet. E kishim një automobil të vogël, i cili nuk i zinte të gjitha valixhet. Kështu që babai vendosi ta ndërtonim një arkë të hapur për valixhe dhe ta vendosnim në mbajtëset e sipërme të automobilin. Më pyeti nëse më pëlqente ta dizajnoja dhe mi dha specifikat:

- I kishim dy dërrasa të cilat ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 30 centimetra të gjera. Këto dy dërrasa do të bëheshin pjesët anësore të arkës.
- Pjesa e poshtme e arkës duhej të ishte me dërrasa më të holla me hapësirë ndërmjet veti, që do të mundësonin kullimin e ujit nga arka në kulmin e automobilin, në rast se na zinte shiu rrugës.
- Dërrasat e holla do të formonin bazën e arkës, dhe arka do të montohej me anë të lidhëseve dado. Duhej t'i bënim 8 dërrasa të shkurtra prej 3 copave të dërrasave që ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 10 centimetra të gjera.

Kështu që fillova t'i bëja llogaritjet dhe ta dizajnoja; „do të ishte një punë e lehtë, kështu mendoja”. Pasi fillova të punojë, e pash se nevojitej më shumë mundësi sesa që kisha menduar, në fillim. Babai nuk më tha asnjëherë „këtë e ke gabim”. Ai do të më parashtronte pyetje si, „nëse do ta bësh arkën kaq të gjerë a do të përshtatej me hapësirën e mbajtëseve? „Nëse do t'i bësh dërrasat më të holla aq të gjata, a do të na mjaftojnë dërrasat? Ai më bënte vazhdimisht pyetje të cilat më bënin të mendohesha „brenda kontekstit”. Me fjalë të tjera, ai u referohej gjithnjë kriterëve që i kishim vendosur, si të ishin objektivat mësimore në një orë mësimi. Brenda një dite e kisha dizajnuar arkën. Dizajni funksionoi dhe e ndërtuam së bashku arkën. Isha shumë krenar dhe i gëzuar se unë „e kisha bërë atë”. Gjatë gjithë kohës po mësoja nën udhëzimet e babait.

### *Reflektim lidhur me tregimin*

Ajo që kishte bërë prindi me fëmijën e vet ishte përdorimi klasik i vlerësimin për të nxënë, por është një shembull që mësimdhënësit mund ta marrin dhe ta përshtatin për nxënësit e tyre në situata të mësimin, kur synojnë të praktikojë vlerësimin për të nxënë, sepse:

<sup>8</sup> David Lynn, Osman Buleshkaj dhe Selim Mehmeti (2012): Mësimdhënia dhe të nxënëit. EU-GIZ, Prishtinë. Cituar sipas Susan M. Brookhart; „Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment” f. 232

- Prindi gjatë gjithë kohës e inkurajonte fëmijën dhe i ofronte komente dhe sugjerime, të cilat nuk gjykonin, kishin fokus të qartë dhe ishin përshkruese;
- E angazhoi në procesin e dizajnit;
- E ndihmoi t'i gjejë gabimet dhe kufizimet dhe sigurohej që fëmija e dinte se cili ishte hapi tjetër;
- Ndërsa, fëmija i merrte veprimet për t'i korrigjuar gabimet dhe e zotëronte procesin e vet të mësimit.

*Inkurajohen mësuesit që të bëjnë të njëjtën gjë me nxënësit e tyre, në detyra dhe aktivitete mësimore.*

## Dimensionet e performancës për vlerësim

Zhvilluesit e përshkruesve të niveleve të performancës janë të dobishëm, sepse ato përqendrohen në përshkrimin e asaj se si nxënësit i kanë arritur standardet sipas dimensioneve: komunikimi, zgjidhja e problemeve, shfrytëzimi i TIK-ut, *shtrirja, shpeshësia, ndihma/fasilitimi, thellësia, kreativiteti dhe cilësia* e njohurive, aftësive dhe shkathtësive që ata i kanë fituar.

**Komunikimi:** i referohet komunikimit të dijes dhe aftësive të fituara brenda fushës së kurrikulës tek të tjerët, përfshirë këtu nxënësit dhe mësuesit.

**Zgjidhja e problemeve:** i referohet zgjidhjes së problemeve rutine dhe të reja, të thjeshta dhe komplekse brenda fushës së kurrikulës.

**Përdorimi i TIK-ut:** i referohet përdorimit të kompjuterëve dhe teknologjisë tjetër informative brenda fushës së kurrikulës.

**Shtrirja:** i referohet shtrirjes së të kuptuarit të rezultateve të të nxënësve të kurrikulës që janë zotëruar dhe cili është niveli i arritjes së rezultateve të të nxënësve për shkallë /fushë.

**Shpeshësia:** i referohet sa shpesh nxënësi demonstroi gjatë procesit mësimor dhe sa shpesh nxënësi është në gjendje të demonstrojë zotërimin e një kompetence.

**Ndihma/fasilitimi:** i referohet nivelit të njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve apo dhuntive që posedon dhe tregon një nxënësi. Nxënësi është i qartë për atë që e thotë apo e demonstroi, duke arsyetuar. Andaj, klasifikohet si një person që të tjerët mund të mësojnë nga ai apo ai u ndihmon të tjerëve.

**Thellësia:** i referohet thellësisë që nxënësi i ka përmbushur rezultatet e të nxënësve përmes niveleve të dijes.

**Kreativiteti:** i referohet aftësisë së nxënësve për të shkuar përtej asaj që është mësuar. Në termin „produkt“ është aftësia për të krijuar diçka të re, përmes frymëzimit, imagjinatës, vizionit, inspirimit dhe zgjidhjes së problemit në situata të reja.

**Cilësia:** i referohet njohurive dhe aftësive për të parë të mësuarit e nxënësve dhe përfshin identifikimin dhe tiparet kryesore të të mësuarit të nxënësve dhe se mësimi klasifikohet sipas shkallëve të përsosmërisë dhe vlerave.

Tabela e mëposhtme tregon disa nga termet që mund të përdoren në një sistem të performancës në nivel të klasifikuar të të mësuarit të nxënësve, në përputhje me secilin nga dimensionet.

DIMENSIONI	Niveli 1-rë	Niveli 2-të	Niveli 3-të	Niveli 4-të	Niveli 5-të
<b>Komunikimi</b>	<i>pasiv</i>	<i>me vështirësi</i>	<i>sipërfaqësisht</i>	<i>me lehtësi</i>	<i>rrjedhshëm</i>
<b>Zgjidhja e problemeve</b>	<i>asnjë element</i>	<i>të thjeshta</i>	<i>të zakonshme</i>	<i>mesatar</i>	<i>kompleks</i>
<b>Shfrytëzimi i TIK-ut</b>	<i>asnjë element</i>	<i>i varfër</i>	<i>i mirë</i>	<i>shumë i mirë</i>	<i>i avancuar</i>
<b>Shtrirja</b>	<i>aspak</i>	<i>ngushtë</i>	<i>pjesërisht</i>	<i>plotësisht</i>	<i>I zgjeruar</i>
<b>Shpeshtësia</b>	<i>asnjëherë</i>	<i>Rrallë</i>	<i>nganjëherë</i>	<i>zakonisht</i>	<i>përherë</i>
<b>Fasilitimi</b>	<i>asnjë element</i>	<i>ngadalë</i>	<i>në mëdyshje</i>	<i>shpejtë</i>	<i>automatikisht</i>
<b>Thellësia</b>	<i>asnjë element</i>	<i>sipërfaqësisht</i>	<i>cekët</i>	<i>adekuat</i>	<i>thellësisht</i>
<b>Kreativiteti</b>	<i>pasiv</i>	<i>imitues</i>	<i>i zakonshëm</i>	<i>imagjinues</i>	<i>krijues</i>
<b>Cilësia</b>	<i>dobët</i>	<i>varfër</i>	<i>mangët</i>	<i>shumë mirë</i>	<i>shkëlqyeshëm</i>

### Aspektet praktike të strategjive, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit

Me rastin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve mund përdorim strategji, teknika dhe instrumente të ndryshme, varësisht prej asaj se çfarë duam të masim.



Në kuadër të fushës *Jeta dhe puna*, një pjesë e madhe e aktiviteteve i dedikohen punës praktike. Kështu, vlerësimi për këtë fushë ka disa specifika dhe kërkon qasje të ndryshme. Njëra ndër format që mund të përdoret nga mësimitdhënësit e kësaj fushe është vëzhgimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve, i punës praktike që lidhet ngushtë me këtë fushë dhe mund të përdoret në shumë situata mësimore në të gjitha nivelet e shkollimit.

Për të vlerësuar bashkëpunimin dhe realizueshmërinë e kryerjes së detyrës si dhe punën në grupe, mund të përdorim **Buletin e pjesëmarrjes** si teknikë për vlerësim.



Për të vlerësuar nxënësin në formë të vazhdueshme, ku i matim njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet, mund të përdorim **Listën e kontrollit**, e cila shërben për të regjistruat përparimin e nxënësve në vazhdimësi.

Përmes kësaj fushe nxënësit angazhohen në aktivitete të ndryshme praktike, siç janë puna me Lego Robot, Krahu Robotik, Control Box, puna praktike duke bërë modele të ndryshme prej drurit, konstruktimi i kornizave xhinks, krijimi i filmave me flip kamera, si dhe përdorimi i kompjuterit për avancimin dhe zhvillimin e shkathtësive në TIK.

**Broshura** është një strategji e cila ndihmon të matim rezultatet e të nxënët.

Gjatë krijimit të broshurës nxënësi fiton njohuri, shkathtësi dhe qëndrime që ndihmojnë në përmbushjen e kompetencave, me çka mund të matet vlerësimi sasior dhe cilësor.



Përveç vlerësimit të nxënësve, është me rëndësi që mësimdhënësi të bëjë planifikim e vlerësimit edhe për punën që ai kryen.

Duke matur performancën e punës së mësimdhënësit, puna e mësimdhënësit bëhet me produktive për nxënësit. Shiko tabelën në vazhdim.

Niveli i arritjeve të nxënësve					Llojet e përkrahjes së nxënësve			
1	2	3	4	5	Përkrahja përmirësuese	Mënyrat	Përkrahje për të talentuarit	Mënyrat
Nxënësi e fillon detyrën pa i hedhur një shikim të shpejtë tekstit; ai ka vështirësi në modifikim in e broshurës .	Nxënësi e fillon detyrën pa i bërë një shikim të shpejtë tekstit: Ai ka vështirësi në gjetjen e shembullit konkret.	Nxënësi e fillon detyrën duke i hedhur një shikim të shpejtë tekstit: Ai ka gjetur vendin e modeleve, por jo modelin përkatës për broshurë.	Nxënësi e fillon detyrën duke i hedhur një shikim të shpejtë detyrës: Ai ka gjetur modelin dhe e ka modifikuar por jo sipas detyrës.	Nxënësi e fillon detyrën duke i hedhur një shikim të shpejtë detyrës: Ai ka gjetur modelin e broshurës, ka modifikuar secilën pjesë sipas kërkesës se detyrës.	Mësimdhënësi vendos se si të përkrah nxënësin, në cilin aktivitet apo çfarë aktiviteti plotësues të zhvillojë.	Mësimdhënësi vendos çfarë metodash do të aplikojë duke pasur parasysh stilin e të nxënët të nxënësit.	Mësimdhënësi vendos se si do ta përkrahë nxënësin, në cilin aktivitet apo çfarë aktivitetesh shtesë do të zhvillojë	Mësimdhënësi vendos se çfarë metodash do të aplikojë, duke pasur parasysh stilin e të nxënët te nxënësit.

Vlerësimi përdoret për të ndërtuar **portfolion** e të arriturave të nxënësit në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera dhe është bazë për raportet ose për certifikimin e mundësisë së shkollimit të tij të mëtejshëm.

Shumë shpesh mësimdhënësit janë konfuzë gjatë identifikimit të llojeve të vlerësimit, instrumenteve të vlerësimit dhe metodave të vlerësimit.

Mësimdhënësit kanë hapësirë të hartojnë instrumente të ndryshme të vlerësimit, të cilat janë në përshtatshmëri me fushën, si dhe duhet të merret parasysh niveli i pyetjeve, gjithmonë duke u bazuar në Taksonominë e Blumit.

## Vlerësimi i njohurive duke përdorur rezultatet e të nxënët

Ky vlerësim bazohet kryesisht në rezultatet e të nxënit nga plani ditor. Aktivitetet duhet t'u përshtaten rezultateve specifike të të nxënit, të cilat janë të nxjerra nga KB-të. Gjatë fazave të orës, mësuesi duhet të përdorë strategjitë e ndryshme që ndihmojnë dhe janë në funksion të matjes së njohurive të nxënësve.

Si shembull për matjen e njohurive, gjatë orës mësimore, përdoren rezultatet e kriteret të cilave mund t'u referohemi përmes strategjive të vlerësimit.

Njëra ndër strategjitë për vlerësim është edhe **Rubrika** që mund të përdoret nga vetë nxënësit për matjen e nivelit të arritjeve të tyre. Kjo strategji e vlerësimit bazohet kryesisht në rezultatet e të nxënit të orës mësimore (plani i orës mësimor). Arritja e rezultateve demonstron në bazë të shkallës së përmbushjes së aktiviteteve. Secila shkallë e arritjes përcaktohet sipas ngjyrave.

Ngjyra e gjelbër tregon nivelin e arritjes së lartë;

Ngjyra e verdhë tregon nivelin e arritjes së pjesshme;

Ngjyra e kuqe tregon nivelin e arritjes së ulët.

Aktiviteti	E gjelbër	E verdhë	E kuqe
<b>Përshkruani se për çka përdoret broshura</b>	Kam përshkruar përdorimin e broshurës për reklama, sensibilizim, informim	Kam përshkruar përdorimin e broshurës disi	Kam përshkruar fare pak për përdorimin e broshurës
<b>Modeloni broshurën me dizajnin modular</b>	Kam modeluar broshurën me modular	Kam modeluar broshurën me model tjetër	E kam modeluar broshurën por nuk e di modelin
<b>Përcakto qartë titullin e broshurës</b>	Kam përcaktuar qartë titullin e broshurës, në harmoni me përmbajtjen	Titulli nuk është shumë i përshtatshëm me përmbajtjen	Titulli i broshurës është ndryshe dhe jo i duhuri

Përcjellja e zhvillimit të kompetencave arrihet kur kemi më shumë të dhëna të akumuluar për të nxënit e fëmijëve. Mjeti më i përshtatshëm për mbledhjen e të dhënave për vlerësim është edhe dosja.

**Dosja (portfolio)**






Është një koleksion i qëllimshëm i punimeve të nxënësve, që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tyre, në fushë e caktuar mësimore. Këtu përfshihet pjesëmarrja e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhjen dhe kriteret e vlerësimit për të dëshmuar për meritat dhe dëshmitë e vetëreflektimit të nxënësit.

Ky lloj i vlerësimit është vlerësim për të nxënësit (vlerësim formativ), pasi që për një kohë të gjatë vazhdimisht mblidhen informatat për zhvillimin e nxënësit.

Është me rëndësi që të vendosni për qëllimet e dosjes, të caktoni rezultatet e pritura dhe si mund të shfrytëzohet dosja për t'i përmbushur ato rezultate.

Ky lloj i vlerësimit ndihmon për arritjen e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve. Ndërsa, stili i të nxënësit, të kjo strategji, është pamor, lëvizor.

### Krijimi i dosjes



### Vlerësim i aktiviteteve

## Shembull:

Lënda : TIK

Mesimdhënesi:

Vlerësim i aktiviteteve

- Instalimi i Windows 7
- Portet për komunikim me pajisje
- Pajisjet q shërbejnë për komunikim dhe informim në TIK. Lidhja e tyre me kompjuter ose pajisje tjera

Vlerësimi i ndërsjellët (VLERËSO SHOKUN/SHOQEN)

Vlerësimi i ndërsjellët

Emri i nxënësit që e vlerëson shokun \_\_\_\_\_

Emri i nxënësit që vlerësohet nga shoku \_\_\_\_\_

- Instalimi i Windows 7 - Pikët nga 1- 10 për secilën pjesë.

Nr	Nx. Ka treguar se:	Po apo JO	Pikët (trego sa pikë ka secila pjesë)	Komente/arsyetime
1	Windows 7 është sistem operativ			
2	Ka treguar ecurinë hap pas hapi të instalimit të Windows 7			
3	Ka paraqitur vendin ku instalohet Windows 7			
4	Ka treguar disa lloje të Windowsit			
5	Ka paraqitur rendësin e mbrojtjes me kod (dhe emrin e kompjuterit)			

Vetëvlerësim

Emri dhe mbiemri i nxënësit \_\_\_\_\_

- Trego 3 porta te kompjuterit-lidhja e pajisjeve mes tyre dhe funksionin.

Aktiviteti	E gjelbert	E verdhe	E kuqe
Përshkruan portat e kompjuterit	Tregon 3 porta të kompjuterit duke paraqitur përdorimin e pajisjeve ne to dhe funksionin	Tregon 2 porta të kompjuterit duke treguar vetëm emrat e tyre dhe Një pajisjeje që lidhet me to	Tregon vetëm 2 emra te portave të kompjuterit
Përshkruan 3 pajisje që vendosen ne portin e USB	Paraqet 3 pajisje, funksionin dhe lidhjen e tyre në portat e USB	Përshkruan lidhjen e Një pajisje me portën e USB duke treguar dhe funksionin	Tregon vetëm portën USB që e lidh me Një pajisje pa funksionin e pajisjes

Vlerësimi i ndërsjellët

Emri i nxënësit që e vlerëson shokun \_\_\_\_\_

Emri i nxënësit që vlerësohet nga shoku \_\_\_\_\_

- Pajisjet që shërbejnë për komunikim dhe informim në TIK. Lidhja e tyre me kompjuter ose pajisje tjera

Nr.1	Vlerësimi: 0=dobët deri 5=shumë mirë	Dëshmitë	Informata kthyesë (Mësimdhënësi)
Paraqet 3 pajisjet për informim duke treguar funksionin			
Paraqet 3 pajisjet për komunikim duke treguar funksionin			
Përshkruan një pajisje për komunikim dhe informim duke treguar aplikimin në praktikë			
Numëron se paku 5 pajisje për informim dhe komunikim.			

## VIII. Bashkëpunimi i mësimeve

Çelësi i suksesit të nxënësve qëndron në bashkëpunimin kolegjial të mësimeve. Kjo do të thotë që, në mes të mësimeve, nuk duhet të ketë xhelozë, sepse të gjithë synojnë zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve; nuk duhet të kenë frikë dhe turp nga njëri-tjetri, sepse të gjithë janë të përgatitur për përkrahje të nxënësve; nuk duhet t'u vijë turp të kërkojnë ndihmë, sepse këtë e bëjnë për nxënësit. Mos harro: **Transparenca eliminon çdo vështirësi!**

Zbatimi i filozofisë së KKK-së dhe KB-ve domosdo kërkon bashkëpunimin në mes të mësimeve. Bashkëpunimi duhet të bëhet në nivel të Këshillit të klasës-ve, por edhe të aktiveve profesionale.

Mësimeve duhet të mbajnë takime javore për planifikimin e aktiviteteve të ndryshme me nxënësit, si dhe të bëjnë adaptimin e mjeteve mësimore për planifikimin e tyre.

Mësimeve e fushës *Jeta dhe puna* duhet të bashkëpunojnë me mësimeve e fushave të tjera dhe të fushave të ndryshme kurrikulare, duke i ndihmuar në realizimin e orëve praktike me përdorimin e teknologjisë përfundimtare dhe me përkrahjen e Klubit të Teknikëve (nxënësit në bashkëpunim me mësimeve).

Mësimeve e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet të bashkëpunojnë ndërmjet vete, por edhe me mësimeve e niveleve të tjera. Ky bashkëpunim duhet të reflektohet në planifikimet mësimore, që do të thotë se mësimeve e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet, bashkërisht, të hartojnë planifikimet për shkallë dhe planifikimet vjetore për të vazhduar më pas në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në hartimin e planifikimeve detyrore, të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga mësimeve e paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mësimeve duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin edhe për hartimin e planifikimeve javore, edhe pse ata janë përgjegjës vetëm për një paralele.



Bashkëpunimi i mësimeve duhet të reflektohet edhe në shkëmbimin e përvojave të metodologjisë së mësimdhënies, të vlerësimit, dhe në krijimin e shkëmbimin e materialeve mësimore.

Mësimeve mund të marrin iniciativë për ngritje profesionale brenda shkollës, duke mbajtur vetë punëtori për çështjet e ndryshme që janë në funksion të mësimdhënies.

Mësimeve, bashkërisht, mund t'i përgatisin nxënësit edhe për gara të ndryshme, për kuize diturie, gara sportive, ekspozita dhe aktivitete të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe në arritjen e kompetencave të caktuara.

Gjithashtu, suksesin e zbatimit të KKK-së e forcon edhe bashkëpunimi me mësimeve e shkollave të tjera, duke shkëmbyer përvojat, literaturën, linçet, informatat dhe njohurit e marra nga trajnimet e ndryshme.

# **SHTOJCË**

**Modele të planifikimeve të mësimdhënësve të shkollave pilot dhe materiale  
të mësimdhënies dhe të vlerësimit**

Ato mund të jenë të ndryshme nga shkolla në shkollë

*Autorët falënderojnë mësimdhënësit e shkollave pilot për punën dhe materialet e siguruar.*

## **Shtojca 1: Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit**

Gjetja e fjalëve të duhura për hartimin e rezultateve të të nxënit/kritereve të vlerësimit mund të jetë e vështirë. Veçanërisht e vështirë mund të jetë, kur fjalitë duhet të përputhen me nivelin e përgjithshëm të përshkrimit. Lista në vijim mund të përdoret për t'ju ndihmuar në këtë proces. Fjalët janë të organizuara në nëntituj që korrespondojnë me astronominë e Bloom-it. Megjithatë, kjo renditje nuk paraqet kurrfarë hierarkie. Fjalët përbëjnë thjeshtë një listë të vokabularit të vjelë nga burime të ndryshme për t'ju ndihmuar në hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit.

**Foljet që kërkojnë fakte për njohuritë:** Defino, përshkruaj, identifikoj, emëro, listoj, riprodho, përsërit, përzgjedh, deklaro, prezanto, ji i vetëdijshëm, nxjerr, organizo, rinumëro, shkruaj, prano, mat, nënvizo, ndërlidh, bashko.

**Foljet që kërkojnë fakte për të kuptuarit:** Interpretoj, përkthe, llogarit, arsyeto, shpreh, konverto, qartëso, mbro, dallo, shpjego, zgjero, gjeneralizo, ilustruj, ofro shembuj, parafrazo, parashikoj, rishkruaj, përmbledh, diskuto, përformoj, raportoj, prezanto, identifikoj, tregoj, gjej, përzgjedh, kuptoj, përfaqëso, emëro, formuloj, gjyko, krahasoj, klasifikoj, shpreh.

**Foljet që kërkojnë fakte për të njohuri/kuptuarit:** Apliko, zgjidh, ndërtoj, demonstro, ndryshoj, llogarit, zbulo, manipuloj, modifikoj, operoj, parashikoj, përgatit, prodhoj, ndërlidh, tregoj, përdor, jep shembuj, hartoj, përzgjedh, shpjego, gjej, vlerëso, ushtrij, ilustruj, verifikoj.

**Foljet që kërkojnë fakte për analizë:** Prano, dallo, vlerëso, analizoj, zbërthe, diferencoj, identifikoj, ilustruj, përshkruaj, përmend, ndërlidh, përzgjedh, ndaj, nënndaj, krahasoj, justifikoj, zgjidh, ekzamino, përmbledh, kritikoj, kontestoj, diagnostikoj, identifikoj, kategorizoj, shpjego.

**Foljet që kërkojnë fakte për sintezë:** Propozoj, prezanto, ndërtoj, integroj, formuloj, mëso, zhvilloj, kombino, kompozoj, krijoj, ndaj, dizajnoj, shpjego, gjeneroj, modifikoj, organizoj, planifikoj, riaranzhoj, rindërtoj, ndërlidh, riorganizoj, rishikoj, shkruaj, përmbledh, tregoj, raportoj, ndryshoj, argumentoj, rendit, përzgjedh, menaxhoj, gjeneralizoj, nxjerr, përfundoj, shkaktoj, sintetizoj, sugjeroj, zgjeroj.

**Foljet që kërkojnë evidencë për vlerësim:** Gjyko, vlerëso, përmbledh, krahasoj, përshkruaj si, kritikoj, shpërndaj, arsyeto, mbro, grado, përcaktoj, zgjedh, çmo, kontestoj.

Gosling, D. & Moon, J. (2002) Hoë to use Learning Outcomes 6 Assessment Criteria - Learning Development Unit, London Metropolitan University. UK.

## **MODELE TË PLANIFIKIMIT MËSIMOR**

### **Jeta dhe puna / Shkalla III**

(Kujdes: Modelet ofrojnë një orientim për punën që duhet bërë mësimeve të fushës në nivel shkolle. Planifikimet në nivel shkolle duhet të përfshijnë të gjitha rezultatet e fushës dhe konceptet e fushës për shkallën përkatëse të kurrikulës, ky model është i vetëm një shkollë, cdo shkollë mund të ketë specifikat e veta për ti planifikuar)

## PLANI VJETOR - 2016 /2017

Fusha e kurrikulës: JETA DHE PUNA \_\_\_\_\_ Klasa : VI

Lëndët e fushës kurrikulare	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator-Tetor	Nëntor -Dhjetor	Janar- Shkurt	Mars – Prill (java I)	Prill - Maj	Qershor	
Lënda: Teknologji duke përfshirë TIK-un	<p>1. <b>Materialet dhe përpunimi I tyre (10 orë)</b></p> <p>2. <b>Njeriu dhe Shoqëria në teknologji (8 orë)</b></p>	<p>3. <b>Shkathësitë e dizajnit (8 orë)</b></p> <p>4. <b>Shkathësitë e të punuarit (5-6 orë)</b></p>	<p>4. <b>Shkathësitë e të punuarit (5 orë)</b></p> <p>5. <b>Teknika bujqësore dhe e ndërtimitarisë (11)</b></p>	<p>6. <b>Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia (6 orë)</b></p> <p>7. <b>Teknologjia e Informimit dhe komunikimit (4)</b></p>	<p>7. <b>Teknologjia e informimit dhe e komunikimit (6)</b></p> <p>8. <b>Këshillimi dhe orientimi në karriere (7orë)</b></p>	<p>8. <b>Të jesh ndërmarrës do të thotë (7orë)</b></p>	<p><b>TEMA 1:</b> I. 1,2,3,4,5,6,7,8, II.1,3,4,5, 6,7,8, III.1,2,3,4,5,6,7,8 IV.1,4,5,7,V.5,6</p> <p><b>TEMA 2:</b> I.1,2,3,4,5,6,7,8, II. 8,III.1,2,3,4,5,6,7,8, IV.1,2,3,4,5, 7, V.3,4, 5,6</p> <p><b>TEMA 3:</b> I.1,2,3,4,6,7, II.1,3,4,5,6,8, III.1,2,3,4,5,6,7,8,IV.1,5,7,VI.1,5, 6)</p> <p><b>TEMA 4:</b> I.1,2,3,4,5,6,7,8,II.1,3,4,5,6,7,8,III. 1,2,3,4,5,6,7,8,IV.1,2,7,V.7,VI.1,5 ,6,7,8</p> <p><b>TEMA 5:</b> I.1,2,3,4,6,7,8,II.1,5,6,III.1,2,3,4,5, 6,7,8,IV.1,2,3,4,5,6,7,V.2,VI.1,3,6</p> <p><b>TEMA 6</b> :I.1,2,3,4,5,6,7,8,II.1,3,4,5,6,7,III. 1,2,3,4,5,6,7,8,IV.1,2,5,7,V.5,7</p>
Lënda:							



## PLANI DYMUJOR

**Fusha e kurrikulës: JETA DHE PUNA Lënda mësimore: TEKNOLOGJI duke përfshirë TIK-un Klasa: VI**

**Temat mësimore: 1. Materialet dhe përpunimi i tyre, 2. Njeriu dhe shoqëria në teknologji**

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

TEMA 1: I. 1,2,3,4,5,6,7,8, II.1,3,4,5, 6,7,8, III.1,2,3,4,5,6,7,8 IV.1,4,5,7,V.5,6

TEMA 2: I.1,2,3,4,5,6,7,8, II. 8,III.1,2,3,4,5,6,7,8, IV.1,2,3,4,5, 7, V.3,4, 5,6

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: RNF: 1.1,2, 2.1, 3.1,2, 4.1**

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë Mësimore	Koha e mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet
1. Materialet dhe përpunimi i tyre,  3. Njeriu dhe shoqëria në teknologji	Tema 1. Identifikon vetitë elementare të materialeve të cilat përdoren në industri dhe teknologji –Përshkruan metodat e përpunimit dhe formimit të materialeve(druri,letra); fazat e punës -shpjegon se ç’është lënda e parë, gjysmëprodhimet dhe prodhimet finale Tregon përdorimin e teknologjisë në mjedis nga	TEMA:1 1.1.1.Njohja me planprogramet, materialet dhe përpunimi i tyre 1.1.2. Teknologjia e përpunimit të letrës 1.1.3. Llojet dhe vetitë e letrës 1.1.4. Përpunimi i letrës-origami 1.1.5 Punë praktike me letër 1.2.1. Llojet e drurit në vendin tonë 1.2.2 Teknologjia e prodhimit dhe përpunimit të drurit 1.2.3 Druri në jetë-përdorimi i tij 1.2.4- Punë praktike me dru 1.2.5. Kuiz përmes TIK-ut Tema 2 2.1.1 Njeriu dhe shoqëria në	• 18	Gjithpërfshirja dhe nxënësi në qendër Të nxënit në bashkëpunim  Punë me projekte Aktivitete praktike me vegla dhe materiale teknologjike	Informata kthyese Vlerësim i ndërsjellët Vetëvlerësim Vlerësimi përmes punimeve-aktiviteteve	Shkencat e natyrës (vetitë e drurit, letrës, [përbërësit e ushqimit])	Libri i Teknologjia 6, Aftësimi Teknologjik 6 •

	<p>hulumtimi i bërë në internet dhe libra të ndryshëm          Diskuton për rendësin e pyjeve për shëndetin e njeriut          Merr pjese në organizime të ndryshme për ruajtjen e ambientit.          Ben punime të ndryshe me materiale ricikluese.          Identifikon materialet plastike te riciklueshme dhe ekologjike si dhe ato te pa riciklueshmet          Tema 2:          Tregon përdorimin e teknologjisë në mjedis nga hulumtimi i bërë në internet dhe libra të ndryshëm</p> <p>Dallon ndotje të ndryshme nga teknologjia në mjedisin shkollor          Tregon ndikimin e teknologjisë në mjedisin ku jetojmë          Harton një plan për parandalimin e ndotjeve nga teknologjia dhe mbrojtjen nga pajisjet teknologjike të dëmshme për shëndetin          Kryen aktivitete praktike për të kuptuar realisht ndotjen nga teknologjia</p>	<p>teknologji</p> <p>2.1.2 Mjedi dhe teknologjia ekologjike</p> <p>2.1.3. Mjedi fizik dhe social</p> <p>2.1.4. Pajisjet teknologjike në mjedis</p> <p>2.1.5. Banesat</p> <p>2.1.6- Mjedi dhe banesat - Punë praktike</p> <p>2.1.7. Teknologjia ushqimore</p> <p>2.1.8. Ushqimi dhe trupi ynë-praktikë</p>					
--	--	---	--	--	--	--	--

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

### ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: **Jeta dhe Puna** / Lënda: \_\_\_\_\_ Shkalla e kurrikulës: 2 / Klasa: 5-të

**Tema**(Ng plani dymujor): **Ekonomia Familjare**

**Rezultati i të nxënit të temës**

(Nga plani dymujor):

1. Tregon konceptet kryesore të ekonomisë familjare përmes shembujve në jetën e përditshme
2. Tregon për veten, familjen dhe mjedisin, duke përshkruar rëndësinë e ekonomisë familjare

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I.2,3, II.3,4, 6 III.2,5, IV.1,4, V.6, VI.1,2,5

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.1,2, 2.1,4.1, 6.1

### ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore : Ekonomia familjare

Fjalët kyçe : Ekonomia familjare, kursimi, paratë, shpenzimi

Rezultat-i/et e të nxënit për orë mësimore:

Kriteret e suksesit:

1. Përshkruaj rëndësinë e ekonomisë familjare në disa shembuj konkret në tabelë
2. Planifiko buxhetin personal në fletë A4
3. Harto planin e kursimeve për të hyrat personale dhe elementet e shtëpisë

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Projektori, Kompjuteri, tabela, markere, Power Point, You tube.

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dheme çështjet ndërkurrikulare:**

**Matematika-** në lidhje me llogaritjet, formulat për statistika,

**Shoqëria dhe Mjedi**si (Edukimi, kultura personale për menaxhim dhe kursim të elementeve kryesore të shtëpisë)

**Çështjet ndërkurrikulare:** Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm lidhur me matematikën (llogaritjet e sakta për kursim dhe menaxhim familjar të parave)

### PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

**Pjesa hyrëse:**

Mësimdhënësi përshkruan një shembull praktik në klasë nga ekonomia familjare duke paraqitur rëndësinë dhe funksionin e saj në jetë.

Përmes shembullit paraqet rolin e menaxhimit dhe vlerën e parasë në jetë

**Pjesa kryesore:**

Mësimdhënësi shpërndan fleta A4 ku kërkon nga nxënësit, për 20 min të planifikojnë buxhetin personal për

një ditë, duke paraqitur, në vlera numerike dhe të mendojnë një plan të kursimit të shpenzimeve. Gjatë planifikimit mësimdhënësi ofron udhëzime dhe ndihmë në kalkulime dhe gjetje të zgjidhjes.

**Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit të orës mësimore:**

Nxënësit prezantojnë planifikimin e shpenzimeve duke paraqitur planin e kursimeve në shpenzimet ditore

**VLERËSIMI I NXËNËSVE**

**Përmes vlerësimit për të nxënit (Listës së kontrollit), mësimdhënësi i ndihmon nxënësit në përmirësimin e planifikimit të buxhetit personal.**

*Gjithashtu vëzhgon ndarjen e buxhetit a është në formë të drejtë apo jo.*

**DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

Detyre e pavarur shtëpie, për të gjithë nxënësit: Identifiko pajisjet të cilat shpenzojnë më shumë në shtëpi dhe format e kursimit të rrymës, ujit, etj.

**Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

**Mësimdhënësi, pas çdo ore mësimore, reflekton (vetëvlerëson) për rrjedhën e orës mësimore në të gjitha aspektet.**

## Instrumenti i vlerësimi –Lista e Kontrollit

**Aktiviteti: Planifikimi i buxhetit personal**

**Nxënësi/Grupi:** \_\_\_\_\_

**Vlerëson mësimpldhënësi**

<b>Nr</b>	<b>Pjesët për kontrollim</b>	<b>Shëno saktësisht gjithë informacionin</b>	<b>Piket 0-10</b>	<b>Arsyetim/Koment</b>
1	Ka paraqitur detajisht planin për përcaktimin e buxhetit personal			
2	Ka ndarë shpenzimet primare dhe ato sekondare			
3	Ka paraqitur vlerat e sakta për elementet e ndryshme në buxhet personal			
4	Ka kalkuluar saktësisht shpenzimet e nevojshme për një ditë			
5	Ka bashkëpunuar me nxënësit tjerë për realizimin e aktivitetit.,			
6	Ka hartuar planin e kursimeve për shpenzime të ndryshme në grup			
7				
8				

### Listë Kontrolli

**Aktiviteti: Planifikimi i buxhetit personal**

**Nxënësi/Grupi:** \_\_\_\_\_

**Vetëvlerësim**

<b>Nr</b>	<b>Pjesët për kontrollim</b>	<b>Shëno saktësisht gjithë informacionin</b>	<b>Shenjezo me shenjën ☑ nëse është kryer me sukses „-“ Nëse nuk është kryer me sukses „-+“ Nëse është kryer disi detyra</b>	<b>Arsyetim/ Koment</b>
1	Ka paraqitur detajisht planin për përcaktimin e buxhetit personal			
2	Ka ndarë shpenzimet primare dhe ato sekondare			
3	Ka paraqitur vlerat e sakta për elementet e ndryshme në buxhet personal			
4	Ka kalkuluar saktësisht shpenzimet e nevojshme për një ditë			
5	Ka bashkëpunuar me nxënësit tjerë për realizimin e aktivitetit.,			
6	Ka hartuar planin e kursimeve për shpenzimet e ndryshme			
7				

Instrument vlerësimi për orën mësimore :**Punimi i skicës së prodhimit të objektit**

Nxënësi: \_\_\_\_\_

Është me rëndësi të identifikohen nxënësit që kanë nevojë për përmirësim dhe përkrahje shtesë në aktivitetet përkatëse për të ofruar forma dhe materiale të ndryshme adekuate për ta, si dhe të identifikohen nxënësit talent që duhet t'u mundësojmë kushte shtesë për t'i avancuar në nivelin e tyre të arritjes. Rubrikat e para në llojet e përkrahjeve u takojnë nxënësve që kanë nevojë për përmirësim, ndërsa 2 rubrikat e dyta i takojnë nxënësve më të avancuar në mësim

KOMPETENCA I.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Komunikues efektiv	AKTIVITETI	NIVELI I ARRITJES SË NXËNËSIT					Komente	LLOJET E PËRKRAHJES PËR NXËNËSIN			
		1	2	3	4	5		Përkrahja përmirësuese	Mënyra	Përkrahja për të talentuarin	Mënyra
I.3 Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazete, reviste, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.	1.Identifikimi i rreziqeve në punë			Nxënësi ka veçuar informata të kryesorë për format dhe rëndësinë e rreziqeve			Të japë më shumë ndihuri, informata në shembuj për format dhe rëndësinë e rreziqeve në punë	Forma grupore (me raste edhe individuale) për përkrahje dhe udhëzime të ndryshme për burimet nga interneti		.	
II.3 Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mësimore (letrare, shkencore, artistike).	1.Identifikimi i rreziqeve në punë				Ka paraqitur planin për marrjen e masave për rreziqet e mundshme në punë				Ka paraqitur dy apo me shumë forma të parandalimit të rreziqeve	Forma individuale që nxjerr në pah nxënësit më të talentuar.	

**Kriteret e Suksesit:**

Nr.	Rezultatet e të nxënit	Kriteret	Kriteret e vlerësimit (1-5)				
	Nxënësi është në gjendje të:		Shkëlqyeshëm	Shumë mirë	Mirë	Mjaftueshëm	Dobët
1	Skicon prodhimin e thjeshte sipas vetive të materialit, funksionit, estetikës, çmimit, etj.	1.Trego si bëhet skica	Ka përshkruar të gjitha hapat për krijimin e skicës duke përdorur shembuj konkret	Ka përshkruar disa hapa për krijimin e skicës duke	Ka përshkruar disa hapat për krijimin e skicës	Ka përshkruar shumë pak krijimin e skicës	Nuk ka bërë një përshkrim të saktë për krijimin e skicës
		2.Krahaso skicën me vizatim të artit figurativ përmes vizatimit të një objekti					
		3.Skico një objekt që ke përpara					
2	Punon në mënyrë të pavarur objekte të ndryshme nga druri dhe letra duke përdorur veglat elementare						
3							

Ne rast të caktimit të kriterëve nga nxënësit bashkë me mësuesin, të hartohet një instrument i vlerësimit ku nxënësit mund të masin kriteret duke i identifikuar me një shenjë √ nivelin e plotësisht të kriterit. Psh.

Nr.	Rezultatet e të nxënit	Kriteret	Kriteret e vlerësimit (1-5)				
	Nxënësi është në gjendje të:		Shkëlqyeshëm <input type="checkbox"/>	Shumë mirë <input type="checkbox"/>	Mirë <input type="checkbox"/>	Mjaftueshëm <input type="checkbox"/>	Dobët <input type="checkbox"/>
1	Skicon prodhimin e thjeshte sipas vetive të materialit, funksionit, estetikës, çmimit, etj.	1.Tregojmë si bëhet skica	Kemi përshkruar të gjitha hapat për krijimin e skicës duke përdorur shembuj konkret	Kemi përshkruar disa hapa për krijimin e skicës duke	Kemi përshkruar disa hapat për krijimin e skicës	Kemi përshkruar shumë pak krijimin e skicës	Nuk kemi bërë një përshkrim të saktë për krijimin e skicës

Kriteri i suksesit -Si do ta dimë nëse e kemi arritur suksesin?

Kriteret e suksesit kanë ndikim në mësimdhënie ashtu dhe në nxënie te nxënësit të cilëve u mundëson ta vlerësojnë veten dhe shokët e tyre.



Në figurën e paraqitur më lartë nxënësit vlerësojnë njëri-tjetrin duke krahasuar punën e tyre me kriteret e suksesit.

***Tani është shumë më lehtë për të mësuar. sepse ne e dimë se çfarë të bëjmë dhe si t'i kryejmë detyrat***

***Nxënës i klasës V***



## **PAKOJA E INSTRUMENTEVE PËR PLANIFIKIMIN MËSIMOR**

Pakoja përfshin katër instrumente për planifikimin mësimor që u dedikohen të gjitha fushave të kurrikulës/ lëndëve mësimore:

- Plani vjetor
- Plani dymujor
- Plani javor, dhe
- Plani i orës mësimore

## PLANI VJETOR - 2016 /2017

**Fusha e kurrikulës:** \_\_\_\_\_ **Klasa :** \_\_\_\_\_

Lëndët e fushës	TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
	PERIUDHA (I)		PERIUDHA (II)		PERIUDHA (III)		
	Shtator-Tetor	Nëntor -Dhjetor	Janar-Shkurt	Mars – Prill (java I)	Prill - Maj	Qershor	
Lënda:							
Lënda:							
Lënda:							

## UDHËZIME PËR PLOTËSIM TË TABELËS

### Udhëzime hyrëse

- Ky format i tabelës/instrumentit të planit vjetor përdoret për të hartuar planet vjetore për të gjitha fushat e kurrikulës, lëndët mësimore dhe për secilën klasë.
- Planifikimi i përbashkët në kuadër të *Departamentit profesional /Aktivitet profesional/ Këshillit të klasave në nivelin fillor* është kusht themelor në procesin e planifikimit vjetor.
- Planifikimi i përbashkët në kuadër të fushës kurrikulare, siguron një segment të rëndësishëm të qasjes së integruar dhe të zhvillimit të kompetencave kryesore/rezultateve të të nxënësve të shkollës (RNK). Në kontekstin e praktikës shkollore, planifikimi i përbashkët dhe organizimi i nxënësve së integruar kërkon punë të përbashkët të mësimdhënësve, menaxhim fleksibil të kohës në dispozicion dhe të hapësirës shkollore e mjeteve mësimore. Kurrikula e re kërkon integrimin e kompetencave profesionale të mësimdhënësve. Prandaj, Departamenti profesional/Aktiviteti profesional/ Këshilli i klasave në nivelin fillor/ duhet t'i shqyrtojë me kujdes përparësitë dhe mangësitë në punën e vet, që të mund të planifikojë dhe zbatojë një plan vjetor që e ruan frymën e kurrikulës së re - qasjen e bazuar në kompetenca.

### Udhëzime për hapat që duhet ndjekur gjatë përgatitjes së planit vjetor

- **Hapi i parë – Përgatitja për planifikim.** Fillimi i procesit të planifikimit vjetor, kërkon pjesëmarrjen aktive të të gjithë mësimdhënësve të fushës përkatëse/mësuesve në nivelin fillor, sigurimin e dokumenteve të kurrikulës (Kurrikulën bërthamë dhe programet lëndore) dhe të raporteve të punës nga klasa paraprake. Përgatitja e mirë për planifikim, siguron që mësimdhënësit, gjatë planifikimit, të mbështeten në programet lëndore të hartuara nga grupet punuese nën udhëheqjen e MASHT-it, në dokumentin e Kurrikulës bërthamë për nivelin - shkollën përkatëse të kurrikulës, në planin mësimor për lëndë, në kohëzgjatjen e secilës nga tri periudhat e ndara për një vit mësimor dhe në nevojat e nxënësve për përkrahje në zotërimin e kompetencave kryesore.
- **Hapi i dytë: Analiza përmbajtjesore.** Brenda Departamentit profesional /Aktivitet profesional/ Këshillit të klasave në nivelin fillor, analizohen dhe shqyrtohen:
  - *përvojat e mësimdhënësve për temat e programeve lëndore të realizuara në vitet paraprake,*
  - *Temat e reja, që për herë të parë fillojnë të zhvillohen në klasën dhe lëndën përkatëse,*
  - *Lidhjet e temave mësimore me lëndët tjera brenda fushës së kurrikulës dhe me lëndët tjera,*
  - *rendi logjik i trajtimit të temave përgjatë vitit mësimor,*
  - *thellësia dhe gjerësia e trajtimit të temës në përputhje me veçoritë e klasës dhe stilet e të nxënësve*
  - *koha mësimore minimale e përcaktuar me planin mësimor (orët e mësimimit që i ka secila lëndë mësimore, brenda një viti shkollor)*
  - *mundësitë që ofron shkolla për organizimin e orëve të mësimimit mbi kohën minimale, organizimin e mësimimit plotësues dhe shtues, etj.*
  - *ndarja e vitit mësimor në tri periudha dhe mundësitë e realizimit të programit të lëndëve brenda secilës periudhë të vitit mësimor, etj.*
- **Hapi i tretë: Vendosja e temave në periudhën dymujore.** Brenda dy muajsh, mund të jenë disa tema mësimore, 1, 2, apo me shumë tema, varësisht sa mësimdhënësit mendojnë se janë të nevojshme të trajtohen brenda muajve (Preferohet numri i vogël i temave). Disa tema mund të jenë të pranishme edhe

në muajt e tjerë, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të behet mbi analizën dhe konkluzionet e bëra në hapin e dytë.

- **Hapi i katërt: Vendosja e numrit të orëve mësimore për tema mësimore.** Mësimdhënësi duhet të konsultojë planin mësimor për klasë dhe lëndë mësimore, të miratuar nga MASHT-ti. Vendosja e numrit të orëve mësimore bëhet në bazë të konkluzioneve të bëra nga hapi i dytë, përkatësisht nga rezultatet e të nxënimit për temë. Afër secilës temë për lëndën përkatëse vendoset numri i orëve mësimore për temë (p.sh. 4 orë). Vendosja e orëve mësimore për tema mësimore, në kuadër të planifikimit vjetor, mund të jetë orientuese dhe fleksibile me mundësi ndryshimi gjatë zbërthimit të planeve dymujore. Vendosja e orëve mësimore për tema në këtë fazë siguron një pasqyrë të mbulueshmerisë së programit mësimor brenda kohës mësimore në dispozicion që ka secila lëndë mësimore dhe brenda kalendarit të vitit mësimor.
- **Hapi i pestë: Vendosja e rezultateve të të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës.** Në kolonën për kontributin në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës, shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca që mendohet se duhet të arrihen përmes temave që zhvillohen përgjatë gjithë vitit mësimor, apo që zhvillimi i këtyre temave i kontribuon arritjes së rezultateve të të nxënimit, të vendosura për këtë periudhë. Këto rezultate mund t'i gjeni te rezultatet e të nxënimit të shkallëve kurrikulare. Për çështjet praktike, në kolonën Kontributi në rezultatet e të nxënimit për kompetencat kryesore të shkallës, rezultatet mund të shënohen me numra origjinale siç janë në KB, por gjatë planifikimit duhet të kuptohet në esencë rezultati i kompetencës, në mënyrë që të mund të bëhet ndërlidhja me segmentet e tjera të planifikimit. Mësimdhënësit i përcaktojnë rezultatet e kompetencës që synojnë t'i arrijnë përmes lëndës mësimore dhe fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temave mësimore. Të gjitha lëndët mësimore, për sa klasë që ka shkalla, duhet synojnë të arrijnë të gjitha rezultatet e kompetencave. D.m.th., nëse shkalla i ka dy klasë, atëherë për dy vite shkollë-mësimore, një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën bërthamë. Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e shkallës (kompetencës) do t'i synojë t'i arrijë p.sh. në klasën gjashtë e cilat në klasën e shtatë. Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetence mund të synohet të arrihet në dy klasë radhazi. Kjo i mbetet mësimdhënësit të vendosë.
- **Kujdes! Rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës**

#### **Të rikujtojmë procedurat e nevojshme për plotësim të tabelës**

- Tabela punohet nga **Departamentet profesionale /Aktivet profesionale** të shkollës/ Këshilli i klasave.
- Për secilën fushë kurrikulare **punojnë bashkërisht mësimdhënësit** e lëndëve që i takojnë fushës kurrikulare. Kjo vlen për shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë.
- Në shkallën e parë dhe të dytë (shkollë fillore), **punojnë të gjithë mësuesit** e paraleleve, sa ka klasa e caktuar. Por, në këtë grup, duhet të kontribuojë edhe një përfaqësues i secilës fushë kurrikulare të shkollës së mesme të ulët.
- Pasi që planifikimi vjetor punohet për lëndët mësimore në kuadër të fushës së caktuar dhe për klasën e caktuar, atëherë **mbledhet Këshilli i klasës** së caktuar dhe bashkërisht analizojnë planifikimin e secilës fushë kurrikulare dhe e vendosin në formatin e tabelës.

- Gjatë vendosjes në këtë tabelë përfaqësuesit e fushave, të klasës së caktuar (në shkollën fillore mund të jetë mësues klase) diskutojnë për përmbajtjen dhe kompetencat që synon t'i arrijë secila lëndë mësimore/fushë për klasën e caktuar, në mënyrë që të sigurohet mbulueshmëria e plotë dhe e drejtë e arritjes së rezultateve të të nxëniet për kompetencat kryesore të shkallës dhe ndërlidhja në mes lëndëve mësimore /fushave të jetë sa më e pranishme në planifikimet mësimore dhe në praktikat e mësimdhënies.

## PLANI DYMUJOR \_\_\_\_\_

**Fusha e kurrikulës:** \_\_\_\_\_ **Lënda mësimore:** \_\_\_\_\_ **Klasa:** \_\_\_\_\_

**Temat mësimore:**.....

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**.....

**Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**.....

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për tema mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare	Burimet

## Udhëzimet për plotësimin e pjesës narrative dhe të tabelës

### Pjesa narrative

### Planifikimi

Plani dymujor, sipas këtij formulari, bëhet për një temë mësimore. Nëse brenda dy muajsh në planifikimin vjetor janë parapa dy apo më shumë tema, atëherë, për secilën temë, duhet të bëhet planifikimi. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular (tabelë).

**Temat mësimore:** Merren nga tabela e planifikimit vjetor të temave për lëndë mësimore sipas planifikimeve për dy muaj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetenca kryesore të shkallës:** Merren nga planifikimi vjetor, vetëm ato rezultate të të nxënit që synohen të arrihen përmes temës/ve mësimore që zhvillohen gjatë periudhës dymujore. Tani rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion si është në Kurrikulën bërthamë. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate.

**Rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë kurrikulare:** Shënohen vetëm ato rezultate të të nxënit të fushës kurrikulare, që, në programin e lëndës mësimore, janë pjesë e temave që zhvillohen brenda këtij planifikimi dymujor dhe që synohen të arrihen me realizimin e këtyre temave. Rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion, ashtu siç janë në programin e lëndës mësimore apo në Kurrikulën bërthamë. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate të synuara brenda një planifikimi dymujor.

## PLOTËSIMI I TABELËS

### Tema/t mësimore

Barten nga pjesa narrative. Tabela plotësohet me kolona horizontale, varësisht nga numri i temave në planin dymujor, në mënyrë që zbërthimi i planit të bëhet për tema të lëndës mësimore.

### Rezultatet e të nxënit për tema mësimore

Merren nga programi i lëndës, përkatësisht nga lista e rezultateve për temat mësimore në kuadër të programeve lëndore. Nëse një temë mësimore zgjatë më shumë se një periudhë dymujore e planifikimit, në tabelën e planit dymujor barten vetëm ato rezultate të të nxënit që duhet të arrihen përmes njësie mësimore që do të shtjellohen gjatë kësaj periudhe. Rezultatet tjera përfshihen në planifikimin tjetër dymujor. Rezultatet e temës së lëndës shënohen në origjinal, ashtu siç janë në kuadër të programit mësimor lëndor. Rezultatet shkruhen me numër dhe me narracion si është në programin e lëndës. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate, varësisht sa ka tema dhe sa rezultate duhet të arrihen brenda kohës së planifikuar.

### Njësitë mësimore

Njësitë mësimore përcaktohen dhe elaborohen për rezultatet e të nxënit të temës së planifikuar - në raport me kohëzgjatjen e saj. Numri i njësive mësimore përcaktohet nga vet mësimdhënësi. Mësimdhënësi përcaktohet për ato njësi mësimore që janë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të temës së lëndës dhe që i kontribuojnë arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe rezultateve të të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës, të caktuara për temën përkatëse. Një njësi mësimore mund të përfshijë disa rezultate, siç mundet që edhe një rezultat të zbërthehet në disa njësi mësimore (*nëse shihet e nevojshme*).

### Koha e nevojshme

Mësimdhënësi duhet të konsultojë planin vjetor, gjegjësisht numrin e orëve të planifikuara për tema. Mësimdhënësi tani vendos sa kohë (orë mësimore) i nevojitet, përmes njësive mësimore, të arrihen rezultatet e të nxënit të temës së lëndës mësimore. Të njëjtën gjë e bën, në çdo planifikim dymujor. Mësimdhënësi vendos sa kohë- javë, ditë, orë mësimore do t'ia dedikoj një rezultati/ rezultateve të temave brenda periudhës së planifikimit dymujor.

### Metodologjia e mësimdhënies

Te shkruhet *metodologjia e mësimdhënies që do të përdoret gjatë zhvillimit të temës (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin e orës mësimore)*, duke specifikuar disa nga qasjet metodologjike, metodat dhe teknikat e mësimdhënies interaktive që janë relevante për temën/lëndën dhe që i ndihmojnë nxënësit

për arritjen e rezultateve të të nxënit të synuara me këtë plan dymujor, si p.sh. puna me projekte, vëzhgimet në natyrë, studimi kërkimor, intervista dhe debate, ekspozita tematike, teknika të mendimit kritik- varësisht nga specifikat e lëndës dhe nga përgatitja e mësimitdhënësit për zbatimin e qasjeve metodologjike.

### **Vlerësimi**

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit të arritjeve të nxënësit (jo shumë e detajuar sepse vendoset në planifikimin ditor) që përdoren për të vërtetuar nivelin e arritjeve të nxënësve dhe për të orientuar mbështetjen e të nxënit të nxënësve. P.sh. vlerësimi me listë kontrolli, vlerësimi me teste ose detyra përmbledhëse, vlerësimi me dosje (portofolio), vlerësimi me projekte, vlerësimi me foto apo albume, etj., varësisht nga specifikat e rezultateve të të nxënit të temës së lëndës.

### **Burimet**

Të shkruhen burimet që mësimitdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të caktuara.

Ato mund të jenë të ndryshme (burimet e shkruara, elektronike, njerëzore etj.);

- Burimet e shkruara mund të jenë tekste mësimore, gazeta, revista dokumente dhe materiale të ndryshme;
- Burimet elektronike interneti, ueb-faqja, TV-kanali-emisioni, radio.
- Burimet njerëzore mund të jenë njerëzit që janë pjesë e zhvillimit të laboratorëve të shkencave natyrore, ngjarjeve, punës, etj.

**Sugjerim:** *Një planifikim i mirë kërkon bashkëpunim brenda departamentit/aktiveve profesionale!*



<b>Dita</b>	<b>Temat /NJËSITË MËSIMORE NË JAVË /</b> (Model i përshtatshëm për nivelin fillor dhe shkollat e vogla që kanë numër të vogël të indekseve të paraleleve në një klasë)							Përshkrim i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës mësimore <sup>9</sup>
E hënë	<b>Fushat e kurrikulës – / lëndët mësimore /duke përfshirë edhe kurrikulën me zgjedhje</b>							
	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	
E martë	<b>Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore</b>							
	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	
E mërkurë	<b>Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore</b>							
	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	
E enjte	<b>Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore</b>							
	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	
E premtë	<b>Fushat e kurrikulës / lëndët mësimore</b>							
	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Lënda:</b>	

<sup>9</sup> A) Temat e përbashkëta që e orientojnë fokusin e përbashkët të të gjitha lëndëve mësimore përgjatë javës, ose brenda një dite. B) Çështja ndërkurrikulare që është në fokus të javës dhe përfshihet në kuadër të shumicës së lëndëve mësimore; etj..

## MODELI I DYTË I PLANIT JAVOR PËR KLASË

**Shkalla: III Klasa: 6 Muaji: Tetor Java: II**

Fushat e kurrikulës	Lëndët mësimore	Temat /NJËSITË MËSIMORE NË JAVË /	Përshkrim i shkurtër i aspekteve të përbashkëta të javës mësimore <sup>10</sup>
<b>Gjuhët dhe komunikimi</b>	Gjuhë amtare		
	Gjuhë angleze		
	Gjuhë e dytë e huaj		
<b>Artet</b>	Art muzikor		
	Art figurativ		
<b>Matematikë</b>	Matematikë		
<b>Shkencat e natyrës</b>	Biologji		
	Fizikë		
<b>Shoqëria dhe mjedisi</b>	Edukatë qytetare		
	Histori		
	Gjeografi		
<b>Jeta dhe puna</b>	TIK		
<b>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</b>	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti		
<b>Pjesa zgjedhore</b>	Pjesa zgjedhore		
<b>Aktivitete jashtëkurrikulare</b>	<b>Aktivitete jashtëkurrikulare</b>		

<sup>10</sup> A) Temat e përbashkëta që orientojnë fokusin e përbashkët të të gjitha lëndëve mësimore përgjatë javës, ose brenda një dite. B) Çështja ndërkurrikulare që është në fokus të javës dhe përfshihet në kuadër të shumicës së lëndëve mësimore; etj..

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Fusha kurrikulare: _____ / Lënda: _____ Shkalla e kurrikulës: _____ / Klasa: _____	
Tema (Nga plani dymujor):	Rezultati i të nxënit të temës (Nga plani dymujor):
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):	
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :	
ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE	
Njësia mësimore	
Fjalët kyçe	
Rezultat-i/et e të nxënit për orë mësimore: Kriteret e suksesit:	
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:	
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare:	
PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE	
VLERËSIMI I NXËNËSVE	
DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR	
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore	

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

(UDHËZIME PËR PLOTËSIM TË TABELËS)

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: \_\_\_\_\_ / Lënda: \_\_\_\_\_ Shkalla e kurrikulës: \_\_\_\_\_ / Klasa: \_\_\_\_\_

Tema (Nga plani dymujor):

Rezultati i të nxënit të temës (Nga plani dymujor):

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

Barten nga plani dymujor, vetëm rezultat-i/et që lidhen me fokusin e orës mësimore.

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**

Barten nga plani dymujor, vetëm rezultat-i/et që lidhen me fokusin e orës mësimore.

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

**Njësia mësimore** (merret nga plani dymujor, përkatësisht nga plani javor. Në raste të veçanta, nëse mësimdhënësi ka vendosur që për çështje praktike temën ta ruajë si formulim në kuadër të njësisë mësimore, atëherë, në vend të njësisë, mund të shënohet tema mësimore.

**Fjalët kyçe** (vendosen vetëm fjalët që identifikohen me njësinë mësimore që trajtohet brenda orës mësimore):

**Rezultat-i/et e të nxënit për orë mësimore:**

Rezultatet e të nxënit për orë mësimore, duhet të jenë të definuara qartë, të matshme, me strukturë të plotë të rezultateve të të nxënit (veprim+qëllim/objekt+kusht+kriter) dhe në funksion të zotërimit të rezultateve të të nxënit të temës së lëndës dhe rezultateve të të nxënit të shkallës për kompetencat kryesore dhe me rezultatet e të nxënit të fushës sipas pritshmërive të përcaktuara për shkallën përkatëse.

Në raste të caktuar, kur tema nuk është zërthyer në njësi mësimore, rezultati i temës mund të jetë edhe rezultati i një apo më shumë orëve të mësimin. Mirëpo në raste të tilla është e domosdoshme që rezultati të zërthehet në kritere të suksesit për orë mësimore.

**Kriteret e suksesit:**

Kriteret e suksesit duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës. Paraprakisht, mësimdhënësi duhet ta bëjë një orientim në bazë të kontekstit të klasës dhe veprimtarive të planifikuara për punë me nxënës. Kriteret e suksesit të zërthyer për rezultatin e të nxënit të njësisë mësimore duhet të jenë të formuluar mirë. Nuk duhet të përsërisin rezultatin e të nxënit të orës mësimore, por rezultatin e të nxënit e zërthejnë sipas niveleve të arritjes (nivel i ulët, nivel mesatar dhe nivel i lartë) dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit të rezultatit të të nxënit të orës mësimore.

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

Këtu vendosen të detajuara burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë gjatë orës mësimore (shih orientimet e përgjithshme të planit dymujor për burimet).

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare:**

Përshkruhet shkurtimisht me cilën/cilat lëndë mësimore dhe çështje ndërkurrikulare ndërlidhet ora mësimore. Në mënyrë specifike, me cilat tema të lëndës/lëndëve dhe me cilat aspekte të çështjes së caktuar ndërkurrikulare ndërlidhet ora mësimore dhe veprimtaritë me nxënës.

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

Përshkrimi duhet të përfshijë organizimin e orës së mësimi, i cili duhet të përmbajë:

- lidhjen e temës/njësisë mësimore me njohuritë e mëparshme të nxënësve;
- ndërtimin e njohurive të reja;
- prezantimin dhe demonstrimin e rezultateve të arritura;
- etj.

### **VLERËSIMI I NXËNËSVE**

Përshkruhet qasja që do të përdoret në vlerësimin formativ në raport me rezultatet e të nxënit për orën mësimore. Pjesë e përshkrimit të vlerësimit duhet të jetë edhe përcaktimi i nxënësve që do të vëzhgohen gjatë kësaj ore mësimi, duke pasur parasysh të dhënat e mbledhura nga evidencat dhe progresi i nxënësve.

### **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR**

*Këtu përshkruhen detyrat dhe puna e pavarur që planifikohen për t'u realizuar me nxënës, kur vlerësohet se disa aktivitete paraprake të orës së mësimi, mund të realizohen më shpejtë, apo mund të zgjatet ora e mësimi edhe pas orës mësimore, në mënyrë që të mos rritet ngarkesa e nxënësit në orë të mësimi. Për këtë vendos vet mësimdhënësi. Detyrat dhe puna e pavarur jashtë orës së mësimi, duhet të bëhen përpjekje që sipas rastit të jenë të integruar, brenda lëndëve të fushës apo ndërmjet fushave.*

### **Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore**

Kjo pjesë plotësohet pas përfundimit të orës mësimore. Mësimdhënësi bën një vetëreflektim dhe vetëvlerësim për cilësinë e orës mësimore në raport me përmbushjen e planifikimit të orës mësimore, në mënyrë të veçantë në raport me ndikimin e orës në arritjet dhe rezultatet e nxënësve.

## Burimet dhe literatura

1. Edited by Ted Huddleston and David Kerr (2010), Making Sense of Citizenship, A Continuing Professional Development Handbook, The Citizenship Foundation, 338 Euston Road, London NĒ1 3BH
2. Education Scotland Foghlam Alb, Career –Long Professional Learning, Guidance for teachers on approaches to professional learning,  
<http://www.educationscotland.gov.uk/clpl>, 06.03.2014
3. Fox chapel area high school, 2004-5005,, Course description guide, Pittsburgh, USA
4. Franklin Regional School District, 2004/2005,, Instructional planning organizer/MAP, Pittsburgh, USA
5. Gashi, Shqipe & Qarkaxhia, Diana, (2013): Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës (Programi parafillor dhe fillor), (dorëshkrim), Prishtinë.
6. Grup autoresh. (2013). Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 të lëndës së matematikës, Basic Education Program, Prishtinë.
7. Kurrikula e shkollës ndërkombëtare në Vanta (International School of Vantaa), Finlandë <http://www.eduvantaa.fi/isv/curriculum/curriculum.pdf>, 06.03.2014
8. MAShT & Kultur kontakt Austria. (2011). Udhëzues për punimin e materialeve mësimore, Prishtinë.
9. MAShT, (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Prishtinë. (Versioni i rishikuar pas fazës së pilotimit).
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të lartë, Prishtinë. (Versioni i rishikuar pas fazës së pilotimit).
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për arsimin e mesëm të ulët, Prishtinë. (Versioni i rishikuar pas fazës së pilotimit).
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & GIZ IS (2012): Moduli 5 për Aftësimin e Mësimdhënësve në Shërbim: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, Prishtinë.
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & SWAP (2012): Udhëzues për mësimdhënës për përmirësimin e praktikave në klasë, Prishtinë.
10. North Hills School District, 2003, Pa Academic Standards, planned instruction, Pittsburgh, USA Road, London NW1 3BH
11. Salihu, Arbër & Gashi, Bislim, (2013): Udhëzues praktik për zbatimin e kurrikulës – Shoqëria dhe Mjediti, (dorëshkrim), Prishtinë.

- Sherry Bennett and Dale Armstrong; Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices (Chapter 13)
- 12. SQA, June 2013, National 5 Unit Specification, Unit code: H27G 75; Unit code: H27H 75
- 13. St Josep Primary School, august, september 2013, Dalily Planner (Mrs Dastey), Glasgoë, Scotland
- Susan M. Brookhart; “Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment” (Chapt. 10)
- 14. The city of Edinburgh Council, 2013 City of Edinburgh Literacy across Learning Progression Pathëays- a resource to support planning, progresion and assessment, Èriting overvieë- firs level – to the end of P4, but earlier or later for some
- 15. University of Oregon, 2003, Dynamic indicatours of basic Early Literacy Skills™ 6<sup>th</sup> Ed, kindregarden, first,secon, third grade Benchmark Assessment, USA
- 16. Vastersundoms Skola, 2012, plani javor, Vanda (Vantaa), Finlandë.
- 17. Webber, Richard (2010): Kurrikulumi dhe vlerësimi i bazuar në kompetenca, Prishtinë.
- 18. Zabeli, dr. Naser (2011). *Teoria e mësimi* – ligjëratat në dorëshkrim.